



Komuna e Podujevës

**HARTA ZONALE E KOMUNËS SË PODUJEVËS
2021-2029**

PËRMBAJTJA

PJESA TEKSTUALE E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS.....	6
PËRKUFIZIMET E SHPREHJEVE TË PËRDORURA NË HZK.....	6
LISTA E SHKURTESAVE	7
I. HYRJE	8
1.1. Baza ligjore për hartimin e HZK-së.....	8
1.2. Qëllimi i HZK-së.....	9
1.3. Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e HZK-së	9
1.4. Kërkesat dhe obligimet nga PZHK-ja.....	10
1.5. Ndërlidhjet me PRRU-të dhe PRRH- të	11
1.6. Ndryshimet eventuale në tematikë ose në strategjitë sektoriale lokale që nga miratimi i PZHK-së.....	11
II. ARSYETIM	13
2.1. Arsyetimi ligjor, mjedisor, ekonomik, financiar dhe social për krijimin dhe zbatimin e Zonave, Zonave mbishtrësore dhe planit të veprimit të PZHK-së	13
2.2. Raporti i shqyrtimit publik	14
2.3. Obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet e planifikimit hapësinor për rajonin më të gjerë	14
2.4. Aspekte të rëndësishme për trajtim para përcaktimit të zonave dhe kushteve të përgjithshme zhvillimore	15
2.4.1. Tërësitë hapësinore.....	15
III. KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHMË.....	18
3.1. Shfrytëzimet e tokës.....	18
3.1.1 Shfrytëzimet e lejuara	19
3.1.2 Shfrytëzimet dytësore	19
3.1.3 Shfrytëzimet dhe strukturat e përkohshme	19
3.1.4 Shfrytëzimet dhe strukturat e veçanta	19
3.1.5 Shfrytëzimet e ndaluara	19
3.2. Qasja në parcelën kadastrale	20
3.3. Qasja në infrastrukturën teknike	20
3.4. Rregullat për parkim dhe shkarkim.....	20
3.5. Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës.....	22
3.6. Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial	24
3.7. Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës.....	25
3.8. Kërkesat për efikasitet të energjisë.....	26
3.9. Formësimi arkitektonik.....	26
3.10. Kërkesat për zhvillimet apo ndërtimet në afërsi të zonave me rëndësi të veçantë.....	27
3.11. Masat për mbrojtjen e mjedisit	27
3.12. Kërkesat për sigurim të qasjes së personave me aftësi të kufizuara	27
IV. LISTA E ZONAVE.....	28
4.1. Lista e të gjitha zonave	28
V. ZONAT E PËRCAKTUARA DHE KUSHTET ZHVILLIMORE TË TYRE	31
5.1 Zona Pyjore.....	31
Sipërfaqet pyjore sipas projeksioneve të PZHK-së.....	31
Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	31
Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë	31
5.2 Zona Bujqësore.....	32
5.2.1 Sipërfaqet bujqësore sipas projeksioneve të PZHK	32
5.2.2 Zona bujqësore Zbu-1- kategoria e tokës bujqësore I-IV.....	32
5.2.2.1. Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara.....	32
5.2.3 Zona bujqësore Zbu-2- kategoria e tokës bujqësore V-VII.....	33
5.2.3.1. Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara.....	33
5.3 Zona e banimit.....	40
5.3.1 Nën-zona e banimit ZB-1: Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët të zhvillimit	43
5.3.2 Nën-zona e banimit ZB-2: Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë të zhvillimit	44

5.3.3	Nën-zona e banimit ZB-3: Sipërfaqet sub-urbane dhe qendrat bazike.....	46
5.3.4	Nën-zona e banimit ZB-4: Sipërfaqe e përgjithshme urbane.....	52
5.3.5	Nën-zona e banimit ZB-5: Sipërfaqe urbane qendrore.....	53
5.4	Zona e shfrytëzimit të përzier.....	57
	Sipërfaqet e shfrytëzimit të përzier sipas projeksioneve të PZHK-së	57
	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	58
	Kushtet zhvillimore.....	58
5.5	Shërbimet.....	60
5.5.1	Shërbimet e komunitetit (Infrastruktura publike)	60
5.5.2	Sipërfaqet e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative (Infrastruktura sociale) ..	66
5.5.3	Sipërfaqet e shërbimeve publike- Infrastruktura teknike	70
5.6	Sipërfaqet e rrjetit të transportit.....	78
5.6.1	Sipërfaqet e rrjetit të transportit rrugor.....	78
5.6.2	Transporti hekurudhor	79
5.6.3	Sipërfaqet e rrjetit të transportit- ajror	80
5.6.4	Urat	80
5.6.5	Sipërfaqet e rrjetit të transportit publik dhe transportit jo të motorizuar	80
5.6.6	Sipërfaqet e rrjetit të transportit- parkingjet.....	81
5.6.7	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	81
	Kushtet zhvillimore.....	83
5.7	Zona industriale dhe komerciale	86
5.7.1	Sipërfaqet për industri sipas projeksioneve të PZHK-së	86
	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	86
	Kushtet zhvillimore.....	86
5.8	Zonat turistike	88
	Sipërfaqet për turizëm sipas projeksioneve të PZHK-së	88
	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	89
	Kushtet zhvillimore.....	89
5.9	Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit.....	92
5.9.1	Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit sipas PZHK-së dhe Strategjive nacionale	92
5.9.2	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	93
	Kushtet zhvillimore.....	96
5.10	Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës.....	97
5.10.1	Sipërfaqet me vlera të mbrojtura të natyrës sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera.....	98
5.10.2	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	98
	Kushtet zhvillimore.....	99
5.11	Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore	100
5.11.1	Sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera	100
	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	102
	Kushtet zhvillimore.....	103
5.12	Zonat e interesit dhe mbrojtjes shtetërore	105
5.12.1	Sipërfaqet e interesit të përgjithshëm sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera	105
	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	105
	Kushtet zhvillimore.....	105
5.13	Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit.....	106
	Sipërfaqet minerare sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjisë nacionale	106
	Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara	106
	Kushtet zhvillimore.....	107
5.14	Zona Mbishtresore	108
5.14.1	Zona Mbishtresore për mbrojtje nga vërshimet (ZM – mv)	109
5.14.2	Zona Mbishtresore për mbrojtje nga erozioni (ZM – me)	109
5.14.3	Zona Mbishtresore për Mbrojtje nga Tërmetet (ZM – mt).....	112
VI	TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE DHE NDËRTIMEVE PA LEJE	113
6.1	Vendbanimet joformale	113
	Sipërfaqet e vendbanimeve joformale sipas projeksioneve të PZHK-së.....	113

Kushtet zhvillimore për vendbanimet joformale	113
6.2. Ndërtimet pa leje	114
VII. PËRCAKTIMI I ZONAVE PËR TË CILAT HARTOHET PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM	114
7. 1. Kufijtë e zonave/ sipërfaqeve për të cilat do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm.....	114
Plani Rregullues i Hollësishëm (PRrH) për Zonën Ekonomike – industriale/komerciale	114
7.1.1 Nevoja për hartimin e Planeve tjera Rregulluese të Hollësishme (PRrH) përpos atyre të përcaktuara me HZK.....	115
VIII. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS.....	116
IX. PROCESET PËR NDRYSHIME, PËRJASHTIME, JOKONFORMITETE DHE BONUSET E ZONIMIT	145
9.1. Ndryshim Plotësimet	145
9.2. Përrjashtimet	145
9.3. Jo konformitetet.....	145
9.4. Bonuset e zonimit.....	146
X. DISPOZITAT PËR INTERPRETIMIN, ANKESAT, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS	146
10. 1 Dispozitat për interpretimin e shfrytëzimeve dhe kushteve zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës	146
10.2. Dispozitat për interpretimin e procesit të ankesave	146
10. 3. Dispozitat për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës	147
10.3.1 Dispozitat për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës.....	147
10.3.2. Dispozitat për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës	148
10.3.3 Dispozitat përfundimtare	148

[Lista e tabelave](#)

Tabela 1 Kufiri ndërtimor sipas ndryshimeve të evidentuara në terren krahasuar me atë të PZHK-së.....	12
Tabela 2 Shfrytëzimi i tokës sipas PZHK-së.....	14
Tabela 3 Numri i vend-parkimeve për automjete varësisht nga lloji i shfrytëzimit	20
Tabela 4 Numri i vend-parkimeve për biçikleta në varësi nga përmbajtja	22
Tabela 5 Vlerat kufitare të burimit të zhurmës varësisht nga lloji i trafikut.....	25
Tabela 6 Lista e zonave.....	28
Tabela 7 Dimensionet e parcelës, intensiteti i zhvillimit, sipërfaqja e gjelbërimit dhe nëntokësore e parcelës.....	58
Tabela 8 Dimensionet e parcelës, lartësia, indeksi për objektet e shërbimeve të komunitetit.....	65
Tabela 9 Normat e planifikimit sipas UA për objektet e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative.....	68
Tabela 10 Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës.....	74
Tabela 11 Madhësitë e parcelës për objektet e shërbimeve publike-infrastrukturës teknike.....	76
Tabela 12 Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë dhe Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive.....	78
Tabela 13 Normat për kategoritë e rrugëve.....	83
Tabela 14 Normat për ndërtimin e rrugëve lokale dhe përmbajtjeve përcjellëse.....	84
Tabela 15 Normat e transportit jo të motorizuar	85
Tabela 16 Madhësia e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit për qendrën e Mobilitetit	85
Tabela 17 Dimensionet e parcelës, lartësia, intensiteti i zhvillimit	86
Tabela 18 Dimensionet e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit:	89
Tabela 19 Vlerat natyrore.....	98

[Lista e kutive](#)

Kutia 1 Vendime/politika nga qeverisja lokale dhe qendrore me implikime në shfrytëzimin e tokës	12
Kutia 2 Rregullorja 315 për hekurudha.....	84
Kutia 3 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në pasurinë ujore publike	93
Kutia 4 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në akumulacionin Batllava.....	93
Kutia 5 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në burimet ujore ekzistuese: Peran, Revuq, Dobratin dhe burimin e planifikuar në Zhiti dhe tjera që mund të planifikohen në të ardhmen (potenciale të mundshme në Sfeqël, Surkish, Murgull dhe Llapashticë).....	95

Kutia 6 Masat mbrojtëse në bazë të Vendimit me nr. 17/127, të burimit ujq sipërfaqësor – Akumulimi i Batllavës	96
Kutia 7 Jokonformitetet sipas përcaktimit ligjor	145
Kutia 8 Interpretimi i dispozitave të HZK-së për aplikuesin për leje ndërtimore	146
Lista e hartave	
Harta 1 Harta e kufirit të sipërfaqeve të ndërtuara.....	17
Harta 2 Harta e të dhënave bazë.....	29
Harta 3 Harta zonale e shfrytëzimit të tokës (hartat e integruar).....	30
Harta 4 Harta zona e shfrytëzimit të tokës pyjore.....	32
Harta 5 Zona bujqësore.....	40
Harta 6 Zona e banimit.....	41
Harta 7 Harta e nën-zonave të banimit.....	42
Harta 8 Harta e nën-zonave të banimit në zonën urbane	42
Harta 9 Harta e nën-zonës së banimit ZB-1.....	44
Harta 10 Harta e nën-zonës së banimit ZB-2.....	45
Harta 11 Harta e nën-zonës së banimit ZB-3.....	47
Harta 12 Harta e nën-zonës së banimit ZB-4.....	53
Harta 13 Harta e nën-zonës së banimit ZB-5.....	54
Harta 14 Zona e shfrytëzimit të përzier.....	58
Harta 15 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit (infrastrukturës publike)	61
Harta 16 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- Institucionet e arsimit.....	63
Harta 17 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- Institucionet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale ..	63
Harta 18 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- administrata publike, mbrojtja dhe siguria sociale	64
Harta 19 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- religjioni dhe varrezat.....	64
Harta 20 Sipërfaqet e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative	68
Harta 21 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike.....	70
Harta 22 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike – Rrjeti i ujësjellësit.....	71
Harta 23 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike – Rrjeti i kanalizimit	72
Harta 24 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike –Rrjeti energjetik, telekomunikacionit dhe ndriçimit publik	73
Harta 25 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike –Infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave.....	75
Harta 26 Sipërfaqet e rrjetit të transportit	82
Harta 27 Sipërfaqet e rrjetit të transportit – qytet.....	82
Harta 28 Zonat industriale dhe komerciale	88
Harta 29 Zonat turistike.....	92
Harta 30 Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës si dhe sipërfaqet ujore me zonat e mbrojtura ujore	99
Harta 31 Zonat e mbrojtura të akumulacionit të Batllavës	100
Harta 32 Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore	105
Harta 33 Harta me sipërfaqet me ndërtesat me rëndësi për Kosovën dhe interesit dhe mbrojtjes shtetërore	106
Harta 34 Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit	108
Harta 35 Zonat mbishtresore	112
Harta 36 Vendbanimi joformal	113
Harta 37 Harta e sipërfaqeve për të cilat do të hartohet Plan Rregullues i Hollësishëm.....	115

PJESA TEKSTUALE E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

PËRKUFIZIMET E SHPREHJEVE TË PËRDORURA NË HZK

Shprehjet dhe termat e përdorura në këtë seksion janë konsideruar si të nevojshme gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK) dhe të cilat nuk janë përkufizuar apo janë përkufizuar jo mjaftueshëm përmes Ligjit për planifikim hapësinor, Normave teknike për planifikim hapësinor apo Planit Zhvillimor komunal. Literatura e përdorur për përkufizimin e tyre është Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për planifikim hapësinor/rajonar (CEMAT).

Bashkëpunimi ndërkufitar, trans-nacional, ndër-rajonar: Bashkëpunimi territorial ndërmjet qeverive nacionale, rajonale dhe lokale është një element i rëndësishëm i integritetit evropian. Ai ka për synim largimin e ndikimeve negative të kufijve shtetëror në zhvillimin territorial.

Dizajni urban: Dizajni urban¹ është disiplinë tradicionale e planifikimit urban e cila ishte veçanërisht në modë në kohën kur planifikimi urban para se gjithash merrej me planet e ndërtimit. Dizajni urban, në veçanti është përdorur në planifikimin e qyteteve të reja, duke përfshirë planifikimin e qyteteve të tëra. Kohët e fundit, në fokusin e dizajnit urban është planifikimi i hapësirave publike, duke përfshirë tërësinë e hapësirave që përdoren lirshëm për çdo ditë nga publiku i gjerë, në veçanti rrugët dhe parqet.

Menaxhimi i tokës: Menaxhimi i tokës mund të përkufizohet si proces i menaxhimit të shfrytëzimit dhe zhvillimit të burimeve të tokës në mënyrë të qëndrueshme.

Menaxhimi i pellgut ujqor: Menaxhimi i pellgut ujqor i referohet menaxhimit të burimeve ujore në pellgun e ujit, i cili përbëhet nga rrjedha e lumit kryesor, të gjitha degët e tij, si dhe ujërat nëntokësor. Aktivitetet e menaxhimit të ujërave përfshijnë parandalimin e vërshimeve, kontrollin e aktiviteteve të cilat kanë ndikim në nivelin dhe kualitetin e burimeve ujore (nxjerrja e ujit, ndotja e përqendruar dhe e shpërndarë) dhe të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të sistemit hidrologjik të pellgut.

Planifikimi me pjesëmarrje: Planifikimi me pjesëmarrje është formë specifike e aktiviteteve të planifikimit të zbatuara nga autoritetet publike, kryesisht në nivel lokal, i cili ju mundëson qytetarëve të përfshihen në procesin e planifikimit.

Partneriteti publiko-privat: Partneritet publik-privat është marrëveshje formale (zakonisht kontratë) me të cilën organet publike (qeveria qendrore, rajonale ose lokale) dhe një ose më shumë subjekteve private vendosin që të bashkëpunojnë në ndërtimin e aseteve ose ofrimin e shërbimeve.

Projektet e zhvillimit hapësinor: Projektet e zhvillimit hapësinor janë projekte të hartuara ose të kontrolluara nga institucionet publike, të cilat kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin territorial në nivele të ndryshme. Projektet e zhvillimit hapësinor mund të përfshijnë punët infrastrukturore, përparimin ekonomik dhe zhvillimin e zonave të veçanta, masat për rehabilitim urban, restaurimi ekosistemeve të dëmtuara, etj.

Planifikimi Hapësinor: Planifikimi hapësinor i referohet metodave përmes së cilave sektori publik ndikon në shpërndarjen e njerëzve dhe aktiviteteve në hapësirë në nivele të ndryshme, si dhe në vendndodhjen e zonave të ndryshme të infrastrukturës, rekreacionit dhe zonave të natyrës.

Struktura urbane/Rrjeti i vendbanimeve: Vlerësimi morfologjik/funksional dhe analiza e qytezave, qyteteve dhe vendbanimeve tjera e bën të mundur identifikimin e strukturës së tyre. Strukturën urbane e përbëjnë elementet dhe funksionet kryesore të cilat shfaqen brenda një zone urbane, të tilla si: morfologjia e qyteteve (kompakte ose e shpërndarë, me një ose më shumë qendra), shpërndarja e zonave urbane sipas vjetërsisë së tyre (mesjetare, e pasluftës, etj.), dhe funksioneve kryesore (veprimtaritë komerciale, banimi, industria, rekreacioni, etj.), shpërndarjes sociale dhe organizimit (zonat e varfëra dhe të braktisura, zonat e të pasurve, zonat me përqindje të lartë të emigrantëve, etj.), karakteristikat kryesore të transportit dhe akset e komunikacionit (sistemi i rrugëve, sistemi i transportit publik).

Shtigjet kulturore: Shtigjet kulturore janë itineraret të cilat lidhin elemente të rëndësishme të trashëgimisë dhe të traditave për të dëshmuar ose ilustruar periudha të veçanta dhe ngjarje të historisë evropiane.

¹ Shprehja “Dizajni urban” në literaturë haset edhe si “Projektim urbanistik”.

Shtigjet kulturore i karakterizon një dinamikë hapësinore dhe virtuale e cila nuk është veçori e peizazhit kulturor i cili për nga natyra është më statik dhe i kufizuar.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis: Vlerësimi i ndikimit në mjedis është një analizë e ndikimeve të mundshme që një projekt mund të ketë në ekosisteme, shëndetin e njeriut dhe në ndryshimet në sistemet natyrore. Ndikimet kryesore që duhet të analizohen janë: ndikimet nga toka e kontaminuar, ndikimet nga ajri i ndotur, efektet e zhurmës në shëndetin e njeriut, ndikimet ekologjike (përfshirë vlerësimin e ndikimit mbi speciet e rrezikuara , vlerësimin e rreziqeve gjeologjike dhe pasojat e ndotjes së ujit).

Vlerësimi strategjik i ndikimit në mjedis (VSM): Vlerësimi i strategjik i ndikimit në mjedis nuk i referohet ndikimeve të mundshme të projekteve individuale (si në rastin e Vlerësimit të ndikimit në mjedis), por ndikimeve të mundshme të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.

Zhvillimi hapësinor, politika e zhvillimit hapësinor: Zhvillimi hapësinor i referohet evoluimit të territoreve në të gjitha dimensionet e tyre (ekonomik, social, mjedisor dhe fizik).

Zonat peri-urbane: Zonat peri-urbane janë zona të cilat janë në një formë të tranzicionit nga zonat strikte rurale në ato urbane. Këto zona shpesh përfaqësojnë puqitjen direkte ndërmjet urbanes dhe rurales dhe përfundimisht mund të evoluojnë në zona plotësisht urbane. Zonat peri-urbane janë vende komponenti kryesor i të cilave janë njerëzit : ato janë mjedise të banuara .

Zona rurale/Fshati: Zonat rurale janë zona pak të banuara në të cilat nuk ka ndonjë qytet të madh apo qytezë të rëndësishme. Nocioni i fshatit i referohet formave të caktuara të peizazheve dhe të shfrytëzimit të tokës ku bujqësia dhe zonat natyrore luajnë një rol të rëndësishëm.

Zonë urbane: Zonë urbane është zona e cila fizikisht është pjesë e një qyteti të madh ose të vogël dhe e cila karakterizohet me një pjesë të rëndësishme të sipërfaqeve të ndërtuara, dendësi të lartë të popullsisë dhe punësimit dhe një rrjet i konsiderueshëm i infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës tjetër (në krahasim me zonat rurale). Zonat urbane gjithashtu mund të përfshijnë zona të pa-ndërtuara, të gjelbra që në përgjithësi përdoren për qëllime rekreative nga banorët urban.

LISTA E SHKURTESAVE

HZK	Harta Zonale e Kosovës	SHL	Shfrytëzimet e lejuara
KK	Kuvendi Komunal	SHLD	Shfrytëzimet e lejuara dytësore
LPH	Ligji për planifikim hapësinor	SHLV	Shfrytëzimet e lejuara të veçanta
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe inovacionit	SHLP	Shfrytëzimet e përkohshme
MI	Ministria e Infrastrukturës	SHN	Shfrytëzimet e ndaluara
MKRS	Ministria e Kulturës, rinisë dhe sportit	TAQ	Tërësia Aktive Qendrore
MMPHI	Ministria e Mjedisit, planifikimit hapësinor dhe Infrastrukturës	TNT	Tërësia Natyra dhe Turizmi
MPBZHR	Ministria e pylltarisë, bujqësisë dhe zhvillimit rural	TMP	Tërësia Malet dhe Peizazhet
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	UA	Udhëzim Administrativ
MPMS	Ministria e Punës dhe mirëqenies sociale		
MSH	Ministria e Shëndetësisë		
NTPH	Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor		
PHK	Plani Hapësinor i Kosovës		
PRrH	Plan Rregullues i Hollësishëm		
PRrU	Plan Rregullues Urban		
PZHK	Plani Zhvillimor i Komunës		
PZHU	Plan Zhvillimor Urban		
QeK	Qeveria e Kosovës		
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare		

I. HYRJE

1.1. Baza ligjore për hartimin e HZK-së

Legjislacioni bazë për hartimin dhe miratimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK) është:

- Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor (LPH);
- Udhëzimi Administrativ (UA) NR. 24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës si dhe ;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinor.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2019 për Metodën e Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave dhe Obligimet e Autoriteteve Publike dhe Personave tjerë fizik dhe juridik sa i përket mirëmbajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve dhe të dhënave në bazën e të dhënave.

Dokumentet relevante në të cilat mbështetet hartimi i HZK-së janë:

- Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) në fuqi
- Plani Rregullues Urban "Qendra"
- Plani Hapësinor i Kosovës në fuqi.

Gjatë hartimit të HZK-së janë konsultuar dhe marrë për bazë edhe këto ligje dhe dokumente të rëndësishme:

- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorinë;
- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës;
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;
- Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (LVSM);
- Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore;
- Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike;
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtje nga Zhurma;
- Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri;
- Ligji nr.04/L-060 për mbeturinat;
- Ligji Nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës;
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet;
- Ligji Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme dhe Ligji Nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/18; UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti.
- Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike;
- Ligji Nr. 04/L-176 për Turizmin;
- Ligji Nr. 05/L-130 për Shërbime;
- Ligji Nr.05/L-085 për energjinë elektrike
- Ligji Nr.05/L-052 për energjinë termale;
- Ligji Nr.04/L-016 për eficiencën e energjisë;
- Ligji Nr.04/L-109 për komunikimin elektronik;
- Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët;
- Ligji Nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr. 2003/11;
- Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat;
- Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim
- Ligji Nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje
- Ligji nr.03/L-164 mbi financimin e programeve të banimit social;
- Ligji Nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbkëqyrjen e kufirit të shtetit;
- Dokumentacioni Urbanistik planor i 17 vendbanimeve të komunës së Podujevës;
- Strategjitë e sektorëve të ndryshëm të Qeverisë dhe Komunës:
 - Strategjia lokale e zhvillimit ekonomik 2016-2018 (DAFI)

- Draft-Strategjia e zhvillimit të turizmit 2019-2021
- Plani lokal i veprimit i menaxhimit të mbeturinave të komunës së Podujevës 2017-2022;
- Draft-Plani lokal për efikasitet të energjisë
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011-2020, MMPH
- Strategjia nacionale për ujërat 2017-2036, MMPHI
- Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit, MI
- Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025, MEZH
- Strategjia për Mbrojtje të Mjedisit 2013-2022, MMPH
- Raport monitorues i zonave të mbrojtura në Podujevë 2015, MMPH/AKMM
- Vendimet të KK që nga miratimi i PZHK-së
- Raporti i vlerësimit të zbatimit të PZHK/U-së për periudhën 2016-2018
- Udhëzuesi për Hartim dhe Miratim të Hartës Zonale të Komunës, MMPH;
- Programi për Zhvillim Rural 2019, MBZHR.

1.2. Qëllimi i HZK-së

Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës (HZK) është përveç përmbushjes së kërkesës ligjore, t'i ofrojë qeverisjes komunale një instrument për kontroll të zhvillimit. HZK është dokument multi-sektorial me karakter rregullues, përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të komunës së Podujevës në zona (të tilla si hapësirat e lira, banim, industri, bujqësia, aktivitete ekonomike, etj), ku për secilën zonë përcaktohen shfrytëzimet e lejuara dhe ato të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ato të ndërtimit si dhe masat e veprimit për periudhën së paku 8 vjeçare.

1.3. Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e HZK-së

Ekipi i ngushtë përgjegjës për përgatitjen e HZK-së:

- | | |
|----------------------|---|
| 1. Bujar Hasani | Drejtor, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 2. Hamdi Jaha | ish-Drejtor, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 3. Veton Aliu | Kryesues, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 4. Fatmir Latifi | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 5. Ismet Kadriu | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 6. Florie Mani | Anëtare, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 7. Doruntina Sollova | Anëtare, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |

Ekipi Komunal i planifikimit:

- | | |
|----------------------|--|
| 1. Veton Aliu | Kryesues, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 2. Shemsedin Latifi | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 3. Ismet Kadriu | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 4. Fatmir Latifi | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 5. Florie Mani | Anëtare, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 6. Doruntina Sollova | Anëtare, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 7. Rizah Muqolli | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit |
| 8. Rrahim Berisha | Anëtar, Drejtoria e Administratës |
| 9. Valon Shabani | Anëtar, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave |
| 10. Ardian Emini | Anëtar, Drejtoria e Arsimit |
| 11. Zaim Thaçi | Anëtar, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale |
| 12. Faik Gashi | Anëtar, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale |
| 13. Petrit Islami | Anëtar, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë |
| 14. Jakup Gashi | Anëtar, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit |
| 15. Mirvete Jaha | Anëtar, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| 16. Rasim Fejza | Anëtar, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| 17. Qefser Vërshevc | Anëtar, Drejtoria e Inspeksionit |
| 18. Xhafer Sekiraga | Anëtar, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| 19. Ejup Babatinca | Anëtar, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik |
| 20. Hanushe Gjata | Anëtare, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik |
| 21. Liman Zeqiri | Anëtar, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim |

22. Teuta Ismajli	Anëtare, DKRS - (Monumentet dhe Trashëgimia Kulturore
23. Masar Çitaku	Anëtar, ekspert në fushën e Sistemit të Adresave
24. Muhamet Jashari	Anëtar, ekspert në fushën e Sistemit të Adresave
25. Shaip Aliu	Anëtar, QKMF – Podujevë, (fusha e shëndetësisë publike)
26. Nexhat Fazliu	Anëtar, KEDS
27. Mehdi Statovci	Anëtar, PTK
28. Naser Kajtazi	Anëtar, K.U.R. "Prishtina" sh.a.
29. Shaban Beselica	Anëtar, K.R.M. "Pastrimi" sh.a.
30. Faik Haliti	Anëtar, "Natyra" sh.p.k.

Momentet kyçe të vendim-marrjes dhe përfshirjes së publikut dhe akterëve tjerë

Gjatë procesit të hartimit të HZK-së, momentet kyçe të vendim marrjes dhe pjesëmarrjes janë:

- a. Vendimi i Kuvendit Komunal për hartimin e HZK-së: 19 Shtator 2017
- b. Takim publik për informimin e banorëve të Kërpimehit dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 12 Shtator 2018
- c. Takim publik për informimin e banorëve të Lluzhanit dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 13 Shtator 2018
- d. Takim publik për informimin e banorëve të Orllanit dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 14 Shtator 2018
- e. Takim publik për informimin e banorëve të Sfeqlës dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 17 Shtator 2018
- f. Takim publik për informimin e qytetarëve të Podujevës përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 18 Shtator 2018
- g. Takime pune të grupit punues të komunës për hartimin e HZK-së;
- h. Takime pune me zyrtarë të qeverisë dhe profesionistë për shtjellimin e zonave të: bujqësisë, pylltarisë, minierave e fushave të eksploatimit, zonat ujore, banimit, hekurudhave, zonat turistike etj;
- i. Punëtori për trajtimin e kushteve zhvillimore/ndërtimore në HZK: 28-29 maj 2019, Prevallë;
- j. Prezantimi publik i kushteve zhvillimore të draft-HZK: 25 qershor 2019;
- k. Dorëzimi i draft-HZK-së në MMPHI korrik 2019. Kërkesa nga MMPHI të sillet edhe raporti i VSM;
- l. Dorëzimi i draft HZK-së në MMPHI së bashku me raportin e VSM-së më 5 dhjetor 2020;
- m. Prezantimi i draft-HZK para MMPHI para se të vihet në shqyrtim publik: 12 dhjetor 2019;
- n. Periudha e shqyrtimit publik: prej 4 shkurt deri më 4 mars 2020;
- o. Prezantimi publik i përmbajtjes së HZK-së gjatë periudhës së shqyrtimit publik: 21 shkurt 2020
- p. Shqyrtimi i komenteve nga grupi punues dhe përpilimi i raportit të shqyrtimit publik;

1.4. Kërkesat dhe obligimet nga PZHK-ja

Pikënisje për hartimin e HZK-së është Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) i cili përfshin periudhën 2016-2025. Vizioni për zhvillimin hapësinor të komunës së Podujevës, sipas PZHK-së, reflekton për aspiratat e zhvillimit social, ekonomik, mjedisor, infrastrukturës dhe administratës duke synuar në përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike përmes krijimit të mundësive të punësimit dhe zvogëlimit të shkallës së varfërisë, avancimin e sistemit të arsimit dhe shëndetësisë përmes ngritjes së kapaciteteve fizike të objekteve shkollore dhe shëndetësore dhe cilësisë së shërbimit, shfrytëzim racional të tokës dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Sipërfaqet me tokat pyjore me 47.21%, tokat bujqësore me 29.85% dhe kullostat me 11.6% janë dominuese duke vënë në pah kështu edhe përparësitë krahasuese të potencialit zhvillimor që ndërlihet me to. Plani identifikon edhe problemet si: shfrytëzimi joracional dhe i pa-balancuar i tokës, zgjerimi i pakontrolluar i vendbanimeve dhe si pasojë humbja e tokës kualitative bujqësore. Për drejtuar zhvillimin e ardhshëm hapësinor, PZHK propozon dendësimin si parim i përgjithshëm i zhvillimit të ardhshëm. Për vendbanimet të cilat janë në presion apo paraqesin potencial për zhvillime të reja, PZHK ka përcaktuar kufirin brenda të cilit lejohet zhvillimi/ndërtimi, zonat ku nuk duhet të ndërtohet për shkak të bonitetit të tokës si dhe sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni. Plani nuk ka paraparë zgjerim të kufirit ekzistues urban, përderisa ka identifikuar tri vendbanime të cilat në të ardhmen do të zhvillohen si nën qendra (Orllani,

Kërpimeh dhe Lluzhan). Sipas projeksionit demografik për vitin 2020 (të dhëna të publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës) duke marrë për bazë vlerësimin e popullsisë në vitet 2011–2014, del se në vitin 2020 komuna e Podujevës do të ketë më pak popullsi se sa ka pasur në kohën kur është hartuar plani, kjo për shkak të trendit negativ të shtimit të popullsisë në vitet e fundit. Mirëpo kërkesa për banim vie si rrjedhojë e zvogëlimit të madhësisë së ekonomive familjare (nga 6.7 anëtarëve në ekonomi familjare rurale dhe 6.2 anëtarë në ekonomi familjare urbane) si dhe kërkesat e shumta për banim nga diaspora japin indikacion për një rritje të mundshme të kërkesës për banim në të ardhmen. PZHK rekomandon investime në infrastrukturë rrugore dhe të asaj për këmbësorë, përmirësim të qasjes në qytet dhe brenda qytetit, mirëpo nuk ka analizë të mirëfilltë në mes të shfrytëzimit të tokës dhe propozimeve të transportit (rrugor, hekurudhor dhe transportit publik). Projektet me interes nacional në komunën e Podujevës janë autostrada Prishtinë-Merdar, Mbrojtja e burimit ujqor të akumulacionit “Batllava”, aeroporti i Dumoshit si dhe hekurudha Prishtinë-Podujevë.

1.5. Ndërlidhjet me PRRU-të dhe PRRH- të

Komuna e Podujevës ka të hartuar PRRU-në për Qendrën e qytetit e cila e ndan këtë zonë në 18 blloqe urbanistike. Tri blloqe kanë destinim të përmbajtjeve të karakterit publik: Sheshi i qytetit dhe gjelbërim (Blloku 5), Sheshi dhe objekti I komunës (Blloku 6) dhe Hapësirë e lirë (Blloku i fundit 18), kurse 15 blloqet tjera kanë këtë përdorim afarizimit me rekreacion (Blloku 1) si dhe Banim me afarizëm (14 blloqet tjera). Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHU-së, dendësimi i paraparë me këtë dokument është zbatuar pjesërisht, andaj dendësimi në zonën urbane është marrë parasysh në dokumentin e HZK-së, të cilat po ashtu janë në përputhje të plotë me rekomandimet e PZHK-së.

1.6. Ndryshimet eventuale në tematikë ose në strategjitë sektoriale lokale që nga miratimi i PZHK-së

Që nga hyrja në fuqi e PZHK-së, në vitin 2016, vërehen ndryshime në terren nga zhvillimet e pakontrolluara jashtë kufirit ndërtimor të përcaktuar me PZHK, kryesisht në banim dhe ekonomi me shtrirje në toka bujqësore. Arsyet për këtë kanë të bëjnë me mungesën e kontrollit të zhvillimit, por edhe me përcaktimin e kufirit të tokës ndërtimore për zhvillimet e ardhshme në kuadër të PZHK-së i cili është bazuar vetëm në strukturat ekzistuese të ndërtesave për banim, duke bërë kështu që kufiri ndërtimor të jetë kufi i zonës së banimit e jo kufi i cili përfshinë zhvillime tjera siç janë: përmbajtjet e ndërtesave bujqësore, ekonomike, etj. Që këto ndryshime janë evidentuar në HZK, të njëjtat janë evidentuar si zhvillime jo-konforme dhe janë subjekt i trajtimit sipas ligjeve sektoriale siç është: Ligji i trajtimit të ndërtimeve pa-leje. Ndryshimet në shfrytëzimit të tokës nga ato që janë propozuar me PZHK vijnë edhe si rrjedhojë e vendim-marrjes lokale apo/dhe asaj të QeK (referoju disa prej tyre në kutinë e mëposhtme) të ndërlidhura kryesisht me projekte të rrjetit të transportit rrugor dhe hekurudhor, përmirësimit të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike, projekte për sport e rekreacion, të mirëqenies sociale etj.). Nga ana tjetër Raporti i vlerësimit të zbatimit të PZHK-së për vitet 2016-2018 ka evidentuar disa mangësi në kualitetin e PZHK, me ç’rast është konstatuar se fusha të caktuara tematike si ajo e banimit dhe ndërtimit, infrastrukturës sociale (kultura, sporti, rekreacioni) pavarësisht rëndësisë në zhvillimin hapësinor, nuk kanë marrë trajtimin e duhur. Andaj bazuar në ndryshimet e deri tashme si në terren po ashtu edhe në vendimmarrje është parë e nevojshme që me HZK të evidentohet kufiri ndërtimor sipas gjendjes ekzistuese ashtu që të plotësohen disa parime të UA Nr. 24/2015, e që janë:

3.3 promovimi i shëndetit publik, sigurisë publike dhe mirëqenies së përgjithshme;

3.4 sigurimi i llojllojshmërisë së shfrytëzimit dhe densiteteve të përshtatshme me karakterin e komunës që pasqyrojnë nevojat aktuale dhe ato të planifikuara;

3.6 sigurimin e zhvillimit të planifikuar bazuar në:

3.6.2 gjendjen ekzistuese, marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore me qëllim që hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të jetë real dhe i zbatueshëm;

3.6.5 nevoja për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;

3.6.7 sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor, etj; vëmendjen e duhur, prandaj ka rekomanduar që këto të kenë trajtim adekuat gjatë hartimit të HZK-së.

Kutia 1 Vendime/politika nga qeverisja lokale dhe qendrore me implikime në shfrytëzimin e tokës

Vendime të KK dhe politika lokale:

- Për dhënien e disa pronave të paluajtshe dhe pronës publike rrugë-lokale në shfrytëzim afatshkurtër respektivisht afatgjatë kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike – KEDS;
- Për caktimin e lokacioneve me destinim për deponimin e mbeturinave të krijuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore,
- Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 01-006-88066/ 06 dhjetor 2016 për caktimin e paluajtshtëmëve për ndërtimin e impiantit për trajtim biologjik të ujërave të zeza në Orllan. Ky ndryshim është bërë sepse në paluajtshtëmitë e caktuara gjendet një burim natyror (krua) ku furnizohen me ujë të pijes një pjesë e banorëve të atij lokaliteti;
- Për dhënien e pronave të paluajtshe për varreza të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Këshillit të Bashkësisë Islame;
- Për dhënien e pronës së paluajtshe në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së punëve të brendshme për ndërtimin e objektit të rezervuarit, kthinës së pompave, përkatësisht për ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit në rrugën nacionale N25.
- Për dhënien e pronës së paluajtshe të Komunës në shfrytëzim afatgjatë kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” – njësia Podujeve për nevojat e kompanisë;
- Për caktimin e lokacionit – Parcelave për ndërtimin e fushës sintetike të futbollit;
- Për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshe të Komunës në Lupç i Poshtëm për kultivimin e kulturave bujqësore me qëllim krijimin e të hyrave për komunën dhe të vendeve të reja të punës;
- Për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshe të Komunës, paluajtshtëmërinë dhe objektin hotelier në fshatin Orllan me qëllim ushtrimi të veprimtarisë hoteliere;
- Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e palestrës së sporteve në vendin “Fidanishte” në sip 20.000m²;
- Për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshe të Komunës, për qendrën për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeqël;
- Për dhënien e pronës së paluajtshe të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Mirëqenies Sociale për ndërtimin e objektit të Qendrës për aftësi profesionale;

Vendime apo politika të QeK:

- Lista e përditësuar e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2017, MKRS
- Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit: Projekti i rindërtimit të linjës hekurudhore dhe Projekti i renovimit të aeroportit të Dumoshit
- Raport monitorues i zonave të mbrojtura në Podujevë 2015, MPMH/AKMM

Tjera:

- Rekomandimet nga raporti i vlerësimit të zbatimit të PZHK/U-së për periudhën 2016-2018 për përfshirjen në HZK të disa projekteve me rëndësi për komunën.

Tabela 1 Kufiri ndërtimor sipas ndryshimeve të evidentuara në terren krahasuar me atë të PZHK-së

Vendbanimi	Evidentimi i kufirit të ndërtimeve në terren sipas gjendjes ekzistuese [ha]	Vendbanimi	Evidentimi i kufirit të ndërtimeve në terren sipas gjendjes ekzistuese [ha]
Bajqinë	108.71	Merdar	18.77
Balloç	91.18	Metehi	76.27
Barainë	12.17	Metergoc	21.46
Batllavë	123.78	Miroc	6.87
Bellopojë	69.78	Muhazob	3.14
Bërvenik	18.84	Murgull	10.89
Bllatë	6.07	Obrançë	373.00
Bradash	147.50	Orllan	92.98
Brainë	41.34	Pakashticë e Epërme	47.03
Brecë	6.34	Pakashticë e Poshtme	68.76
Buricë	12.75	Penuhë	44.38
Dobërdol	63.65	Peran	59.15
Dobratin	71.94	Përpellac	3.28
Dumnicë e Epërme	37.38	Podujevë	671.25
Dumnicë e Poshtme	258.26	Pollatë	14.82
Dumosh	65.52	Popovë	16.19

Vendbanimi	Evidentimi i kufirit të ndërtimeve në terren sipas gjendjes ekzistuese [ha]	Vendbanimi	Evidentimi i kufirit të ndërtimeve në terren sipas gjendjes ekzistuese [ha]
Dvorishtë	9.49	Potok	4.24
Dyz	35.36	Radujevc	17.77
Gërdoc	64.25	Rakinicë	3.91
Gllamnik	210.40	Reçicë	3.17
Godishnjak	11.64	Repë	27.33
Halabak	33.45	Revuq	97.44
Herticë	47.49	Sallabajë	26.35
Kaçybeg	31.75	Sfeqël	77.04
Kalaticë	16.01	Shajkoc	99.45
Kërpimëh	90.26	Shakovicë	31.18
Kunushhec	62.67	Shtedim	69.15
Kushevicë	22.30	Siboc i Epërm	53.17
Letanc	95.77	Siboc i Poshtëm	19.69
Livadicë	60.60	Sllatinë	11.25
Lladoc	45.86	Surdull	4.25
Llaspashticë e Epërme	113.97	Surkish	64.54
Llaspashticë e Poshtme	136.45	Sylevicë	8.12
Llaushë	60.47	Tërnavë	67.07
Llugë	88.48	Tërnavicë	3.12
Lluzhan	84.57	Turuçicë	22.40
Lupç i Epërm	16.99	Velikarekë	36.97
Lupç i Poshtëm	104.82	Zakut	23.47
Majac	85.97	Zhiti	7.25

II. ARSYETIM

2.1. Arsyetimi ligjor, mjedisor, ekonomik, financiar dhe social për krijimin dhe zbatimin e Zonave, Zonave mbishtresore dhe planit të veprimit të PZHk-së

HZK ofron elaboratin e hollësishëm të kufijve të zonave dhe kushteve zhvillimore për secilën zonë. Bazë për definimin e zonave është harta e shfrytëzimit të tokës e PZHk-së e cila ka përcaktuar shfrytëzimet e prezantuara në tabelën e mëposhtme. Emërtimi i zonave është bërë në përputhje me UA për NTPH. Në caktimin e zonave është aplikuar parimi i sigurimit të zhvillimit të planifikuar të bazuar në gjendjen faktike të mjedisit të ndërtuar me ç' rast janë shfrytëzuar imazhet satelitore të vitit 2018. Harmonizimi i kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private, promovimi i shëndetit dhe sigurisë publike si dhe kapacitetet e planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike e private janë marrë në konsideratë sidomos në përcaktimin e zonës së banimit dhe zonës së shërbimeve. Zonat me vlera natyrore dhe trashëgimisë kulturore si dhe sipërfaqet e mbrojtura ujore janë bazuar në parimin e sigurimit të mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peisazhor dhe kriterëve për mbrojtjen e brigjeve të ujë rrjedhave dhe akumulacioneve që dalin nga vendimet e QeK dhe ligjet respektive. Caktimi i zonës bujqësore dhe pyjore është bërë duke marrë parasysh karakteristikat natyrore të tokës, përfshirë përshtatshmërinë e shfrytëzueshmërisë të bazuar në karakteristikat e dheut, topografisë etj., parimin e ruajtjes së tokës kualitative bujqësore sipas përcaktimit të ligjit respektiv si dhe promovimin e traditës vendase në prodhimtarinë bujqësore. Kërkesat që vijnë nga ligjet respektive për sigurimin e kontrollit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, zhurmës, masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit, rrëshqitjes së dheut, tërmeteve dhe vërshimeve janë marrë parasysh gjatë përcaktimit të zonës mbishtresore. Definimi i shfrytëzimeve të lejuara, të lejuara dytësore, të lejuara të veçanta, të përkohshme dhe atyre të ndaluara si dhe i kushteve zhvillimore/ndërtimore në këto zona janë hartuar në përputhje me ligjet respektive dhe normat teknike të planifikimit hapësinor. Në rast të mos-ofrimit të tyre nga materiale e sipër-përmendura, është konsultuar literatura akademike.

Tabela 2 Shfrytëzimi i tokës sipas PZHK-së

Shfrytëzimi i tokës/Tërësitë hapësinore	Sipërfaqja (ha)		
	Malet dhe Pejsazhet 27700 ha	Aktive qendrore 19480 ha	Natyra dhe Turizmi 15690 ha
Sipërfaqe pyjore	15421	4509	9868
Sipërfaqe të banuara	597	1649	344.5
Sipërfaqe bujqësore	4701	11431	2758
Kullosat	5651	482.2	1284
Livadhe	1266	1253	1127
Degradim	12.21	16.22	18.21
Djerrina	17.71	52.26	9.75
Mbeturina	14.61	39.12	7.87
Varreza	19.6	48.11	15.09
Liqeni			257.52

Pikënisje për hartimin e planit të veprimit të HZK-së ka qenë marrja në konsideratë e planit të veprimit të PZHK-së, rekomandimet e dala nga raporti i vlerësimit të zbatimit të tij, rekomandimet e dala nga takimet e organizuara me qytetarë, projektet e parapara me vendime apo plane lokale të qeverisjes lokale si dhe nga strategjitë në fuqi të Qeverisë së Kosovës.

2.2. Raporti i shqyrtimit publik

Pas njoftimit nga MMPHI për marrjen e vendimit për shqyrtim publik, Kuvendi Komunal ka proceduar me marrjen e këtij vendimi kështu që me datën 4 shkurt 2020 draft-HZK i është ekspozuar shqyrtimit publik deri më datën 4 mars 2020. Vërejtjet e marra nga publiku janë regjistruar dhe janë trajtuar nga komuna. Është hartuar raporti i shqyrtimit publik i cili është pjesë përcjellëse e HZK-së.

2.3. Obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet e planifikimit hapësinor për rajonin më të gjerë

Podujeva në Planin Hapësinor të Kosovës (PHK) përfshihet në tërësinë “Porti i Kosovës-zona e kaltër” e cila karakterizohet me shërbime administrative, arsimore, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike me qendër kryesore Prishtinën. Obligimet për komunën e Podujevës nga ky Plan janë:

- Angazhim në përmirësimin e ofertës së shërbimeve në mënyrë ato të jenë më efikase;
- Forcimi i lidhjeve me fshatrat përreth dhe përpjekje që zona si tërësi të funksionojë në bazë të programeve të përcaktuara zhvillimore;
- Ndërtimi i autostradës Merdar–Vërmicë;
- Zhvillimi i stacioneve hekurudhore;
- Instalimi i gypave të gazsjellësit përgjatë rrugëve magjistrale që lidhin shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës dhe disa qendra më të vogla dhe lidhja e tyre me rrjetet e gazsjellësve të Serbisë dhe Maqedonisë; furnizimi në pesë faza. Faza e pestë: furnizimi i Kamenicës dhe Podujevës;
- Ndërtimi i akumulacioneve ujore;

Obligimet me karakter të bashkëpunimit ndër-komunal dhe me institucionet qendrore ndërlidhen me:

- Masa për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturore historike–Memorandum mirëkuptimi me MMPHI dhe MBPZHR për veprime të përbashkëta për mbrojtje të pyjeve;
- Bashkëpunimi me MMPHI si dhe me donatorët privat për të gjetur mundësinë e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve dhe gropave septike;
- Bashkëpunimi me MBPZHR dhe donatorët tjerë për hartimin e planeve menaxhuese të pyjeve, si dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura;
- Bashkëpunimi me MBPZHR dhe donatorë tjerë për realizimin e projekteve në fushën e bujqësisë;
- Projektet e ndërtimit të çerdhes, anekseve shkollore- në bashkëpunim me MASHTI;
- Projektet në sferën e shëndetësisë- bashkëpunimi me MSH;
- Trajnimet për menaxhimin e bizneseve të vogla- bashkëpunimi me MTI;
- Projektet infrastrukturës rrugore- bashkëpunimi me MI.

Sipas PZHK-së së Prishtinës, sfera të përbashkëta zhvillimore me Podujevën janë:

- Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm nga akumulacioni Batllava;
- Rrjeti rrugor, hekurudhor;
- Transporti publik ndër-urban dhe transporti i mallrave;

Me komunën e Mitrovicës, sfera të përbashkëta zhvillimore me Podujevën janë:

- Rrjeti rrugor në aksin: Mitrovicë-StanTërg–Bajgorë–Kërpimeh (R129); Me komunën e Obiliqit, sfera të përbashkëta zhvillimore me Podujevën janë:
- Rrjeti rrugor përmes rrugës rajonale R120;

2.4. Aspekte të rëndësishme për trajtim para përcaktimit të zonave dhe kushteve të përgjithshme zhvillimore

Sipas PZHK-së territori i komunës së Podujevës është ndarë në tri tërësi hapësinore si: Malet dhe Peisazhet, Natyra dhe Turizmi si dhe Qendra, të cilat dallohen nga aspekti i zhvillimit demografik, ekonomik, social, mjedisor, i infrastrukturës dhe shërbimeve.

2.4.1 Tërësitë hapësinore

Tërësia **Malet dhe Peisazhet** është e dominuar nga sipërfaqet e tokës bujqësore të punueshme e pyjore, livadhe dhe kullosa, të cilat së bashku krijojnë peizazhe tërheqëse. Potenciali zhvillimor janë: pylltaria, blegtoria, bletaria dhe turizmi. Tërësia përfshin 28 vendbanime rurale që janë nën administrimin e nën qendrës Kërpimeh dhe bashkësive lokale: Pollatë dhe Zhihi. Vendbanimet me më së shumti ndërtesa banimi janë Bradashi, Lupçi i Epërm dhe Majaci kurse më së paku Potoku, Përpelac dhe Reçica. Dendësinë më të madhe të popullsisë e kanë vendbanimet Pakashticë e Poshtme (47.1 b/ha), Bradash (35.8 b/ha) dhe Kërpimeh (34 b/ha), kurse më të ulët Përpelac dhe Reçicë të cilat janë vendbanime të pabanueshme dhe Potok me 4.3 b/ha. Me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore dhe pengimin e zgjerimit të vendbanimit në mënyrë të pa kontrolluar, PZHK rekomandon që zhvillimi/ndërtimi në të ardhmen të bëhet me Plotësim të hapësirave ndërmjet ndërtimeve ekzistuese dhe Dendësim. Sipas PZHK, në periudhën e ardhshme, nevoja më e madhe për sipërfaqe të reja për ndërtim është në vendbanimet: Bradash, Velikarekë, Dobratin, Revuq, Kërpimeh, Llaushë, Zakut, Metehi, Dobërdol dhe Buricë, kurse në vendbanimet tjera lejohet dendësimi ku objektet e reja të banimit do të lejohen në kuadër të parcelave ekzistuese.

Tërësia **Natyra dhe Turizmi** zhvillimi i së cilës drejtohet kah bujqësia, blegtoria, pylltaria. Është e dominuar kryesisht me pyje dhe kullosat, uji-liqeni, peizazhet natyrore atraktive për rekreacion dhe turizëm. Në këtë tërësi përfshihen 16 vendbanime rurale që janë nën administrimin e nën-qendrës Orllan dhe bashkësive lokale: Herticë, Bërvenik, dhe Batllavë. Vendbanimet me dendësinë më të madhe të popullsisë e




Figura 1 Tërësitë hapësinore sipas PZHK-së

kanë vendbanimet: Kusheica (54.5 b/ha), Rakinica (46.6 b/ha) dhe Batllava (35.1 b/ha), kurse më të ulët Muhazob-vendbanim i pabanueshëm, Surdull (1.5 b/ha) dhe Bllata (3.4 b/ha). Sipas PZHK, nevoja për sipërfaqe të reja për ndërtim paraqitet vetëm në Shajkovc dhe Batllavë kurse për vendbanimet tjera duhet të ketë Plotësim të hapësirave ndërmjet ndërtimeve ekzistuese dhe Dendësim.

Tërësia **Qendrore-Aktive** konsiderohet si zona që ka potencialin më të madh për një zhvillim më të hovshëm ekonomik në fushën e bujqësisë, industrisë, bizneseve, turizmit, shërbimet etj. Në këtë pjesë janë të koncentruara pjesa më e madhe e vendbanimeve, popullsisë, shërbimeve, komunikacionit etj. Zhvillimi i ardhshëm i kësaj zone duhet të orientohet drejtë avancimit veprimtarive ekonomike: bujqësia, industria, bizneset, shërbimet etj. Koncentrimi i madh i vendbanimeve, infrastrukturës dhe veprimtarive të shumta ekonomike në këtë zonë mund të përcillet me konfliktin e zënies së tokës bujqësore kualitative, prandaj kërkohet që zhvillimet dhe ndërtimet në të ardhmen të jenë në kontroll të plotë dhe ato të ndodhin sipas planit. Kjo tërësi përfshin pjesën rurale dhe vendbanimin urban-qtetin e Podujevës.

Tërësia aktive-rurale: përfshin 35 vendbanime rurale që janë nën administrimin e qendrës komunale të Podujevës dhe nën qendrës së Lluzhanit dhe bashkësive lokale: Dumnicë e Poshtëme, Shtedim, Sfeqël, Lupc i Poshtëm, Tërrenavë, Gllamnik, Llapashticë e Epërme, dhe Bajçinë. Në kuadër të kësaj tërësie, vendbanimet me dendësinë më të madhe të popullsisë janë: Shtedim (63.4 b/ha), Sibovc i Poshtëm (60.5 b/ha) dhe Surkish (55.6 b/ha), kurse më të ulët Radujevc vendbanim i pabanueshëm, Kunushec (4.5 b/ha) dhe Kalaticë (10.3 b/ha). Me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore dhe pengimin e zgjerimit të vendbanimit në mënyrë të pa kontrolluar, PZHK rekomandon që zhvillimi/ndërtimi në të ardhmen të bëhet me Plotësim të hapësirave ndërmjet ndërtimeve ekzistuese dhe Dendësim, sidomos në fshatrat Halabak dhe Tërrenavë mirëpo për shkak se kjo zonë është shumë aktive sa i përket zhvillimit, në të gjitha vendbanimet tjera PZHK ka përcaktuar sipërfaqe të reja për ndërtim; më së shumti në Obrancë, Llapashticë e Epërme dhe Gllamnik.


Tërësia **Aktive-pjesa urbane** është e ndarë në këto njësi urbane:

- Njësia urbane “Qendra 1”
- Njësitë urbane “Qendra 2: Veri, Lindje dhe Jug”
- Njësia Kopshti Lindor

Njësia e qendrës 1 dallohet me prezencën e objekteve publike, kulturore e tregtare, e mbuluar kryesisht me objekte banimi kolektiv. Ndërsa, njësitë tjera të zonës urbane, janë të dominuara kryesisht me banim të cilat e rrethojnë qendrën e qytetit.

Rrugët kryesore në drejtim të qendrës, si dhe disa rrugë anësore ndaj qendrës, dallohen me aktivitete tregtare. Zonat e banimit zhvillohen në të gjitha njësitë e zonës urbane, ndërsa zona industriale shtrihet në lindje të qytetit, buzë magjistrales Prishtinë-Merdar. Struktura urbane e Podujevës gradualisht është duke u ndryshuar si rezultat i zhvillimeve të cilat kanë ndodhur viteve të fundit. Përpos sipërfaqeve të banimit në pjesën urbane hynë sipërfaqet tjera të ndërtuara si, transporti, shërbimet, sipërfaqet e veçanta dhe sipërfaqet e gjelbra. Kufiri urban në qytetin e Podujevës përfshinë pjesërisht zonat kadastrale të Podujevës, Obrancës dhe Letancit. Hapësira qendrore urbane në komunën e Podujevës është e përcaktuar si hapësirë për ri-formatim dhe zhvillim. Këtu kryesisht parashihet të bëhet rigjenerim dhe rivitalizim urban, dhe dendësim i theksuar në njësitë qendrore të tij. Ky dendësim është planifikuar të bëhet në përputhje të plotë me dispozitat të cilat janë të përcaktuara me PZHK. Për të përmirësuar lëvizshmërinë brenda zonës urbane është paraparë edhe krijimi i rrjetit të ri të rrugëve të cilat do të ofronin lidhshmëri të mirë në mes të tërësive brenda zonës urbane, duke patur për prioritet transportin e pa motorizuar si dhe do të ofrohen mundësi për organizimin e transportit urban. Lëvizshmëria do të rregullohet me planin e mobilitetit.

Harta 1 Harta e kufirit të sipërfaqeve të ndërtuara



III. KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME

Rregullat e mëposhtme do të zbatohen për të gjitha shfrytëzimet, zhvillimet dhe ndërtesat në territorin e komunës, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me këtë HZK. Sipas përcaktimit ligjor të UA 24/2015, këto kushte mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, masat mbrojtëse, modelet e projektimit dhe udhëzimet mbi:

- shfrytëzimet e tokës (shfrytëzimet e lejuara, shfrytëzimet dytësore, të lejuara të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara);
- qasjen në parcelën kadastrale;
- qasjen në infrastrukturën teknike;
- rregullat për parkim dhe shkarkim;
- rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës;
- kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyrore dhe artificial;
- kërkesat dhe zvogëlimi i zhurmës etj.

3.1. Shfrytëzimet e tokës

Llojet e shfrytëzimit të tokës në HZK janë bazuar në PZHK dhe në trendet e zhvillimit gjatë periudhës pas aprovimit të PZHK-së. Ndarja në zona e territorit të komunës është bërë në përputhje me UA mbi NTPH, respektivisht sipas Sistemit Hierarkik të Shfrytëzimit të Tokës (HILUCS).

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për secilën zonë janë përcaktuar në bazë të ligjeve, akteve nënligjore përkatëse. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për të gjitha zonat janë:

- zhvillimet dhe ndërtimet nuk duhet të pengojnë dhe shkaktojnë ndikim negativ të zhvillimit apo ndërtimit fqinje;
- zhvillimet dhe ndërtimet duhet të respektojnë normat teknike të planifikimit hapësinor për mbrojtje të mjedisit dhe trashëgimisë natyrore e kulturore;
- zhvillimet dhe ndërtimet duhet të respektojnë normat teknike të planifikimit hapësinor për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore;
- zhvillimet dhe ndërtimet brenda shfrytëzimit të caktuar apo zonave nuk duhet të lejohen nëse nuk janë në përputhje me këtë HZK;
- raporti në mes hapësirës së shfrytëzuar dhe hapësirës së lirë në të gjitha zonat duhet të jetë në përputhje me NTPH.
- Veprimtaritë ekonomike duhet të plotësojnë të gjitha standardet e mbrojtjes së mjedisit;
- Hapësirat pranë zonave ekzistuese të banimit nuk mund të destinohen për industri e cila nuk i plotëson standardet;
- Hapësirat pranë zonave ekzistuese turistike nuk mund të destinohen për industri ndotëse përtej normave të lejuara;
- Hapësirat që destinohen për veprimtari tregtare–furnizim të popullatës me mallra të konsumit të përditshëm dhe të gjerë, duhet të jenë brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre;
- Zgjerimi i zonave ekzistuese të industrisë dhe biznesit do të lejohet vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për t'u alokuar;
- Të gjitha veprimtaritë publike duhet të plotësojnë edhe kërkesat për personat me aftësi të kufizuara fizike të parapara me norma dhe standarde ndërkombëtare;
- Ndalohet çfarëdo ndërtimi në sipërfaqet në të cilat HZK parasheh ndërtimin e rrugëve të reja automobilistike (autoudhëve, nacionale, regjionale dhe lokale) dhe në sipërfaqet e brezave mbrojtës të këtyre rrugëve.
- Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër autoudhët, rrugët nacionale, rrugët regjionale dhe ato lokale duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat e veçanta të nxjerra nga MI;
- Transportin publik të udhëtarëve mund ta realizojnë vetëm operatorët e licencuar të transportit. Licencimi bëhet nga Ministria e infrastrukturës;
- Në mënyrë që transporti i udhëtarëve të jetë sa më i sigurt, automjetet transportues duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet teknike të përcaktuara nga MMPHI;

- Për ndërtimin e sistemeve publik të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, duhet të merret leja nga MMPHI;
- Për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe të kolektorëve që mbledhin këto ujëra, duhet të merret leja nga MMPHI;
- Operatori i telefonisë mobile nuk mund të fillojë veprimtarinë e vet (fillimisht vendosja e antenave dhe pastaj shërbimet e telefonisë) pa pasur licencën për këtë, të cilën e lëshon ARKEP;
- Përveç licencës që merret nga ARKEP, për vendosjen e antenave në terren, operatori i telefonisë mobile duhet të marrë edhe pëlqimin mjedisor nga MMPHI;
- Nuk lejohet vendosja e antenave në rezervatet strikte të natyrës;

3.1.1 Shfrytëzimet e lejuara

- Zhvillimet dhe ndërtimet e lejuara brenda një shfrytëzimi, zone apo parcele janë parësore;
- Në zonën bujqësore të klasit 1–4 nuk lejohen zhvillime dhe ndërtime tjera përpos atyre që janë në shërbim të bujqësisë.

3.1.2 Shfrytëzimet dytësore

Në zonat përkatëse lejohet vetëm zhvillimi i shfrytëzimeve dytësore të përcaktuara me PZHK dhe HZK.

- Shfrytëzimet dytësore nuk duhet të themelohen para zhvillimit të shfrytëzimit të ndërtesës ose strukturës kryesore, të cilës i shërben ose ndaj së cilës është vartëse;
- Shfrytëzimet dytësore nuk do të vazhdojnë të ekzistojnë pasi shfrytëzimi, objekti apo struktura kryesore të cilës i shërben, ose ndaj të cilës është vartëse, të jetë ndërprerë së ekzistuar.

3.1.3 Shfrytëzimet dhe strukturat e përkohshme

- Do të lejohen ndërtimi apo instalimi i strukturave të përkohshme vetëm nëse pronari apo investitori posedon certifikatën për përdorim apo lejen e ndërtimit;
- Shfrytëzimet e përkohshme si panairë, koncerte, ekspozita, do të lejohen vetëm në hapësira ku nuk pengojnë lëvizshmërinë e këmbësorëve dhe automjeteve;
- Strukturat e shfrytëzimit të përkohshëm nuk duhet penguar vizurat përreth hapësirës;
- Kohëzgjatja e qëndrimit të strukturave të përkohshme caktohet nga autoriteti përgjegjës komunal;
- Të gjitha pajisjet, materialet, ndriçimi, shtyllat, strukturat si dhe elementet tjera të përkohshme duhet të largohen dy ditë pas përfundimit të lejes së shfrytëzimit. Në rastet kur pronari apo investitori nuk i largon atëherë autoriteti komunal / inspektori ka të drejtë që të urdhërojë pronarin apo investitorin të largojë apo rrënojë ndërtesën, strukturën apo pajisjet përkohshme dhe nëse nuk respektohet urdhëresa atëherë do të ketë të drejtë t'a rrënojë atë.

3.1.4 Shfrytëzimet dhe strukturat e veçanta

- Në të gjitha zonat lejohen vetëm shfrytëzimet dhe strukturat e veçanta të definuara me HZK;
- Zhvillimi i shfrytëzimeve të veçanta në zonat përkatëse si shërbimet (autolarjet, restorantet, kafeteritë, diskotekat, lojërave të fatit, etj.), impiantet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, objektet për trajtimin dhe reciklimin e mbeturinave, depove për mbeturina, instalimi i trafostacioneve dhe shtyllave të telekomunikacionit lejohen vetëm kur ndërmerren kushte dhe masa plotësuese të përcaktuara me ligjet përkatëse për zbutjen apo pengimin e shqetësimeve që do të mund t'i shkaktojnë mjedisit dhe banorëve në zonën përkatëse dhe përreth.

3.1.5 Shfrytëzimet e ndaluara

- Nuk lejohet zhvillimi i atyre shfrytëzimeve në zona nëse nuk janë paraparë me PZHK dhe HZK;
- Nuk lejohen shfrytëzimet jo bujqësore/blegtorale në tokën bujqësore të kategorisë I-IV.
- Nuk do të lejohen zhvillime/ndërtime në tokën kualitative bujqësore jashtë kufirit ndërtimor dhe në mos-përputhje me ligjet respektive ndërsa ndërtimet ekzistuese do të trajtohen si jokonformitet.
- Ndalohet parcializimi i tokës bujqësore;
- Prerja e pakontrolluar e pyjeve për nevoja të përpunimit është e ndaluar;
- Nuk lejohet zhvillimi i atyre shfrytëzimeve dhe aktiviteteve të cilat do të kenë ndikim negativ në mjedis, dhe trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

3.2. Qasja në parcelën kadastrale

- Para fillimit të një zhvillimi/ndërtimi duhet të sigurohet qasje adekuate në parcelën kadastrale;
- Parcela kadastrale duhet të ketë mundësi hyrjeje e daljeje të drejtpërdrejte më së paku nga një rrugë publike ose private ose nga një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Rrugët duhet të sigurojnë qasjen e lehtë të automjeteve private, makinerive gjatë ndërtimit dhe të zjarrfikësve;
- Zhvillimet/ndërtimet e reja në parcelën kadastrale duhet të sigurojnë qasjen në rrugë publike me mjet transporti të motorizuar dhe jo të motorizuar apo në këmbë të pronarit apo shfrytëzuesit të parcelës kadastrale fqinje;

3.3. Qasja në infrastrukturën teknike

- HZK zbatohet dhe interpretohet ashtu që të mos pengojë zhvillimin dhe ndërtimin, ngritjen ose shfrytëzimin e pajisjeve dhe rrjetit të shërbimeve publike;
- Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim (rryma, sistemi i kanalizimit dhe i ujësjellësit);
- Zhvillimi i infrastrukturës duhet ofruar gradualisht bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës;
- Në të ardhmen nuk do të lejohet furnizimi me ujë të pijshëm nga pusët individuale;
- Në të ardhmen nuk do të lejohet shkarkimi i ujërave të zeza në sistem individual të gropave septike;
- Nëse një parcelë kadastrale ka mundësi të lidhet me shërbimet publike, si ujësjellës dhe kanalizim, në atë parcelë nuk lejohet të ndërtohet asnjë ndërtim apo strukturë, nëse e njëjta nuk lidhet me shërbimin publik në dispozicion;
- Nevojat për ujë të pijshëm dhe amvisëri, mirëmbajtje të hapësirave publike, si dhe kushtet për përzgjedhjen e lokacionit adekuat përcaktohen në përputhje me UA mbi NTPH;
- Përzgjedhja e lokacionit për ndërtesat ose pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza duhet të bëhet në përputhje me UA mbi NTPH;
- Përzgjedhja e lokacionit për vendosjen e linjave mbitokësore dhe nëntokësore të energjisë elektrike duhet të bëhen në përputhje me UA mbi NTPH;
- Përcaktimi i vëllimit dhe kapacitetit të deponive/stacioneve për transferim, si dhe kushtet për përcaktimin e lokacionit për deponi/stacion transferi duhet të jenë në përputhje me UA mbi NTPH dhe aktet respektive;
- Të gjitha zhvillimet apo ndërtimet duhet të lidhen me rrjetet infrastrukturore të ujit të pijshëm, kanalizimit, ujërave atmosferik, energjisë elektrike, rrjetit të teknologjisë informative, si dhe rrjetit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave;
- Rrjetet publike të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike;
- Shërbimet publike për zhvillimet e planifikuara brenda zonës së lejuar të ndërtimit si: ujësjellësi, kanalizimi, energjia elektrike dhe rrjeti i teknologjisë informative, rrjeti i grumbullimit të mbeturinave, duhet të ofrohen për të gjithë banorët e komunës, pa ndonjë diskriminim.

3.4. Rregullat për parkim dhe shkarkim

Vend-parkimet për automjete mund të akomodohen në vend-parkime të rregulluara, rrugë e garazhe.

Kemi katër lloje themelore të parkimit e që janë:

- vend-parkim rrugor;
- vend-parkim jashtë-rrugor publik,;
- vend-parkim jashtë-rrugor privat;
- vend-parkim jashtë-rrugor privat për banor.

Kërkohet që vend parkimet të dimensionohen sipas normave të përcaktuara me UA mbi NTPH, shih tabelën më poshtë.

Tabela 3 Numri i vend-parkimeve për automjete varësisht nga lloji i shfrytëzimit

Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja			
Përmbajtja	Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes se ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) apo vendeve për garazhin për 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN)	
Banimi	Ndërtesat e banimit të mesëm dhe të lartë/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës se banimit	Nga numri i obligueshëm i VP, së paku 20% duhet të jetë për shfrytëzim publik, ndërsa gjatë hartimit të planeve operative, për pjesë të pa

			ndërtuara, të planifikohen edhe se paku 10% për shfrytëzim publik
	Ndërtesat e banimit të ulët/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo me pak se numri i njëjësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit	Gjatë hartimit të planeve operative për pjesë të pa ndërtuara, domosdoshmërisht të planifikohet edhe 1 VP/ 1 ndërtesë të banimit të ulët
	Ndërtesat e banimit të ulët- vilat (deri në 4 njësi maksimale)	3 VP/ njësi banimi	-
Hoteleria dhe turizmi	Ndërtesat e hoteleve deri në 3*	0.2 VP një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 4*	0.5 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 5*	0.75VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e restoranteve, kafeneve dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	4 VP në 100 m ²	-
Tregtia dhe përmbajtjet komunale	Ndërtesa e tregtisë	4 VP / 100 m ² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesa/ hapësirat e tregjeve	3 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesat e depove	1 VP/ 100 m ²	-
Biznes publik	Ndërtesat e bizneseve	4 VP/100 m ²	Për sipërfaqe më të vogla se 100 m ² , të sigurohen se paku 2 VP
	Ndërtesat administrative (publike)	2 VP/ 100 m ²	-
Industria dhe zanatet	Ndërtesat e industrive	1 VP / 100 m ²	
	Ndërtesat e zanateve	2 VP/ 100 m ²	-
Kultura dhe arsimit	Ndërtesat e kopshteve/cerdheve të fëmijëve	1 VP / 100 m ²	-
	Ndërtesat e shkollave fillore	0.5 VP/ 100 m ²	Për ndërtesat e sallave të sporteve në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës.
	Ndërtesat e shkollave të mesme	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e fakulteteve dhe instituteve	1 VP/ 100 m ²	Për sipërfaqet e komplekseve, nr. i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta, përkatësisht me plane operative.
	Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat religjioze- xhamitë, kishat, etj	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e muzeve, galerive dhe bibliotekave	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat/ sallat e kongreseve	1 VP/ 100 m ²	-
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Ndërtesat e spitaleve, klinikave, qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit	3 VP / 100 m ²	Numri i VP duhet të jetë jo më i vogël se numri i ambulancave
	Shtëpitë për të moshuar	0.5 VP/ 100 m ²	-
Sporti dhe rekreacioni	Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmijë)	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
	Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
	Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
Terminalet udhëtareve	Ndërtesat e terminaleve të autobusëve	-	Për ndërtesat e terminaleve duhet të hartohet projekti i teknik i trafikut, me kalkulimin e numrit të VP, në veçanti për: Vendqëndrimet (ngarkim/ shkarkim); parkim afat-shkurtë; parkim afat-gjatë
	Ndërtesat e terminaleve të trenit	-	
	Ndërtesat e terminaleve të aeroportëve	-	

- Hapësira për parkim/garazhim të automjeteve për nevoja personale duhet të parashihet në kuadër të parcelës ndërtimore të destinuar për banim individual. Gjerësia e hyrjes private në parcelën ndërtimore pa qasje direkte në rrugën publike nuk mund të jetë më pak se 2.5m’;
- Në objektet tjera, hapësira për parkimin/garazhim të veturave për pronarët/personelin të parashihet në kuadër të parcelës ndërtimore dhe jo në sipërfaqen publike të rrugës. Llogaritjet duhet të jenë të tilla që së paku 1/3 e veturave të jetë e vendosur në garazhë apo të kenë të siguruar vend-parkim në kuadër të parcelës. Kurse hapësira e parkingut për konsumatorët/qytetarët etj përcaktohet sipas normativave të përcaktuara varësisht nga lloji i objektit;
- Largësia nga vend parkimi i fundit deri te hyrja e ndërtesës duhet të jetë jo më shumë se 100m;
- Duhet të planifikohen vend-parkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në automjete transportuese të veçanta, dhe ndalesat për parkim të transportit publik duhet të jenë 2m’, sipas UA mbi NTPH;
- Gjerësia e shtegut për këmbësorë duhet të jetë me gjerësi së paku 1.8m, por nëse nuk është e mundur mund të jetë dhe 1.5m’, ashtu që të mundësohet lëvizja e papenguar të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa gjerësia e kalimeve ndërmjet pengesave fikse duhet të jetë të paktën 0.9m’, sipas UA mbi NTPH;
- Pjerrësia e rampave për persona me aftësi të kufizuara nuk duhet të jetë më e madhe se 5%, por nëse nuk është e mundur mund të jetë dhe 8%, sipas UA mbi NTPH;
- Dimensionet e vend-parkimit për biçikleta duhet të jenë 1.20 m²/biçikletë, sipas UA mbi NTPH;
- Sipas UA mbi NTPH numri i vend-parkingjeve për biçikleta sipas përmbajtjes së ndërtesave është prezantuar në tabelën më poshtë:

Tabela 4 Numri i vend-parkimeve për biçikleta në varësi nga përmbajtja

Përmbajtja/ Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes se ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta (VPB)
Përmbajtjet tregtare dhe komunale	5 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet e bizneseve dhe publike	1 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për të punësuar
Përmbajtjet arsimore	1 VPB/ 5 nxënës, për vizitor + 1 VPB/ 10 të punësuar
Përmbajtjet kulturore- teatro dhe muze	10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor
Përmbajtjet shëndetësore- spitale	10 VPB/ 100 shtretër, për vizitor
Përmbajtjet sportive dhe rekreative	10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor

- Aty ku është e mundur duhet të planifikohet brezi mbrojtës ndërmjet korsive të rrugës dhe shtigjeve për këmbësorë apo biçikleta;
- Kërkohe që në shfrytëzimet dhe ndërtesat për industri dhe aktivitete komerciale të parashihet hapësira për ngarkim dhe shkarkim e të mirave, pajisjeve, materialeve, etj., e cila nuk duhet të jetë para ndërtesave dhe rrugës publike;
- Ndalesat për parkim të transportit publik duhet të jenë 2m të gjera.

3.5. Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës

Peizazhi paraqet pjesë e territorit me karakteristika të veçanta të relievit, formuar nga një kompleks ekosistemesh të integruar në mënyrë funksionale, përfshirë edhe elementet e qytetërimit;²

Larmia peizazhore nënkupton një territor me karakteristika të veçanta të relievit, formuar nga një kompleks ekosistemesh të integruar në mënyrë funksionale përfshirë edhe elementet e qytetërimit. Rregullimi i larmisë peizazhore në tërësi, duhet të harmonizohet me regjimet, kushtet dhe masat e mbrojtjes të përcaktuara me vendimet përkatëse për vendosjen në mbrojtje, si dhe me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e natyrës 03/L-233 dhe aktet nënligjore të nxjerrura prej tij. Ligji për mbrojtjen e natyrës vazhdimisht harmonizohet me direktivat relevante për natyrën dhe Acquisin mjedisor e posaçërisht me Direktivën e Vendbanimeve natyrore 92/43 EEC, Direktivën e zogjve të egër 79/409 EEC, Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES).

Kushtet dhe masat për mbrojtjen, rregullimin dhe zhvillimin e *peizazheve natyrore* duhet të sigurojnë:

- përdorimin racional të burimeve natyrore
- funksionimin e papenguar të proceseve natyrore,
- mbrojtjen e biodiversitetit dhe llojllojshmërisë
- revitalizimin dhe rehabilitimin e peizazhit në harmoni me regjimin e mbrojtjes

² Ligji për mbrojtjen e natyrës 03/L-233

- valorizimin dhe prezantimin e vlerave natyrore dhe estetike
- ruajtjen dhe avancimin e:
 - Strukturës dhe pamjes karakteristike e peizazheve rurale dhe urbane
 - Traditës së ndërtimit dhe specifikave të strukturës fizike
 - Përshtatjes së elementeve natyrore dhe atyre të ndërtuara
 - Identitetit arkitektonik të vendbanimit
 - Hapësirat e hapura publike kualitative
 - Hapësirat e gjelbra dhe elementet natyrore
- ndërhyrjen dhe ndikimin minimal të veprimeve në peizazh (gjatë ndërtimit të objekteve të përhershme , infrastrukturës rrugore, instalimeve energjetike etj.)
- shmangjen e dëmtimit të përhershëm të sistemeve natyrore dhe shkatërrimin e pjesëve me vlerë të peizazheve gjatë hulumtimit dhe eksploatimit të lëndëve të para, gërmimeve dhe argjinaturave
- Në rast të dëmtimit të pashmangshëm të natyrës dhe peizazheve të bëhet iniciimi i suksesionit natyror, rinaturalizimi, rregullimi miqësor ndaj natyrës, ripërdorimi ose rekultivimi i tyre;
- Në zonat rurale është e rëndësishme ruajtja e peizazhit bujqësor:
 - Për ta ruajtur larminë biologjike dhe peizazhore të tokave të punueshme duhet ruajtur skajet e vlefshme të vendbanimeve të rrezikuara: gardhiqet, trungjet individuale, grupet e trungjeve, moçalet dhe skajet e livadheve.
 - Gjatë planifikimit të zgjerimit të tokës bujqësore, duhet që në masë sa më të madhe të ruhen vendbanimet ekzistuese ose të krijohen vendbanime të reja në përputhje me dispozitat e ligjit respektiv si dhe të planifikohet vendosja dhe madhësia në mënyrën e cila do të sigurojë vlerat më të mëdha të vendbanimeve për larminë biologjike dhe peizazhore³.
- Në zonën urbane, fokusi duhet të jetë në menaxhimin e zhvillimit dhe interesave konfliktuoze që do të rrezikojnë kontinuitetin ekzistues të peizazhit, që nënkupton se:
 - duhet të mbrohet lidhja e qytetit me peizazhet përreth (ruajtja e vizurave kah peizazhet)
 - lidhshmëria ekzistuese e peizazheve duhet të ruhet dhe përmirësohet përmes lidhjes së trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore dhe zonave peri-urbane me ato rurale
 - duhet të krijohet një sistem i hapësirave të lira të cilat integrojnë funksione të ndryshme publike: brezat e gjelbër mbrojtës, parqet, sipërfaqet për lojë dhe pushim, zonat rekreative, ujë rrjedhat dhe kolektorët e ujit atmosferik, bujqësinë urbane, etj.
 - Peizazhet duhet të ruhen në aspekt të strukturës dhe elementeve karakteristike të cilat varësisht nga përshtatshmëria dhe vendndodhja e tyre shërbejnë për rekreacion aktiv apo pasiv të popullsisë. Sipërfaqet e përshtatshme për këtë qëllim duhet të mbrohen dhe, kur është e nevojshme, të mirëmbahen, rregullohen dhe bëhen të qasshme.
 - Duhet të ruhen dhe valorizohen habitatet ekzistuese natyrore si: dru-radhitjet, “gardhet e gjalla”, kopshtet botanike, ujë-rrjedhat, etj., si dhe të gjitha strukturat e vogla që kanë rëndësi ekologjike.
- Peizazhi duhet të mirëmbahet nga pronari i pronës dhe çdo dru, bimë dekoruese që vyshket apo dëmtohet duhet të zëvendësohet nga ai.
- Peizazhi i hapësirave para ndërtesave publike e private dhe i rrugëve duhet të ruaj karakterin e zonës në të cilën ndodhen;
- Zhvillimet e ardhshme nuk duhet të shkatërrojnë vlerat natyrore, të peizazheve, mjedisit dhe as veçoritë autoktone të komunës.

Hapësirat e gjelbra dhe shiriti i gjelbër mbrojtës:

- Çdo pjesë të një parcele apo zone me shfrytëzim të përzier, komercial, industrial, teknologjik, për shërbime publike ose banim, që nuk përdoret për ndërtim, rrugë publike, ngarkim dhe parkim, si dhe hapësira të caktuara të magazinimit, duhet të jetë hapësirë e gjelbër e cila duhet të mirëmbahet nga pronari;
- Lokacionet për mbjelljen e drunjëve mund të jenë ose të mos jenë ndërmjet vijës rregulluese dhe skajit të rrugës, në varësi të rrethanave të vendit. Nëse drunjët nuk janë të vendosur ndërmjet vijës rregulluese dhe

³ Ligji për mbrojtjen e natyrës 03/L-233 (GZRK Nr.85/09.11.2010)


skajit së rrugës, ato vendosen brenda parcelës menjëherë pranë vijës rregulluese, apo përgjatë vijës aksiale qarkulluese të rrugëve publike;


- Brezat e gjelbër dhe tampon zonat duhet të parashihen në zonat apo ndërtesat industriale, komerciale, shërbimeve publike, tregtare. Parametrat normativ janë dhënë në kuadër të kushteve respektive të zonës;
- Kërkohe mbjellja e drunjëve dhe bimëve dekoruese në hapësirat e hapura në vendbanime;
- Kërkohe që hapësirat publike të dizajnohen ashtu që të jenë të sigurta dhe lehtë të qasshme për banorët e zonës dhe vizitorët;
- Kërkohe që hapësirat publike të përdoren për aktivitete që janë atraktive për të gjitha moshat;
- Kërkohe që për elementet e hapësirave publike të përdoren materialet vendase-rrethore;
- Gjatë trajtimit të parqeve të qytetit nuk duhet të parashihet pllakosje më shumë se 10% e sipërfaqes së përgjithshme të parkut. Duhet analizuar me kujdes kushtet mikro – klimatike;

3.6. Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial

Sa i përket kushteve për ndriçim ato janë përcaktuar me UA mbi NTPH, e që janë:

- Të sigurohet diellosje maksimale dhe mbrojtje nga erërat e forta gjatë përzgjedhjes së lokacioneve për vendosjen e objekteve në veçanti atyre të banimit, infrastrukturës sociale e publike;
- Të sigurohet arritja e rregullit 45° në zonat me densitet të mesëm dhe të lartë të zhvillimit, ose ndërmjet dy zonave me densitet të ndryshëm të zhvillimit. Përmes rregullit 45° kontrollohet hijezimi i strukturave dhe pronave fqinje. Për përcaktimin e lartësisë së ndërtesave në raport me kufinj të parcelës, në rast se pjerrësia e parcelës kadastrale është 8% ose më pjerrët, lartësia e specifikuar (L) kontrollohet me rrafshin 45° të ndriçimit natyror.
- Për të siguruar nivelin adekuat të ndriçimit natyror të ndërtesave ekzistuese në rastet kur ato janë përballë me strukturat e reja, duhet të respektohen rregullat lidhur me raportin e distancës dhe lartësisë së objekteve të përcaktuara në UA 08/2017 për NTPH (Kapitulli I, nën-seksionet 4, 5 dhe 6). Në këtë rast rekomandohet aplikimi i "rregullit 25 shkallë". Sipas këtij rregulli, nga një vijë referente në lartësi prej 2m (qendra/mesi i dritares së një kthine të banimit në katin përdhese të ndërtesës ekzistuese) tërhiqet një vijë imagjinare në këndin vertikal prej 25 shkallë në drejtim të strukturës së re të propozuar për ndërtim. Vëllimi i strukturës së re të propozuar nuk duhet të kalojë vijën e këndit 25 shkallë. Në rastet kur kemi të bëjmë me terren të pjerrtë, hijezimi është më i madh kështu që nevojitet distancë më e madhe ndërmjet ndërtesave.
- Strukturat e renditura më poshtë mund të ndërhyjnë përmes rrafshit 45 shkallë të ndriçimit natyror:
 - o Oxaqet, boshtet e ventilimit, boshtet e ashensorëve, boshtet e shkallëve, dhe rezervuarët e ujit në çati me kusht që dimensionin maksimal nuk tejkalojnë 1m², dhe me kusht që distanca minimale ndërmjet secilës prej këtyre strukturave është 20m, dhe me kusht që këto struktura nuk tejkalojnë muret e jashtme të ndërtesës ku janë vendosur;
 - o Kulmet e pjerrëta kur prekin rrafshin e tërhequr jo më poshtë se në gjysmë ndërmjet strehëve dhe vijës kurrizore të kulmit, atëherë pjesët e larta të kulmeve të tilla të ndërhyjnë në rrafshin e tërhequr.





- Ndërtesat e reja dhe rindërtimet duhet të sigurojnë përdorimin e ajrosjes natyrale dhe ndriçimit natyror si burim kryesor i dritës. Kushtet e veçanta varësisht nga lloji i objektit jipen në seksionet respektive;
- Për planifikimin e distancave ndërmjet ndërtesave, kriteri për diellosje është $\geq 2h$ diellosje gjatë ditës për kthina të banimit më datë 21 dhjetor. Ky kriter njëkohësisht plotëson edhe kriteret për ndriçim natyror dhe privatësi;
- Në mënyrë që banorëve t’ju ofrohet siguri gjatë lëvizjes të gjitha rrugët dhe lagjet në qendër, nën-qendra dhe në vendbanimet rurale duhet të ndriçohen me ndriçim artificial.

Ndriçimi artificial

- Ndriçimi i hapësirave publike (rrugë, shtigje, rrugëkalime, parqe, parkingje, etj.) është i një rëndësie të veçantë për sigurinë e hapësirës publike. Përdorimi i duhur i ndriçimit në një hapësirë publike duhet të siguron:
 - o përmirësimin lexueshmërinë e vendeve kyçe, shenjave dhe reperëve, komunikimeve dhe hapësirave për aktivitete të ndryshme në hapësirën publike;
 - o lëvizje më të sigurt të këmbësorëve dhe automjeteve, përmirësimin e sigurisë dhe zvogëlimin e situatave të mundshme që mund të rrezikojnë përdoruesit ose pronën në zonë;
 - o rigjallërim të hapësirave publike më pak të përdorura dhe inkurajon përdorimin e hapësirës publike gjatë natës.
- Përzgjedhja e llojit dhe intensitetit të ndriçimit duhet të përshtatet me karakterin e mjedisit lokal. Efektet e dëmshme të shpërndarjes së tepërt dritës dhe "ndotjes nga ndriçimi" në eko-sistemet ekzistuese në rastin e zonave të gjelbëra dhe parqeve, banorët ose shoferët duhet zvogëluar në minimum.
- Shtyllat e ndriçimit duhet të vendosen brenda korridoreve të rrugës në atë mënyrë që të sigurojnë ndriçim të plotë të të gjitha zonave të trafikut në të gjitha kushtet e motit. Distanca minimale e shtyllave nga cepi i skajshëm i profilit tërthor të rrugës është 0.50m.
- Furnizimi i shtyllave me energji bëhet nga kabllo të nëntokësore të tensionit të ulët dhe rekomandohet që menaxhimi i ndriçimit të planifikohet në mënyrë qendrore, me sistem automatik të fikjes/ndezjes së çdo të dytit ndriçues dhe mundësinë e zvogëlimit të intensitetit të ndriçimit me 50% në periudha të caktuara gjatë natës (ndërmjet 01 - 04 h).
- Rekomandohet përdorimi i burimeve të dritës LED pasi ato kanë një rezistencë të lartë ndaj dridhjeve, goditjeve mekanike dhe lagështisë, si dhe jetë më të gjatë në raport me burimet klasike të dritës.

3.7. Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës

Sipas UA mbi NTPH kushtet për zvogëlim të zhurmës janë:

- të gjitha zhvillimet /ndërtimet e ardhshme në zona duhet të planifikohen, dizajnohen dhe të operojnë në mënyrë që të mos prodhojnë zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Tabela 5 Vlerat kufitare të burimit të zhurmës varësisht nga lloji i trafikut

Vlerat kufitare të burimit të zhurmës (dBA)	Trafiku Rrugor		Trafiku hekurudhor	
	Ditën Ld	Natën Ln	Ditën Ld	Natën Ln
Zonat industriale	69	59	68	58
Zonat rurale	64	54	65	53
Zonat mikse	64	54	65	53
Zonat e banimit dhe vendbanimet e vogla	59	49	57	48

Institucionet publike dhe sociale	57	47	54	45
-----------------------------------	----	----	----	----

- ndalohet kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera, në mënyrë që me zhurmë pengohet qetësia dhe pushimi i njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga ora 22:00– 07:00;
- në vendbanime lejohet dëgjimi i zërit të zileve ose pajisjeve elektroakustike nga ora 07:00–22:00, përjashtim bën zërimi i zilës ose pajisjeve elektroakustike, në kohën e riteve fetare dhe në festa;
- për zvogëlimin e efekteve të zhurmës nga rrugët me trafik më të ngarkuar në dy anët e rrugës të përdoren rende drunjësh, ndërsa tek vendbanimet përgjatë rrugëve regjionale me rend të dyfishtë;
- kërkesa specifike për mbrojtjen nga ndotja e zhurmës, rrjedhin nga ligji për mbrojtje nga zhurma me aktet përcjellëse dhe dokumente respektive komunale si p.sh. harta strategjike e zhurmës nëse ka, plani lokal për veprim në mjedis.

3.8. Kërkesat për efizienz të energjisë








Autoriteti komunal përgjegjës për planifikim duhet të sigurojë që objektet e reja si dhe ato që rinovohen apo rindërtohen, të plotësojnë kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave sipas rregullores në fuqi: Rregullore për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave dhe Planit Lokal Komunal për efizienz të energjisë. Kushtet e përgjithshme të ndërtimit të cilat sigurojnë zvogëlimin e shpenzimit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë të cilat do të mund të përdoren për ngrohje, ftohje dhe ventilimin e objektit. Kushtet e ndërtimit që ndërlidhen me efizienz të energjisë dhe qëndrueshmërinë e objektit përbajnë dy aspekte: zgjidhjen arkitektonike, konceptin e formësimit dhe materializimin e objektit, gjeometrinë solare, përshtatshmërinë e objektit me kushtet klimatike, zvogëlimin e humbjeve në rrjetin energjetik si dhe elemente tjera të fushës së planifikimit.

3.9. Formësimi arkitektonik

Formësimi arkitektonik nënkupton dukjen e jashtme të objektit, formën e kulmit, materialet e përdorura, ngjyrat dhe elementet tjera. Kushtet zhvillimore të përgjithshme për formësimin arkitektonik të aplikueshme për të gjitha ndërtesat janë:

- dizajni i ndërtesës duhet të demonstrojë përdorim të qëndrueshëm të ngjyrave, materialeve dhe detajeve në të gjitha lartësitë e ndërtesës;
- të gjitha lartësitë që përballen me një rrugë publike, duhet të projektohen për pamje publike dhe nuk duhet të injorohen, ose të marrin vetëm trajtim minimal arkitektonik;
- ndërtesat dytësore duhet të jenë konsistente me formësimin arkitektonik të jashtëm të atyre primare;
- fasadat e ndërtesave përgjatë rrugëve publike, nuk duhet të përmbajnë sipërfaqe të mureve pa hapje primare, që tejkalojnë 10m' gjatësi. Fasadat e ndërtesave që janë prej 40m ose më shumë gjatësi, do të përfshijnë një model arkitektonik të përsëritur me dy ose më shumë elemente të mëposhtme, si ndryshimi i ngjyrës, strukturës, materialit ose ndryshimi, zbulimi, ndërprerja ose menjanimi i shtyllave;
- fasada e ndërtesave duhet të ketë ngjyrë të nuancave të lehta; e preferueshme përdorimi i ngjyrave pastele, sipas paletës prezantuar në figurën e mëposhtme ose të ngjashme. Nuk lejohet përdorimi i ngjyrave që tërheqin vëmendjen dhe ngjyrave bazë: intensive (të papërziera me ngjyrat tjera apo shkallë të hirtë) ose të zbutura-akuarele (ngjyra bazë e zbutur me ngjyrën e bardhë).

Ngjyra Pastele shifra RGB

						
61,120,125	151,177,176	84, 53, 81	155,99,76	242,223,180	192,109,105	201,208,174

- materialet e jashtme duhet të jenë shumë të qëndrueshme dhe që lejojnë mirëmbajtje të lehtë;
- materializimi i sipërfaqeve dhe kulmeve që prodhojnë shkëlqim verbues janë të ndaluara, me përjashtim të paneleve diellore të cilat synojnë të rrezatojnë energji diellore të absorbuar ose të pa-pasqyruar dhe të zvogëlojnë akumulimin e nxehtësisë në ndërtesë.
- të gjitha pajisjet mekanike të montuara në kulm ose tokë, do të shfaqen nga pamja deri në masë të mundshme praktike. Matësit dhe pajisjet tjera të shërbimeve publike dhe pajisjet duhet të vendosen në vende që nuk janë të dukshme nga rruga publike¹;
- materialet e përdorura duhet t'i përshtaten strukturës dhe karakterit të objektit, të përdoren aq sa është e mundur materiale që konsiderohen miqësore ndaj natyrës dhe përdoren elemente ndërtimi që janë karakteristike për zonën¹;
- objektet e planifikuara përveç që së bashku duhet të paraqesin kompozicion arkitektonik, duhet që edhe si të veçanta, me volumin e tyre, proporcionet dhe destinimin të paraqiten si tërësi arkitektonike;

- forma dhe përzgjedhja e materialeve duhet të përshtaten me përmbajtjen e objektit, siluetën e rrugës, konfiguracionin e terrenit dhe në përgjithësi lokacionit më të gjerë;
- kërkesa specifike të formësimit arkitektonik (fasadat, ngjyrat, kulmet) për objektet në zonat e banimit dhe zonat e përziera përcaktohen në seksionet e zonave përkatëse;
- për objektet me vlera të trashëgimisë kulturore dhe historike si dhe objektet që mund të ndërtohen në zonat natyrore të mbrojtura (monumentet e natyrës) si dhe objektet që ndërtohen në zonat me interes të veçantë dhe ato të sigurisë shtetërore e civile aplikohen rregulla të veçanta në përputhje me ligjet respektive.

3.10. Kërkesat për zhvillimet apo ndërtimet në afërsi të zonave me rëndësi të veçantë

Distanca e zhvillimeve apo ndërtimeve të planifikuara nga zonat në afërsi të resurseve ujore duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës përkatëse;

Distanca e zhvillimeve apo ndërtimeve të planifikuara nga monumentet e natyrës duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës përkatëse në fuqi;

- Distanca e zhvillimeve apo ndërtimeve të planifikuara nga zonat në afërsi të resurseve ujore duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA 08/2017, ligjet dhe aktet nënligjore të fushës përkatëse në fuqi;
- Distanca e zhvillimeve apo ndërtimeve të planifikuara nga monumentet e natyrës duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA 08/2017 ligjet dhe aktet nënligjore të fushës përkatëse në fuqi;
- Distanca e zhvillimeve apo ndërtimeve të planifikuara nga monumentet e trashëgimisë kulturore duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA 08/2017, ligjet dhe aktet nënligjore të fushës përkatëse në fuqi;
- Zhvillimet apo ndërtimet në afërsi të ndërtesave të sigurisë shtetërore duhet të zhvillohen në përputhje me ligjet në fuqi .

3.11. Masat për mbrojtjen e mjedisit

- Për të shmangur ndotjen dhe degradimin e mjedisit për çdo zhvillim industrial ekzistues apo që është planifikuar me HZK duhet të ndërmerren masa të përcaktuara me ligjin për mbrojtje të mjedisit dhe aktet nënligjore, ku njëra nga masat e domosdoshme është edhe hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM);
- Për mbrojtjen e popullsisë në rast të fatkeqësive natyrore dhe tjera si evakuimi dhe strehimi, qeveria qendrore dhe lokale duhet të ndërmarrin masat e kërkuara sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
- Për mbrojtjen nga zjarri, vërshimet, erozioni, tërmetet, radiologjike, kimike dhe biologjike pronari apo shfrytëzuesi i ndërtesës duhet të ndërmarrë masat e kërkuara sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
- Për mbrojtje nga fragmentimi i tokës duhet të respektohen masat të bazuara në NTPHsi:
 - toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela;
 - toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e së cilës është ≤ 0.5 ha, të mos mund të fragmentohet tutje.
- Mbrojtja e tokës pyjore duhet të bëhet në përputhje me UA 08/2017, si në vijim:
 - për mbrojtje nga shpyllëzimi duhet të bëhet prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas toka të përdoret për shfrytëzime tjera jo pyjore;
 - mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll;
 - mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në forme të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës).

3.12. Kërkesat për sigurim të qasjes së personave me aftësi të kufizuara

Hapësirat publike, ndërtesat publike dhe ato të banimit shumë banesor me funksione tjera në pajtueshmëri duhet të plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara me UA për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar për të siguruar qasje të lehtë për persona me aftësi të kufizuara.

IV. LISTA E ZONAVE

Ndarja e territorit në zona/nënzona është bërë në përputhje me rekomandimet e PZHK-së, LPH-së dhe UA- ve respektive. Për çdo zonë janë përcaktuar Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, të veçanta, përkohshme, të ndaluara si dhe kushtet zhvillimore.


4.1. Lista e të gjitha zonave

Tabela 6 Lista e zonave

Kodi	Zona	Kodi HILUCS 1	Klasa HILUCS1	Kodi HILUCS 2	Klasa HILUCS2	Kodi HILUCS 3	Nën-zonat	Kodi	Ngjyra
ZP	PYJORE	1	Prodhim parësor	1.2	Pylltari	1.2.1	Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër		
Zb	BUJQËSORE			1.1	Bujqësi	1.1.1	Bujqësi për konsum komercial	Zb-Kk	
						1.1.3	Bujqësi për konsum vetjak	Zb-Kv	
ZB	BANIMIT	5	Banim	5.1	Banim i përhershëm		Banim individual	ZB-In	
						Banim shumëbanesor	ZB-Sh		
				5.2	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri		Banim individual me afarizëm	ZB-Ia	
						Banim shumëbanesor me afarizëm	ZB-ShA		
5.3	Banim tjetër		Banim i përkohshëm-kamping	ZB-P					
ZM	SHFRYTËZIM I PËRZIER - PËRGJITHSHËM							ZM	
ZSh	SHËRBIMEVE	3	Prodhim tretësor	3.3	Shërbim i komunitetit	3.3.1	Shërbim të administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale	ZSh-ApMs	
						3.3.2	Shërbimi arsimor	ZSh-A	
						3.3.3	Shërbim shëndetësor dhe shoqëror	ZSh-Sh	
						3.3.4	Shërbim fetar dhe shërbim tjetër komuniteti	ZSh-FSht	
				3.4	Shërbim kulturor, argëtues, dhe rekreativ (sipas NTPH/HILUCS) apo Infrastruktura sociale	3.4.1	Shërbim kulturor	ZSh-K	
						3.4.2	Shërbim argëtues	ZSh-Ar	
						3.4.3	Infrastrukturë sportive	ZSh-Is	
						3.4.4	Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative	ZSh-HrSht	
						3.4.5	Shërbime tjera rekreative	ZSh-tr	
				4.3	Shërbime publike (sipas NTPH/HILUCS) apo Infrastruktura teknike	4.3.1	Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike	ZSh-E	
						4.3.2	Infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza	ZSh-UK	
						4.3.3	Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave	ZSh-Tm	
						4.3.4	Format tjera të infrastrukturës publike	ZSh-t	
ZKT	KOMUNIKACIONIT - TRANSPORTIT	4	Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1	Rrjetet e transportit	4.1.1	Infrastrukturë e transportit rrugor	ZkT-Rr	
						4.1.2	Infrastrukturë e transportit hekurudhor	ZkT-H	
							Urat	ZkT-U	
							Transporti publik	ZkT-Tp	
ZI-K	INDUSTRIALE – KOMERCIALE	2	Prodhim dytësor	2.1	Industri e lëndës së parë	2.1.2	Prodhim i drurit dhe produkteve me bazë të drurit		
						2.1.6	Prodhim i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuaara		
						2.1.7	Prodhim i produkteve jo metalike minerale		
						2.1.8	Prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës		
		2.3	Industri e prodhimeve të lehta	2.3.1	Prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit				
		3	Prodhim tretësor	3.1	Shërbim tregtar	3.1.1	Shërbime tregtare me shumicë		
ZrT	REKREATIVE-TURISTIKE						Turizëm vikendor	ZT-V	
							Turizëm rehabilitues	ZT-R	
							Ekoturizëm	ZT-Et	
							Turizëm malor	ZT-M	
							Turizëm kulturor dhe sportiv	ZT-KS	
							Turizëm ndërkufitar	ZT-Nk	

SU	SIPËRFAQE UJORE DHE ZONAT E MBROJTURA SANITARE					Sipërfaqet ujore	SU		
						Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve	Zm-U		
ZN	NATYRORE	6	Shfrytëzim tjetër	6.3	Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomi	Monumente me karakter botanik	ZN-B		
						Monumente me karakter hidrologjik	ZN-H		
Zm	ZONAT DHE SIPËRFAQET E MBROJTURA TË TRASHËGIMISË KULTURORE					Trashëgimia arkeologjike	Zm-a		
						Trashëgimia arkitekturore	Zm-A		
Zlp	SIPËRFAQET E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM						Zlp		
ZmS	REZERVA MINERARE DHE FUSHAT E EKSPLLOATIMIT	1	Prodhim parësor	1.3	Minierë dhe e gurore	1.3.2	Minierë e xeheve metaleve	ZmS	
						1.3.3	Minierë dhe gurore tjetër		
ZMb	ZONA MBISHTRESORE						ZMb		

Harta 2 Harta e të dhënave bazë



V. ZONAT E PËRCAKTUARA DHE KUSHTET ZHVILLIMORE TË TYRE

Ky kapitull elaboron në detaje shfrytëzimet e tokës dhe kushtet zhvillimore për çdo zonë.

5.1 Zona Pyjore

Toka pyjore përfshin sipërfaqet e tokës të mbuluara me pemë pyjore në formë të grumbullit pyjor që përfshinë edhe bashkësitë bioekologjike, me sipërfaqe më të madhe se dhjetë (10) ari⁴.

Sipërfaqet pyjore sipas projeksioneve të PZHK-së

Sipas shfrytëzimit të tokës së PZHK-së, sipërfaqet pyjore shtrihen në të tri tërësitë hapësinore të Podujevës përveç në zonën urbane dhe sipërfaqja e tyre e përgjithshme është 29.680,8ha. Sipas HZK-së mbesin relevante rekomandimet e dhëna me PZHK si mbrojtja e tyre, mos shfrytëzimin për qëllime ekonomike përveç për përpunimin e drurit për qëllime artizanale dhe për prodhimin e biomasës, zhvillimin e bletarisë, turizmit dhe rekreacionit.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimi i lejuar: HZK përcakton se në zonën pyjore lejohet pylltaria e bazuar në rotacion të shkurtër, klasë e cila përfshinë hapësira pyjore ku periudha e rotacionit të një brezi pemësh është 50 vjet ose më pak, pas së cilës pylli rigjenerohet në mënyrë artificiale apo natyrore, me mbjelljen dhe mbirje fare. Kësaj klase i përkasin po ashtu plantacione pemësh dhe drurësh që përdoren për prodhimin e biomasës. Në zonën pyjore lejohet ndërmarrja e masave preventive-kultivuese të parapara me ligjin respektiv.

Shfrytëzime dytësore përfshijnë ndërtesat në shërbim të menaxhimit të pyjeve, kullosa, infrastrukturë rrugore rajonale, lokale dhe e pa-kategorizuar (shtigjet), shtigjet kundërzjarrit;

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara: përfshijnë prerjen e pyjeve, ripyllëzimin, meliorimin të gjitha në pajtueshmëri me dispozitat ligjore respektive.

Shfrytëzimet e përkohshme: Në sipërfaqet e zhveshura të pyjeve me propozimin dhe pëlqimet paraprake nga komuna dhe Agjensioni i pyjeve, banorëve të zonës ju lejohen ndërtime e struktura të përkohshme apo aktivitete të cilat i kontribuojnë valorizimit të zonës, dhe me kushtin që të mos ketë prerje drunj. Në kuadër të këtyre veprime do të përfshihen: kultivimi i bujqësisë dhe blegtorisë (shoqëritë e bletëve (deri në 100)), shfrytëzimi i mineraleve, gjuetia, ndërtesat e klubeve/shoqatave të gjuetareve e të ngjashme, mbledhja dhe pikat shitëse të prodhimeve bujqësore/blegtorale, aktivitete argëtuese e rekreative (hiking, turistike), peshkimi, shfrytëzimi i produkteve jo-drusore (kërpudha, frutat e egra), kultivimi i kafshëve të egra (drerit, kaprollit, lepurit, ujkut etj), etj.

Në kuadër të *shfrytëzimeve të ndaluara* ndalohet të gjitha ato aktivitete si dhe ato të ngjashme që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë

Dimensionet e parcelës: deri në 300 m² për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë. Ndërtesat tjera për shfrytëzim të përkohshëm dimensionohen sipas normave respektive.

Lartësia: 1 kat me lartësi maksimale 4m për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë.

Intensiteti: ISHZPK 50%; ISN 0.5.

Qasja në parcelë: përputhet me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Distancat: shoqëritë e bletëve duhet të ndërtohen larg sipërfaqeve ujore dhe të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, infrastrukturës rrugore, si dhe shfrytëzimeve tjera të frekuentuara nga komuniteti.

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritat e gjelbër mbrojtës: shih Kushtet e Përgjithshme.

Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial shih Kushtet e Përgjithshme.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: objektet e reja duhet të jenë të ndërtuara nga materialet të cilat lehtë mund të çmontohen dhe të cilat janë miqësore me mjedisin si dru, gurë dhe qelq, me formë dhe ngjyra që janë në harmoni me mjedisin.

Siguria nga zjarri: të respektohen kushtet e përcaktuara me Ligjin për Pyjet e Kosovës dhe udhëzimin respektiv për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: përputhet me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: shih Kushtet e Përgjithshme.


Bonuset e zonimit: /

Jonkonformitetet: nëse në këtë zonë ekzistojnë zhvillime apo objekte të cilat zhvillohen apo janë ndërtuar pa pëlqimin dhe lejen e MBPZHR-së dhe të Komunës, e të cilat nuk janë në harmoni me kërkesat e HZK-së do të konsiderohen subjekt i “ngrirjes së zhvillimit” deri në trajtimin e tyre me ligjet respektive apo programe të veçanta.

Masat mbrojtëse: mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet në pajtueshmëri me ligjet respektive.

⁴ UA mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor

Harta 4 Harta zona e shfrytëzimit të tokës pyjore



5.2 Zona Bujqësore

Toka bujqësore është toka e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdha peshku dhe moçale, si dhe tokat tjera që nuk janë në shfrytëzim për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor, duke marrë parasysh vetitë e tyre natyrore dhe kushtet ekonomike⁵.

5.2.1 Sipërfaqet bujqësore sipas projeksioneve të PZHK

Sipas PZHK-së, sipërfaqja bujqësore shtrihet në të tri tërësitë hapësinore të Podujevës që përfshijnë gjithsej 62.870ha ku 25% e sipërfaqes i përket klasës I-IV, dhe pjesa e mbetur klasës V–VII. Në këto sipërfaqe është rekomanduar të zhvillohen bujqësia dhe blegtoria. Për periudhën dy-vjeçare, vlerësimi i zbatimit të planit ka vënë në pah progresin në zbatimin e një mori veprimeve të parapara në fushën e zhvillimit të bujqësisë të cilat përfshijnë veprimet të cilat kanë ndikuar në shtimin e numrit të bizneseve në këto lëmi duke mundur rritjen e numrit të fermerëve, bletarëve dhe blegtorëve rrjedhimisht rritjen e sipërfaqeve të punëshme dhe produktivitetit. Bazuar në këto zhvillimi edhe HZK e konsideron prioritet zhvillimin e këtyre dy fushave.

5.2.2 Zona bujqësore Zbu-1- kategoria e tokës bujqësore I-IV

5.2.2.1. Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzime të lejuara: Tokat bujqësore të klasave I-IV, në përputhje me Ligjin 02/6L për tokën bujqësore do të shfrytëzohen ekskluzivisht për prodhimtari intensive bujqësore për konsum vetjak e komercial (perimtaria në të hapur dhe në serra në Tërësitë Natyra dhe Turizmi e Aktive Qendrore përveç në qytet, lavërtaria, kultivimi i bimëve foraxhere dhe mjekuese, fidanishtet, si dhe bletaria në të gjitha tërësitë përveç në qytet

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: hapësirë për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore/blegtorale, plehut dhe ushqimit për kafshë, si dhe hapësira për makineritë dhe pajisjet tjera në të gjitha tërësitë përveç në qytet, shërbim kulturor si monumentet kulturore dhe natyrore, hapësirë e hapur rekreative si pyll, lum, tokë bujqësore, burimet e ujit në të gjitha tërësitë.

⁵ UA mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara:

- Infrastruktura bujqësore në funksion të prodhimit bujqësor. Preferohet të ndërtohet në tokën bujqësore të cilësish më të dobët, mirëpo nëse nuk është e mundur atëherë do të lejohen në klasat I- IV, në kuadër të parcelave të cilat do të trajtohen si tokë ndërtimore e veçanta dhe atë vetëm në rastet kur plotësohen kushtet e përcaktuara me ligjet/rregulloret e veçanta sektorale e në veçanti në përputhje me UA Nr.41/2006 për ndërrimin e tokës bujqësore si dhe me këtë HZK lidhur me: madhësinë minimale të parcelës, largësinë nga zona e ndërtuar e vendbanimit dhe rrugët publike, dhe numrin minimal të njësive blegtorale që lejohet të mbarështohen jashtë zonës së ndërtuar të vendbanimit;
- Ndërtesat për panairë;
- Infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe për ujitje, infrastruktura e transportit si rrugët ekzistuese lokale dhe të pa kategorizuara, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, hekurudha, infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike (trafostacionet) dhe shtyllat e telekomunikacionit në të gjitha tërësitë (rekomandohet që të shmanget vendosja e infrastrukturës në këtë zonë, nëse është e pashmangshme atëherë preferohet në tokën e kategorisë V-VII);
- Infrastruktura për prodhim të energjisë alternative të bazuar në biomasë (hapësira ku prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishtme (sipërfaqe me panele solare që shfrytëzojnë burimin diellor për prodhimin e ujit të ngrohtë edhe për energji elektrike për nevojat e ndriçimit të ndërtesave bujqësore).

Për të gjitha zhvillimet në kuadër të shfrytëzimit e veçanta të lejuara, nevojiten kushte shtesë të përcaktuara me aktet apo nën-aktet ligjore përkatëse si marrja e pëlqimit mjedisor apo raporti i VNM-së. Si parim i përgjithshëm për zhvillimet e ardhshme është të tentohet të përdoret toka me bonitet më të ulët.

Shfrytëzimet e përkohshme të lejuara në të gjitha tërësitë: shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale, peshkimi si peshkim rekreativ dhe profesional, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairët.

Shfrytëzimeve të ndaluara: të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionin e ngjashëm të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

5.2.3 Zona bujqësore Zbu-2- kategoria e tokës bujqësore V-VII

Sipas UA për NTPH kjo klasë e tokës bujqësore është tokë me përshtatshmëri nën mesatare dhe e dobët që kryesisht është tokë pyjore dhe livadhe, prandaj me HZK në tokat e tilla planifikohet të zhvillohet blegtoria dhe aktivitetet tjera.

5.2.3.1. Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzime të lejuara për këtë zonë janë prodhim bujqësor komercial dhe bujqësi për konsum vetjak si:

- pemëtaria e perimtaria në të hapur dhe në serra, lavërtaria në tërësitë Natyra e Turizmi dhe Aktive Qendrore duke mos përfshirë qytetin, bletaria, kultivimi i fidanëve, dhe i bimëve mjekuese e dekoruese;
- Infrastruktura bujqësore (klasifikimi sipas HILUCS) ose ndërtesat mbështetëse (sipas NTPH), si objektet për përpunimin primar të prodhimeve bujqësore, objektet për grumbullimin e produkteve bujqësore përfshirë edhe ato për trajtim paraprak të produkteve bujqësore (tharjen e pemëve dhe perimeve), frigoriferët, për therrjen e bagëtisë.
- Industri për prodhim të qumështit, mishit, parapërgatitje e ushqimeve për bagëti në Tërësinë Natyra e Turizmi dhe Aktive Qendrore përpos në qytet;
- Ndërtesat bujqësore të kategorisë I dhe II (sipas përcaktimit të Ligjit të ndërtimit Nr.04/L-110 /UA për kategorizimin e ndërtimeve) ku përfshihen: fermat për kultivimin e kafshëve të trasha (lopë, dele, dhi), ferma të shpezëve, ndërtesa bujqësore përcjellëse për bagëti dhe shpezëtari, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës, hapësira për makineritë dhe pajisjet bujqësore dhe peshkim në të gjitha tërësitë përpos në qytet.

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në të gjitha tërësitë janë banimi në rastet kur kemi zhvillim të bujqësisë për konsum vetjak, hapësirë e hapur rekreative, infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes të cilat janë në funksion të plotësimit të përmbajtjeve të lejuara.

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara:

- infrastruktura e transportit si hekurudha në Tërësinë Aktive Qendrore, rrugët ekzistuese dhe të pakategorizuara, ndalesat e autobusëve, shtigjet për biçikleta dhe këmbësorë në të gjitha tërësitë, dhe infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike (trafostacionet) dhe shtyllat e telekomunikacionit në të gjitha tërësitë përpos në qytet.
- prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë (hapësira ku mund të prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishme (sipërfaqe me panele solare që shfrytëzojnë burimin diellor për prodhimin e ujit të ngrohtë edhe për energji elektrike).

Për të gjitha ndërtesat të cilat janë në funksion të shfrytëzimeve të veçanta të lejuara, përveç kushteve të përcaktuara me HZK është e domosdoshme edhe Leja mjedisore apo raporti i VNM-së në pajtim me legjislacionin përkatës. Si parim i përgjithshëm për zhvillimet e ardhshme është të tentohet të përdoret toka me bonitet më të ulët.

Shfrytëzimet e përkohshme të lejuara janë shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairët, peshkim rekreativ dhe profesional. Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionin e ngjashëm të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

5.2.4. Kushtet zhvillimore

5.2.4.1. Kushtet zhvillimore- kulturat bujqësore

Sa i përket dimensionit të parcelës për kultivimin e pemëtarisë drufrutore dhe manore, perimtarisë, drithërave, vreshtave fidaneve e luleve në rastin e vet financimit mund të jetë e madhësisë që e posedon pronari, mirëpo në rastet e aplikimit për grante duhet të përputhet me kërkesat e përcaktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të MBPZHR.

Në kuadër të parcelës përpos kultivimit të pemëve, perimeve, fidaneve, luleve, bimëve mjekuese dhe foragjere lejohet edhe ndërtimi i strehëve, depove, dhomave për tharje dhe ftohje të produkteve, frigoriferëve, hapësirave për ruajtjen e frutave, si dhe hapësirave për makineri bujqësore, pajisjeve, mjeteve të punës, paketimit, trafostacionet e të ngjashme.

Këto objekte mund të ndërtohen vetëm brenda parcelave të cilat shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore dhe nuk lejohet në parcelat të reja apo zvogëlimi i atyre ekzistuese.

Kushtet për zhvillimet/ndërtimet në parcelat e zonës bujqësore:

- zgjedhja e lokacionit të përshtatshëm për ngritjen e plantacioneve të kulturave bujqësore duhet bazuar në karakteristikat natyrore të lokacionit (relievit, karakteristikave agro-ekologjike, meteorologjike dhe hidrologjike), si dhe kushteve të tjera (afërsia me rrugën publike, mundësia e furnizimit me ujë për ujitje, afërsia me ndërtesat e ruajtjes së prodhimit, etj.).
- parcela duhet ta ketë të siguruar sistemin e ujitjes (pikë-pikë ose me spërkatje) dhe drenazhimin (përmes kanaleve të hapura ose gypave);
- lokacioni duhet të jetë i ekspozuar ndaj diellit dhe i mbrojtur nga ndikimi direkt i erërave të forta. Për mbrojtje nga erërat e forta rekomandohet ngritja e brezave të gjelbërimit mbrojtës me gjerësi 10-15 m dhe largësi 200-300 m nga pemishtja;
- toka duhet të ketë strukturë të përshkueshme dhe pa ujëra nëntokësor në nivel të lartë;
- për shkak të rrezikut nga erozioni, terrenet me pjerrësi më të madhe se 30 ° nuk janë të përshtatshme për rritjen e pemëve frutore. Rekomandohen parcelat me pjerrësi të butë prej 4 deri në 6 ° të cilat mundësojnë regjim më të favorshëm të ujitjes dhe ajrosjes. Për mbrojtjen e tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontroll të përmbytjeve në zonën e erozionit duhet të ndërmerren masat antierozive të cilat trajtohen në Zonën Mbishtresore;
- madhësia e parcelës për kultivimin e këtyre kulturave mund të jetë e ndryshme varësisht nga kushtet natyrore dhe madhësia e tokës që është në dispozicion, përdorimi i mekanizimit, etj.
- parcelat duhet të rrethohen me gardh transparent i larguar nga skajet e parcelës së paku 50 cm;
- në kuadër të plantacioneve të pemëve me sipërfaqe më të madhe se 5ha lejohet ndërtimi i ndërtesave mbështetëse (zyra, depo, frigoriferë etj.), të cilat zakonisht vendosen përgjatë rrugës. Ndërtesat mbështetëse mund të ndërtohen vetëm në parcelat të cilat shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore dhe nuk lejohet formimi i parcelave të reja apo zvogëlimi i atyre ekzistuese. Materiali për ndërtimin e ndërtesave mbështetëse mund të jetë nga blloqet, konstrukcionet e drurit apo metalike. Kulmi të jetë dy ujor i mbuluar me tjegulla apo llamarinë të valëzuar. Ndërtesat duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri;
- largësia minimale mbrojtëse e zonave të banimit nga arat/pemishtet në të cilat aplikohet trajtimi intensiv me plehra kimike dhe pesticide është së paku 500m;
- largësia minimale mbrojtëse nga ujë rrjedhat e hapura jo më pak se 30m.
- nuk lejohet kullimi apo depozitimi i materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në tokën bujqësore dhe në kanalet e ujitjes;
- nuk lejohet përdorimi i folieve të cilat nuk janë biodegraduese në tokën bujqësore të punueshme;

- për mbrojtjen e tokës bujqësore nga fragmentimi⁶ duhet të ndërmerren masat kundër fragmentimit si:
 - Toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤1ha, nuk mund të fragmentohet në parcela.
 - Toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e se cilës është ≤ 0.5ha, të mos mund të fragmentohet tutje.
 - Toka bujqësore duhet të rregullohet përmes konsolidimit si dhe përmirësimit të pjellorisë së tokës bujqësore përmes meliorimit.
- Në rastet kur parcela përdoret për prodhimtari bujqësore komerciale madhësia e parcelës në të cilën do të ndërtohen objektet në funksion të bujqësisë duhet të ketë madhësinë jo më të vogël se 0.5ha.
- Në rastet kur parcela përdoret për prodhimtari bujqësore për konsum vetjak, madhësia minimale e parcelës për të cilën mund të lejohet ndërtimi i këtyre objekteve është 500m'. Së paku 95% e sipërfaqes së parcelës duhet të përdoret si tokë e punueshme (pemishte, vreshtë, kopsht perimesh ose kopsht lulesh);
- Gabariti maksimal i shtëpizës ndihmëse për produktet bujqësore është 40m² për parcelat prej 500m² – 2000m² por jo më shumë se 60m² për parcela më të mëdha se 2000m². Sipërfaqja e depos mund të rritet për 20m² për çdo 1000m² më shumë, por deri në maksimum prej 80m²;
- Në afërsi të shtëpizës ndihmëse për produktet bujqësore lejohet ndërtimi i depos për vendosjen e prodhimeve (fruta, perime), mjeteve të punës dhe mekanizimit me sipërfaqe maksimale prej 100m²;
- Për kushtet rreth objekteve të banimit referoju Zonës së Banimit në vendbanimet rurale;
- Në parcelat më të mëdha se 2 ha, lejohet ndërtimi i strehëve, verandave dhe pergolave për vendosjen e përkohshme të prodhimeve bujqësore me sipërfaqe deri 40m², me sipërfaqe bruto e së cilës mund të rritet për 20m² për çdo 5000m² shtesë të sipërfaqeve të kultivuara. Këto struktura duhet të ndërtohen nga materiale të lehta dhe të jenë të hapura nga të dy anët;
- Në parcelat e pemishteve me sipërfaqe më të madhe se 5ha mund të ndërtohet objekti i frigoriferit për ruajtjen e frutave me sipërfaqe maksimale prej 200m²;
- Serat mund të vendosen në parcela të dimensioneve të ndryshme, por mos të pengojnë parcelat fqinje;
- Sipërfaqja e serave nuk duhet të jetë më e madhe se 70% e sipërfaqes së parcelës;

5.2.4.2. Kushtet zhvillimore- Infrastruktura bujqësore

i. Infrastruktura bujqësore - fermat komerciale

Të gjitha ndërtesat e destinuar për mbajtjen dhe mbarështimin e kafshëve dhe shpezëve duhet të projektohen dhe ndërtohen sipas normave dhe standardeve për ndërtimin e këtij lloji të objekteve dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi. Fermat përbëhen nga një grup i ndërtesave të lidhura funksionalisht, që kanë në dispozicion edhe një sipërfaqe përkatëse të tokës bujqësore. Dimensionet e fermave dhe kushtet që duhet plotësuar janë përcaktuar me UA për kategorizimin e ndërtimeve, Udhëzuesin për aplikim dhe UA të MBPZHR.

Në kuadër të parcelës për ferma përfshihen shtallat për mbarështimin e kafshëve dhe shpezëve dhe depo për ruajtjen e produkteve bujqësore, hambar, ahur, silose, hapësira për vendosjen e mjeteve dhe makinave bujqësore si dhe objekte për përpunimin dhe paketimin e produkteve bujqësore.

- Në këtë zonë varësisht nga madhësia e parcelës dhe kushtet ekzistuese do të ndërtohen fermat e vogla, të mesme dhe të mëdha.
- Madhësia e parcelës, objekteve duhet të projektohen në përputhje me kushtet dhe standardet të përcaktuara me ligje përkatëse përfshirë dhe Ligjin Nr.04/L-110 për ndërtim në UA për kategorizim të ndërtimeve;
 - Madhësia e parcelës dhe kushtet tjera për objektet e banimit janë dhënë në Zonën e Banimit në vendbanimet rurale;
 - Ndërtimi i ndërtesave mbështetëse në funksion të prodhimtarisë bujqësore në tokën ndërtimore të veçuar është i mundur në lokacione të caktuara, me sipërfaqe maksimum deri në 10ha, nëse respektohen kushtet higjieno-teknike, mjedisore, të mbrojtjes nga zjarri etj. Kushtet e përgjithshme për ndërtimin e ndërtesave për mbarështimin e kafshëve të fermës (fermave të mesme dhe të mëdha⁷) janë:
 - lokacioni për ndërtimin e fermave duhet të përbushë kushtet mjedisore dhe ato të përcaktuara me Ligjin e ndërtimit Nr.04/L-110 /UA për kategorizimin e ndërtimeve, në mënyrë që të evitohet ndikimi negativ nga ndërtesat përreth dhe anasjelltas.
 - toka duhet të jetë kompakte dhe duhet të ketë rrjedhje të mirë të ujërave atmosferikë;
 - lokacioni duhet të jetë jashtë zonës që mund të rrezikohet nga përmytjet dhe rrëshqitjet e dheut;
 - para se të fillojë zhvillimi i objekteve bujqësore në parcelë, duhet të sigurohet qasja në rrjetin e infrastrukturës teknike bazë (furnizimi me ujë, kanalizimet e ujërave të zeza dhe energji elektrike) dhe infrastrukturën e transportit;
 - preferohet që furnizimi me energji i ndërtesave të sigurohet nga burimet e energjisë së ripërtëritshme;
 - në kuadër të fermës mund të ndërtohen ndërtesat e infrastrukturës blegtorale: stallë kafshësh, ndërtesa mbështetëse për prodhimtari blegtorale, ndërtesa për qëllime të përpunimit dhe paketimit të produkteve bujqësore të prodhuara në fermë.

⁶ Sipas legjislacionit në fuqi

⁷ Ligji nr. 04/l-191 për blegtorinë i ndan fermat sipas madhësisë në:

1.1. ferma të vogla blegtorale, që mbarështojnë më pak se pesë (5) njësi blegtorale në baza ditore;

1.2. ferma të mesme blegtorale, që mbarështojnë nga gjashtë (6) deri në njëzet (20) njësi blegtorale në baza ditore;

1.3. ferma të mëdha blegtorale, që mbarështojnë mbi njëzet (20) njësi blegtorale të kafshëve të fermës në baza ditore.

- lejohe vetëm një ndërtesë një-familjare e banimit për nevoja të pronarit dhe hapësirat për qëndrim ditor të punëtorëve të fermës me kusht që ato të mos e kalojnë vlerën maksimale të lejuar prej 20% të sipërfaqes së tërësishme të ndërtesave të infrastrukturës blegtorale në parcelë;
- ndërtesat përcjellëse të fermave mund të ndërtohen vetëm pas ndërtimit ose njëkohësisht me ndërtimin e ndërtesave kryesore;
- sipërfaqja e tokës për ngritjen e fermës duhet të jetë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për kapacitetin e kafshëve dhe numrin dhe madhësinë e ndërtesave në kuadër të saj, për të siguruar lidhjen e tyre funksionale dhe distancën e mjaftueshme midis tyre;
- sipërfaqja maksimale e dyshemesë së objektit për mbarështimin e kafshëve nuk mund të tejkalojë sipërfaqen e nevojshme për kapacitetin e kërkuar të njësive blegtorale, gjë që duhet të arsyetohet në projekt;
- ndërtesat e fermave që mbarështojnë deri në 50 njësi blegtorale duhet të jenë të larguara së paku 100m nga kufiri i tokës ndërtimore të vendbanimit rural;
- largësia e ndërtesës së fermës nga komplekset rekreative-sportive dhe komplekset tjera publike duhet të jetë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse të kësaj fushe por jo më pak se 500m, varësisht nga madhësia, kapaciteti dhe lloji i kafshëve që mbarështohen në fermë;
- sipërfaqja minimale e tokës bujqësore në të cilën mund të ngritet një fermë nuk mund të jetë më pak se 0.5ha në tërësinë e saj funksionale, ndërsa pjesa e tokës bujqësore nuk mund të ndahet në parcela më të vogla;
- intensiteti i ndërtimit mund të jetë një maksimum prej 0.3;
- etazhiteti maksimal i ndërtesës së stallës është P+0 dhe lartësia maksimale është 4.5m;
- lartësia e ndërtesave mbështetëse, oxhaqeve, siloseve dhe strukturave tjera përcaktohet në varësi të karakteristikave të zgjidhjes teknologjike, por nuk mund të tejkalojë 8m;
- stallat që mbarështojnë 5-10 njësi blegtorale në baza ditore duhet të jenë të larguara së paku 5m nga kufijtë e parcelës, për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi blegtorale në baza ditore kjo distancë është së paku 10m;
- ndërtimi i stallave do të lejohet vetëm nëse menaxhimi i ujërave të zeza dhe jashtëqitjeve shtazore bëhet me filtrim paraprak;
- hapësira e depozitimit të plehut duhet të jetë e vendosur/ndërtuar në mënyrë që të parandalojë ndotjen e mjedisit, në drejtim të kundërt të erërave dominuese dhe së paku 50m larg nga ndërtesa ku mbahen kafshët;
- ndërtimi i ndërtesave për thertore lejohet sipas kushteve në vijim: vëllimi maksimal i ndërtesës të mos e kalon intensitetin prej 1m³/m². Largësia nga kufijtë e parcelës duhet të jetë së paku 20m, ndërsa largësia nga zonat e banimit së paku 500m;

Për mbrojtjen e tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontroll të përmbytjeve në zonën e erozionit duhet të ndërmerren masat antierozive të cilat do të trajtohen në Zonën Mbishtresore.

ii. Infrastruktura bujqësore– fermat e vogla

Në zonën bujqësore mund të zhvillohet prodhimtaria bujqësore për konsum vetjak - ekonomitë bujqësore. Në kuadër të një parcele të banimit të vendbanimeve rurale, lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe ndërtesave mbështetëse për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore për konsum vetjak.

Parcela e ekonomive bujqësore funksionalisht ndahet në disa tërësi: pjesën e ndarë të kopshtit me pemë dhe perime, oborrin ekonomik me ndërtesat mbështetëse për: ruajtjen prodhimtarisë bujqësore, mekanizimit dhe stallës për mbajtjen e bagëtive, dhe pjesën për ndërtimin e ndërtesës së banimit (shih modelet e dhëna për organizimin e parcelës tek zona e banimit).

Sipërfaqja e ndërtesave mbështetëse (infrastrukturës bujqësore) duhet të merret parasysh gjatë llogaritjes së indeksit të shfrytëzimit të parcelës.

Rregullimi hapësinor i parcelave të ekonomive bujqësore duhet të siguron lidhjet funksionale dhe të sigurta nga aspekti shëndetësor midis tërësive të parcelës.

Kushtet e përgjithshme për ndërtimin e ndërtesave për mbarështimin e kafshëve të fermave të vogla janë:

- etazhiteti maksimal i ndërtesave mbështetëse është P+0 dhe lartësi deri në 4.5m;
- vendosja e ndërtesave të stallave të bagëtive në raport me pjesën rezidenciale të oborrit bëhet në drejtim të kundërt me erërat mbizotëruese;
- kushtet për ndërtimin e ndërtesës së banimit përputhen me kushtet e dhëna të zona e banimit për zonë rurale;
- rekomandohet ndarja me një rrip të gjelbër (pemë, shkurre) e oborrit ekonomik nga pjesa e banimit;
- objekti për grumbullimin e plehut duhet të vendoset afër stallës me ekspozim kah veriu dhe me qasje përmes sipërfaqes së pllakosur të rrugës;
- largësia më e vogël e ndërtesave mbështetëse për vendgrumbullim të plehut, kompostim dhe depozitim të sanës e kashtës nga kufijtë e parcelës është së paku 5m;
- objektet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore (hambarët, koshat) duhet të ndërtohen nga materialet natyrore dhe bazuar në traditën lokale;
- lejohet ndërtimi i objektit për ruajtjen e ushqimit të bagëtisë, silosit me kapacitet deri 100 tonelata në largësi prej 15m nga muret me hapje të ndërtesës së banimit, 8m nga ndërtesat tjera në parcelë, 5m nga kufijtë e parcelës;
- largësia më e vogël në mes të objektit për banim dhe stallës së bagëtive është 15m;
- largësia minimale e ndërtesës së banimit, pusit, ose burimit të ujit nga vendgrumbullimi i plehut dhe tualeteve në natyrë është së paku 20m, dhe atë vetëm kur vendgrumbullimi i plehut është në kuotë më të ulët se ato;

- në rast se oborret ekonomike të parcelave fqinje kufizohen drejtpërdrejt me njëra tjetrën, distanca e objekteve të reja mbështetëse nga kufiri i parcelës nuk mund të jetë më pak se 1.5m;
- nëse oborri ekonomik i një parcele kufizohet drejtpërdrejtë me pjesën rezidenciale të parcelës tjetër, largësia e strukturave të reja mbështetëse është së paku 15m;
- në parcelën me pjerrësi të terrenit prej rrugës publike (më poshtë), në rast të ndërtimit të ri, oborri rezidencial vendoset në kuotën më të lartë, përgjatë rrugës. Gjerësia më e vogël e rrugës për qasje ekonomike në parcelë është 3m. Oborri ekonomik vendoset mbrapa oborrit rezidencial (më poshtë);
- në parcelën me pjerrësi të terrenit kah rruga publike (më lart), në rast të ndërtimit të ri, oborri i objektit të banimit vendoset në kuotën më të lartë. Gjerësia më e vogël e rrugës për qasje në objekt të banimit është 2,5m kurse e asaj ekonomike 3m;
- oborri ekonomik mund të vendoset përgjatë rrugës publike, ndërsa objektet ekonomike në vijën ndërtimore të përcaktuar, me kusht që vija ndërtimore është zmadhuar me një shirit gjelbërues prej së paku 3m;
- parcela mund të rrethohet me mur me lartësi deri 0.9m ose me gardh transparent me lartësi deri 2m. Nuk lejohet vendosja e gardhit masiv dhe jo transparent;
- për mbrojtjen e ndërtesave nga efektet e dëmshme të erozionit dhe për kontroll të përmytjeve në zonën e erozionit duhet të ndërmerren masat antierozive të cilat trajtohen në Zonën Mbishtresore.

iii. **Infrastruktura bujqësore-ndërtesat në funksion të prodhimtarisë bujqësore**

Infrastruktura bujqësore në funksion të prodhimtarisë bujqësore nënkupton ndërtesat përcjellëse të të gjitha llojeve të aktiviteteve bujqësore: për kultivimin e bimëve, të prodhimit të ushqimit për njerëz dhe për kafshë; prodhimin e fibrave, biokarburantëve, dhe prodhimeve tjera për nevoja të njeriut. Në këto ndërtesa përfshihen: **Ndërtesat për vendosjen e mekanizmit bujqësor dhe pajisjeve tjera:** ndërtesat e mbyllura ose strehët që përdoren për vendosjen e të gjitha llojeve të makinerive bujqësore dhe veglave dhe pajisjeve bujqësore me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së tyre;

Ndërtesat për ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe ushqimit për bagëti si: të gjitha llojet e depove, palestra gjysmë të mbyllura dhe të mbyllura, strehët, silosat, frigoriferët, etj, përfshirë edhe ato për trajtim paraprak të produkteve bujqësore (tharje e tymosje).

Kushtet zhvillimore përfshijnë:

- Ndërtimi i ndërtesave mbështetëse në funksion të prodhimtarisë bujqësore është i mundur në lokacione të caktuara, me sipërfaqe maksimum deri në 10ha, nëse respektohen kushtet higjieno-teknike, mjedisore, të mbrojtjes nga zjarri etj.
- Madhësia minimale e parcelës kadastrale e cila shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore komerciale në të cilën mund të ndërtohen këto objekte, është:
 - 2 ha për ndërtesa në funksion të prodhimit lavërtar,
 - 1 ha për ndërtesa në funksion të kultivimit të pemëve frutore,
 - 1 ha për ndërtesa në funksion të kultivimit të perimeve,
 - 0,5 ha për ndërtesa në funksion të kultivimit të hardhisë së rrushit,
 - 0.5 ha për ndërtesa në funksion të kultivimit të luleve dhe fidanishteve
 - Serat mund të ndërtohen pavarësisht nga madhësia e parcelës;
- Parcelat duhet të jenë të lidhura me infrastrukturën e nevojshme si: rruga për qasje, instalimet elektrike, uji sanitar, gropa septike e papërshkueshme nga uji, etj.
- Ndërtesat mund të jenë të veçuara apo të grupuara dhe të lidhura ndërmjet veti në mënyrë funksionale;
- Numri maksimal i etazhave të ndërtesave është B+P (bodrum + përdhese);
- ISHPKZH e lejuar është jo më shumë se 30%;
- ISN i lejuar nuk duhet të kalojë vlerën prej 0,4;
- Largësia më e vogël e ndërtesave nga vija rregulluese është 20 m;
- Largësia më e vogël e ndërtesave nga kufijtë e parcelës fqinje është 5 m ndërsa nga ndërtesat tjera 10 m;
- Largësia minimale mbrojtëse e zonave të banimit dhe zonave rekreative-turistike nga arat/pemishtet në të cilat aplikohet trajtimi intensiv me plehëra kimike dhe pesticide është së paku 800 m;
- Largësia minimale mbrojtëse nga ujërrjedhat e hapura jo më pak se 30 m;
- për mbrojtjen e ndërtesave nga efektet e dëmshme të erozionit dhe për kontroll të përmytjeve në zonën e erozionit duhet të ndërmerren masat antierozive të cilat trajtohen në Zonën Mbishtresore.

Infrastruktura bujqësore - ndërtesat ndihmëse për pemishte, lavërtari dhe vreshta

- Në parcelat e tokës pjellore për ngritjen e pemishteve, vreshtave, apo kultivimin e perimeve ose luleve lejohet ndërtimi i shtëpizave ndihmëse, depo, tharëse, dhoma ftohjeje dhe frigoriferë, hapësira për ruajtjen e frutave, rrushit dhe verës, si dhe hapësirat për akomodimin e makinerive bujqësore, pajisjeve, mjeteve të punës, paketimit, trafostacionet e të ngjashme;
- Në rastet kur parcela përdoret për prodhimtari bujqësore për konsum vetjak, madhësia minimale e parcelës për të cilën mund të lejohet ndërtimi i këtyre objekteve është 500 m². Së paku 95% e sipërfaqes së parcelës duhet të përdoret si tokë e punueshme (pemishte, vreshtë, kopsht perimesh ose kopsht lulësh);
- Sipërfaqja bruto maksimale e shtëpizës ndihmëse për pemishte/ vreshtë /kopsht perimesh / lulësh është 40m² për parcelat prej 500m²-2000m² por jo më shumë se 60m² për parcela më të mëdha se 2000m². Sipërfaqja e shtëpizës mund të rritet për 20m² për çdo 1000m² më shumë, por deri në maksimum prej 80m²

- Largësia e objektit nga vija rregulluese duhet të jetë së paku 5m, ndërsa jo më pak se 6m nga ndërtesa në parcelën fqinje. Largësia nga kufiri anësor i parcelës, në anën ku është e vendosur rruga e detyrueshme për qasje të automjeteve është 4 m, ndërsa nga kufiri anësor në anën e kundërt 1 m;
- Numri maksimal i etazhave të ndërtesës është B+P (bodrum+përdhese), nëse plotësohen kushtet hidroteknike;
- Në parcelat më të mëdha se 2ha, lejohet ndërtimi i strehëve, verandave dhe pergolave për vendosjen e përkohshme të prodhimeve bujqësore me sipërfaqe deri 40 m², me sipërfaqe bruto e së cilës mund të rritet për 20 m² për çdo 5000 m² shtesë të sipërfaqeve të kultivuara. Këto struktura duhet të ndërtohen nga materiale të lehta dhe të jenë të hapura nga të dy anët;
- Skaj shtëpizës ndihmëse për pemishte/vreshtë/kopsht perimesh/lulesh lejohet ndërtimi i depos për vendosjen e prodhimeve (fruta, prime, rrush) dhe mjeteve të punës dhe mekanizimit me sipërfaqe maksimale prej 100m² dhe etazhitet Përdhese. Largësia minimale e objektit nga kufiri i parcelës fqinje është 1m, dhe nga ndërtesa në parcelën fqinje jo më pak se 6m’;
- Në parcelat e pemishteve me sipërfaqe më të madhe se 5ha mund të ndërtohet ndërtesa e frigoriferit për ruajtjen e frutave me sipërfaqe maksimale prej 200m².
- Në rastet kur shtëpizat ndihmëse dhe strehët janë të vendosura në parcela fqinje, largësia ndërmjet tyre duhet të jetë së paku 6m;
- për mbrojtjen e ndërtesave nga efektet e dëmshme të erozionit dhe për kontroll të përmbytjeve në zonën e erozionit duhet të ndërmerren masat antierozive të cilat trajtohen në Zonën Mbishtrësore.

Serat

Sera do të konsiderohen ndërtesat montazhe me struktura mbajtëse të vendosura mbi themele, të veshura me xham ose foli plastike. Serat për kultivimin e perimeve, pemëve, kërpudhave, luleve, e të ngjashme mund të ndërtohen në sipërfaqet bujqësore brenda ose jashtë zonave të ndërtimit, duke i respektuar kushtet në vijim:

- Sipërfaqja e këtyre ndërtesave dhe lartësia e tyre përcaktohet nga zgjidhja teknologjike, duke pasur kujdes që vendosja dhe funksioni i tyre të mos paraqet pengesa në parcelat fqinje, dhe nëse kjo nuk është në kundërshtim me kushtet lokale dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Sipërfaqja e serave nuk duhet të jetë më e madhe se 70% e sipërfaqes së parcelës;
- Largësia minimale nga kufiri i parcelës është jo më pak se 3m;
- Largësia minimale nga ndërtesa e banimit në të njëjtën parcelë është jo më pak se 5m;
- Parcela duhet të ketë kyçje në infrastrukturën përkatëse: energji elektrike, burime të ujit, rrugë publike;
- Rekomandohet që terreni të jetë i rrafshët, me ekspozim të lirë ndaj jugut e juglindjes, i mbrojtur nga erërat;
- Parcelat mund të rrethohen nga një gardh transparent me një lartësi maksimale 1.8m. Gardhi dhe shtyllat e gardhit duhet të vendosen në një largësi prej të paktën 1m nga kufiri i parcelës;

Bletoret

Bletoret⁸ dhe objektet për përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit duhet të vendosen në përputhje me rregullat e posaçme⁹ në mënyrë që të mos shqetësojnë fqinjët më të afërt, kalimtarët dhe trafikun rrugor. Largësia më e vogël e objektit nga vija rregulluese është jo më pak se 40 m. Bletoret duhet të jenë të larguara së paku 5m nga kufiri i parcelës fqinje nëse zgjojet e bletëve janë të kthyera përballë saj, dhe të paktën 3.0 m nëse ato janë të kthyera në drejtim të kundërt.

Tregjet e bagëtisë, mallrave bujqësore dhe panairë bujqësore

Tregjet e bagëtisë dhe objektet për panairë bujqësore duhet të ndërtohen sipas kushteve në vijim:

- Duhet të vendosen jashtë zonës së vendbanimit;
- Toka në të cilën ndërtohen të mos jetë e rrezikuar nga vërshimet;
- Lokacioni ndërtesës të mos jetë i shfrytëzuar si varrezë e bagëtisë apo deponi e mbeturinave;
- Parcelat duhet të jenë të pajisura me infrastrukturë rrugore për qasje me gjerësi së paku 3.5m’;
- Të kenë një hapësirë të veçantë për izolimin e kafshëve të cilat gjatë kontrollimit janë identifikuar si të infektuara ose dyshohen si të tilla;
- Pika grumbulluese në të cilën behët grumbullimi i kafshëve duhet rrethuar, ndërtuar nga materiali i përshtatshëm me numër të mjaftueshme të hyrjeve dhe daljeve të cilat mund të mbyllën, vende për lidhjen e kafshëve, vendin për ngarkimin-shkarkimin si dhe pajisje për furnizimin me ujë të pijshëm për kafshë.
- Madhësia e hapësirës është në proporcion me vëllimin dhe llojin e qarkullimit të kafshëve duke marrë parasysh edhe rritjen e sipërfaqes së rekomanduar për 15% në emër të rrugëve, sipërfaqeve për manipulim dhe objekteve sanitare;
- Shitja e mallrave në tavolinë në të hapur mund të bëhet vetëm në vendet për të cilat organet e qeverisjes lokale kanë dhënë lejen paraprake dhe është e domosdoshme edhe pëlqimi i inspeksionit sanitar, në pajtim me dispozita e Udhëzimit Administrativ për inspeksionin sanitar të Kosovës;

⁸ “Bletore” – vendi ku vendosen zgjojet me bletë, mund të jenë të hapura ose në ndonjë shtëpizë me etazhe, por mund të vendoset edhe në makina për transport;

⁹ Ligji nr. 02/L-111 për Bletari

- Shitja e artikujve në tavolinë mund të bëhet vetëm nëse janë siguruar kushtet në vijim: - mbrojtja e tavolinës nga veprimi i dëmshëm i rrethit (pluhuri, gaz i automjeteve, dielli, era etj.), - pastrimi dhe larja e vendeve të shitjes, - mënjanimi ditor i mbeturinave;
- Për shitjen e llojeve të caktuara të artikujve (artikujve që lehtë prishen) duhet të sigurohen pajisje për temperaturë të ultë për ruajtjen e tyre;
- Për shitjen e shalqinjve, pjeprave, specave, lakrave, patateve dhe llojet tjera të pemëve dhe perimeve duhet të sigurohet një shtresë për vendosjen e mallit e cila duhet të jetë e ngritur nga sipërfaqja e tokës;
- Shitësi ambulant mund të bëjë shitjen vetëm në vendet për të cilat organet e qeverisjes lokale kanë dhënë lejen paraprake;
- Shitja lëvizëse e prodhimeve industriale të ngrira dhe të paketuara mund të bëhet vetëm në mënyrë të përcaktuar me rregullore për mbrojtjen shëndetësore të prodhimeve, sipas UA për mbikëqyrjen Sanitare;
- Sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti, mbeturinat e ngurta duhet mbledhur në vendin e caktuar dhe të paraparë më herët duke siguruar kushtet e nevojshme shëndetësore-teknike dhe largimin e tyre në mënyrën si e ka përcaktuar organi kompetent komunal.

5.2.4.3. Kushtet tjera zhvillimore

Qasja në parcelë: përputhet me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme;

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës: sipas Kushteve Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: përveç kushteve Zhvillimore të Përgjithshme dhe konform normave dhe standardeve të ligjeve dhe akteve nënligjore;

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: përveç kushteve Zhvillimore të Përgjithshme. Materiali për ndërtimin e stallave preferohet të jetë blloqe, konstruksione të drurit apo metalike ndërsa ndërtesave mbështetëse nga materiale miqësore ndaj natyrës dhe materiale karakteristike për zonën. Kulmi të jetë dy uJOR i mbuluar me tjegulla apo llamarinë të valëzuar. Kushtet tjera duhet të përputhen me specifikat e ndërtesës;

Siguria nga zjarri: përputhen me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para se të filloj ndërtimi i ndërtesave bujqësore duhet të sigurohen kushtet higjieniko-sanitare, teknike, dhe të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore, ujësjellësit, ujitjes, kanalizimit, energjisë, gropa septike të papërshkueshme nga uji, etj.


Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: sipas Kushteve Zhvillimore të Përgjithshme.

Masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës bujqësore: masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës bujqësore për ndarjen apo bashkimin e parcelave rregullohet me legjislacionet respektive në fuqi. Sipas Ligjit nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kërkohet të kryhet raport i VNM-së për llojet e projekteve apo stallave të listuara në shtojcën 1 dhe 2 të këtij ligji.

Bonuset e zonimit: Autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor legjislacionet në fuqi si p.sh. Ligjin për tatimin në pronë i cili parasheh lirimin nga tatimi në pronë për pronarët që punojnë tokën bujqësore, apo dhe instrumente tjera. Do të ofrohen lehtësira nga komuna si rritja e ISN-së nëse është e nevojshme që për interesin publik të përdoret pjesë e tokës bujqësore nga Komuna për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe për shtrirjen e infrastrukturës së transportit dhe të shërbimeve publike.

Jonkonformitetet: nëse në këtë zonë ekzistojnë zhvillime apo objekte të cilat zhvillohen apo janë ndërtuar pa pëlqimin dhe lejen e MBPZHR si dhe të Komunës dhe të cilat nuk janë në harmoni me kërkesat e HZK-së ato do të jenë subjekt i “ngrirjes së zhvillimit” dhe duhet të trajtohen përmes programeve të veçanta apo ligjeve respektive. Për këto zhvillime/objekte komuna nuk ka detyrim të siguroj dhe të ofrojë infrastrukturën rrugore dhe teknike dhe shërbimet.

Harta 5 Zona bujqësore



5.3 Zona e banimit

Zonë e banimit konsiderohet sipërfaqja e caktuar kryesisht për qëllime të banimit¹⁰. Sipas HILUCS, banimi përfshin këto nënkategori:

- **Banim i përhershëm**
- **Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri**
- **Banim tjetër**


Banimi i përhershëm përfshin hapësira banimi të dominuara nga ndërtesat e banimit individual (shtëpitë e veçanta të rrethuara me kopshte dhe/ose oborre, apo në kombinim me shtëpitë veçanta, shtëpi dyshe, shtëpi në varg) kryesisht shtëpi individuale me sipërfaqe deri në 450m²¹¹ dhe ndërtesat e banimit me shumë njësi. Në këtë HZK, banim i përhershëm nënkupton dominimin deri në 90% me funksion të banimit dhe 10% funksione tjera.

Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri: përfshin hapësira të caktuara për banim të kombinuar me funksione të tjera në pajtueshmëri (p.sh. shërbime të ndryshme, industri të lehta etj). Në këtë HZK, banimi me funksione të tjera në pajtueshmëri nënkupton dominim e banimit (70% banim) dhe pjesa tjetër (30%) për funksione mikse që janë në pajtueshmëri me funksionin e zonës (shërbime tregtare/afarizëm, prodhime bujqësore komerciale, infrastrukturë bujqësore, disa aktivitete të prodhimit të lehtë industriale me kapacitet të ulët).

Banim tjetër përfshin hapësira të caktuara për banim të përkohshëm. Në këtë HZK kjo klasë e banimit përfshin shtëpitë malore, vikend shtëpiza e të ngjashme, të cilat shfrytëzohen kryesisht gjatë fundjavave, pushimeve sezonale etj.

¹⁰ Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor


¹¹ Ligji Nr.04/110 për ndërtim




Duke ju referuar NTPH për strukturat e ndërtuara në referencë të dendësisë së banimit si dhe karakteristikave zhvillimore, është bërë ky përcaktim i nën-zonave të banimit:

- Nën-zona e banimit ZB-1: Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët të zhvillimit;
- Nën-zona e banimit ZB-2: Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë të zhvillimit
- Nën-zona e banimit ZB-3: Sipërfaqet sub-urbane dhe qendrat bazike
- Nën-zona e banimit ZB-4: Sipërfaqe e përgjithshme urbane
- Nën-zona e banimit ZB-5: Sipërfaqe urbane qendrore

Harta 7 Harta e nën-zonave të banimit



Harta 8 Harta e nën-zonave të banimit në zonën urbane



5.3.1 Nën-zona e banimit ZB-1: Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët të zhvillimit

Përfshin vendbanimet krejtësisht rurale me dendësi të banimit **deri në 10b/ha** të cilat të karakterizuara me një intensitet shumë të ulët të zhvillimit në të cilat mungojnë funksionet eksterne. Në këto vendbanime zhvillohen vetëm ato funksione interne të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të përditshme të popullsisë së atij vendbanimi të cilët merën kryesisht me bujqësi. Këto janë fshatra tipike bujqësore të cilat paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë. Shumica prej tyre janë të vendosura më larg qendrës dhe në viset kodrinore-malore dhe funksioni i tyre është i lidhur kryesisht për qendrat rurale. Do të synohet ruajtja e karakterit rural prandaj mbrojtjes së tokës bujqësore dhe peisazheve natyrore do t'i kushtohet rëndësi. Ndërtimi me "ishuj" duhet të parandalohet. Sipas PZHK, tek këto sipërfaqe do të ketë vetëm **plotësim** me qëllim të krijimit të kompaktësisë dhe lehtësirave në investimet në infrastrukturën rrugore dhe atë teknike. Për këtë arsye, renditja e objekteve të banimit kryesisht do të jetë e lidhur për vijën kryesore të komunikacionit në vendbanim. Në rastet e vetmuara të sipërfaqeve të ndërtuara jashtë zonës së banimit do të aplikohet parimi i "jokonfirmimitet (ngirirja e gjendjes)" dhe komuna nuk obligohet të ofrojë infrastrukturë rrugore dhe teknike.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara:

- Banim i përhershëm;
- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri;
- Infrastrukturë e transportit rrugor, ndalesat e autobusëve;
- Shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të zonës: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit të cilat mund të gjenden:

- shërbime të komunitetit (shërbime arsimore, fetare);
- shërbime argëtuese dhe rekreative (parqe, gjelbërim, terrene sportive, pishina,...);
- shërbime tregtare me pakicë (shërbime të ushqimit-shitore, dhe hotelierisë (restaurante, bare);
- hapësira të vogla për riparim të automjeteve dhe pajisjeve personale dhe shtëpiake e të ngjashme;
- hapësira të vogla artizanale;
- prodhim bujqësor për konsum vetjak dhe infrastrukturë bujqësore si sera dhe ferma të vogla¹²

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin:

- veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit. Dimensionit të parcelës për shfrytëzimet dytësore i shtohet sipërfaqja e nevojshme për strukturat dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse.
- prodhim bujqësor për konsum vetjak, si sera dhe ferma të vogla¹³;
- objekte për ruajtjen e ushqimit të bagëtisë (sanës, ushqimit të koncentruar, gropat e betonuara të siloseve dhe kullat e silosit);
- objektet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore (hambarët, koshat, depo për ruajtjen e bulmetit);
- objekte për depozitim e plehut, druve;
- objektet tjera si garazhe për automjete dhe teknikën bujqësore, punishtet e tymosjes, tharëset, veranda e të ngjashme;


Shfrytëzimet e veçanta të lejuara: shërbime tregtare me shumicë

Shfrytëzimet e përkohshme përfshijnë: pikat e shitjes së prodhimeve bujqësore/blegtorale), mbledhja e prodhimeve, tenda për panair apo manifestime të caktuara.

Shfrytëzimeve të ndaluara: të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen apo nuk përkohjnë me funksionin e ngjashëm të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

¹² Shih përcaktimin për fermat e vogla në seksionin Zona bujqësore

¹³ Shih përcaktimin për fermat e vogla në seksionin Zona bujqësore



5.3.2 Nën-zona e banimit ZB-2: Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë të zhvillimit

Janë vendbanime me intensitet më të lartë të zhvillimit, me dendësi të banimit deri në 50b/ha, ku përveç objekteve të banimit, bujqësisë dhe ekonomisë së vogël zhvillohen edhe funksione tjera eksterne të cilat u shërbejnë popullsisë së vendbanimit por edhe atyre përreth. Në këto sipërfaqe të vendbanimeve, ashtu siç e ka përcaktuar PZHK, është paraparë **zgjerim i ri** i zonave të banimit (përveç Pollatës, Zhitisë, Krushevicës, Rakinicës, Herticës, Bërvenikut dhe Tërrnavës), **dendësimi dhe plotësimi** në kuadër të konturave ekzistuese të vendbanimeve dhe atë ndërmjet grupacioneve ekzistuese me qëllim që të formohet vendbanim më i dendur dhe mbrohet toka bujqësore. Për të mundur dendësimin, do të lejohen **rehabilitimet** ku përfshihen shtesat dhe zgjerimet në ndërtesat ekzistuese, **prishjet dhe rindërtimet** duke ju përshtatur kushteve të rregullimit të zonës. Në shumicën e vendbanimeve renditja e objekteve ndërtimore do të jetë kryesisht e lidhur për vijën e komunikacionit rrugor dhe atij hekurudhor gjegjësisht në disa rrugë lokale të fshatit si dhe rrugët e fushave të lidhura me këto vija. Në rastet e vetmuara të sipërfaqeve të ndërtuara në toka bujqësore do të aplikohet parimi i “jo-konformitetit (ngjirja e gjendjes)”.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara:

- Banim i përhershëm
- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri
- Infrastruktura e transportit rrugor, ndalesat e autobusëve;
- Shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime të komunitetit (shërbime arsimore, shëndetësisë, fetare);
- shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative (parqe, gjelbërim, terrene sportive, pishina,...);
- shërbime tregtare me pakicë (shërbime të ushqimit-shitore, dhe hotelierisë (restaurante, bare) dhe shumicë
- hapësira të vogla për riparim të automjeteve, pajisjeve personale dhe shtëpiake e të ngjashme, autolarje;

- hapësira të vogla artizanale;
 - prodhim bujqësor për konsum vetjak, si sera dhe ferma të vogla
- Shfrytëzimet dytësore të lejuara në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin:* veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit. Dimensionit të parcelës për shfrytëzimet dytësore i shtohet sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e strukturave dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse.
- prodhim bujqësor për konsum vetjak, si sera dhe ferma të vogla¹⁴;
 - objekte për ruajtjen e ushqimit të bagëtisë (sanës, ushqimit të koncentruar, kullat e silosit e të ngjashme);
 - objektet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore (hambarët, koshat, depo për ruajtjen e bulmetit);
 - objekte për depozitimin e plehut, druve;
 - objektet si garazhe për automjete e teknikën bujqësore, punishtet e tymosjes, tharëset, veranda e të ngjashme;


Shfrytëzimet e veçanta të lejuara:

- shërbime tregtare me shumicë;
- shërbime të industrisë së prodhimeve të lehta (hapësira për prodhimin e pijeve, ushqimeve; prodhim të rrobave dhe lëkurës, prodhim të mobilieve, instrumenteve muzikore e të ngjashme) me kapacitet të ulët prodhues dhe sipërfaqe jo më shumë se 1000m²;
- disa shërbime të industrisë së lëndës së parë me kapacitet të ulët prodhues të zhvilluar në sipërfaqe jo më madhe se 1000m² ku përfshihet: prodhimi i drurit (hapësira për përpunimin e drurit-zdrukthëtari), prodhim të letrës, kartonit, gomës dhe plastikës, e të ngjashme);
- prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë (hapësira ku mund të prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishme (penele diellore);

Shfrytëzimet e përkohshme përfshijnë: pikat e shitjes së prodhimeve bujqësore/blegtorale), mbledhja e prodhimeve, tenda për panairë apo manifestime të caktuara.

Shfrytëzimeve të ndaluara: të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionin e ngjashëm të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

Harta 10 Harta e nën-zonës së banimit ZB-2



¹⁴ Shih përcaktimin për fermtat e vogla në seksionin Zona bujqësore

5.3.3 Nën-zona e banimit ZB-3: Sipërfaqet sub-urbane dhe qendrat bazike

Këtu përfshihen tri nën-qendrat – qendrat bazike (Kërpimëh, Orllan dhe Lluzhan) si dhe tri njësitë urbane “Qendra 2 Veri Blloku 2 dhe 3”, “Qendra 2 Lindje- blloku 3 dhe Qendra 2 Jug Blloku 3”. Këto të fundit paraqesin njësitë të cilat janë në kufi me zonën rurale dhe zonën bujqësore brenda kufirit kadastral të Podujevës. Si të tilla kanë dendësi më të ulët të banimit deri 30-105 b/ha, janë të dominuar nga banimi individual, si dhe ofrojnë shërbime të nevojshme për komunitetin. Në parcelat përgjatë rrugëve rajonale të cilat gjenden në këtë tërësi, pjesërisht është i zhvilluar banimi me funksione tjera në pajtueshmëri, i njëjti funksion planifikohet të vazhdojë të **plotësohet dhe dendësohet**. Për shkak të karakterit të njësive inkurajohet zhvillimi i banimit të përhershëm por edhe atij me funksione tjera në pajtueshmëri në të cilat do të mund të zhvilloheshin **aktivitete të bujqësisë urbane** ashtu siç edhe është praktikuar deri më tani. Në përgjithësi këto njësi karakterizohen me mungesë të hapësirave rekreative dhe sportive, në veçanti njësia Qendra 2 Jug, po ashtu edhe me mungesë të tokave komunale për ndërtimin e këtyre përmbajtjeve. Në të ardhmen komuna duhet të ndërmerr masa për të siguruar hapësira rekreative për banorët në këtë pjesë të qytetit.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara:

- Banim i përhershëm
- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri (ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet me shërbim tregtar dhe shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare në përdhese të objektit dhe atë vetëm në parcelat që kanë qasje direkte në rrugët nacionale, rajonale apo rrugën kryesore të vendbanimit-vlen për qendrat bazike, si dhe rrugët urbane përmbledhëse).
- Infrastruktura e transportit rrugor, ndalesat e autobusëve;
- Shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime të komunitetit (shërbime arsimore, shëndetësisë, fetare);
- shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative (parqe, gjelbërim, terrene sportive...);
- shërbime tregtare: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, pije; shitore me pakicë;
- shërbime të hotelierisë (restaurante, bare, bujtina);
- hapësira të vogla për riparim të automjeteve dhe pajisjeve personale dhe shtëpiake e të ngjashme, autolarje;
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare;
- hapësira të vogla artizanale;
- Parkingje;

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit. Dimensionit të parcelës për shfrytëzimet dytësore (kur ato planifikohen si ndërtesa/hapësira të veçanta nga ndërtesa e banimit) i shtohet sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e strukturave dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse.

- prodhim bujqësor për konsum vetjak, si sera dhe ferma të vogla (vlen për qendrat bazike)¹⁵;
- objekte për ruajtjen e ushqimit të bagëtisë (sanës, ushqimit të koncentruar, gropat e betonuara të siloseve dhe kullat e silosit);
- objektet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore (hambarët, koshat, depo për ruajtjen e bulmetit);
- objekte për depozitimin e plehut, druve;
- objektet tjera si garazhe për automjete dhe teknikën bujqësore, punishtet e tymosjes, tharëset, veranda e të ngjashme;

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime tregtare me shumicë;
- shërbime të industrisë së prodhimeve të lehta (hapësira për prodhimin e pijeve, ushqimeve; prodhim të rrobave dhe lëkurës, prodhim të mobilie, instrumenteve muzikore e të ngjashme) me kapacitet të ulët prodhues dhe sipërfaqe jo më shumë se 1000m²;


¹⁵ Shih përcaktimin për fermat e vogla në seksionin Zona bujqësore

- disa shërbime të industrisë së lëndës së parë me kapacitet të ulët prodhues të zhvilluar në sipërfaqe jo më madhe se 1000m² ku përfshihet: prodhimi i drurit (hapësira për përpunimin e drurit-zdrukthëtari), prodhim të letrës, kartonit, gomës dhe plastikës, e të ngjashme;
- prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasa (hapësira ku mund të prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishme (panele diellore);

Shfrytëzimet e përkohshme: Pikat e shitjes së prodhimeve bujqësore (treg ditor mobil), shërbime argëtuese si festivale, koncerte, panaire.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Harta 11 Harta e nën-zonës së banimit ZB-3



Kushtet zhvillimore për ZB-1, ZB-2 dhe ZB-3

KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET E LEJUARA PRIMARE PËR ZB-1									
Brecë; Dumnicë e Epërme; Pakashticë e Epërme; Pakashticë e Poshtme; Lupç i Epërm; Dvorishtë; Majac; Murgull, Popovë, Repë, Përpellac; Potok; Reçicë, Tërnavicë; Sllatinë; Sylevicë, Zhiti; Bllatë; Muhazob; Surdull, Brainë; Metergoc; Turuçicë, Kushevicë; Bërvenik, Barainë Kalaticë; Dyz; Rakinicë; Halabak									
DB (b/ha)	Tipologjia e banimit	MP (m ²)	SGJP (%)	ISHPKZh (%)	ISN	SNP (%)	Etazhiteti	FP	
Kuptimi i shkurtesave: DB-Dendësia e banimit; MP-Madhësia e parcelës; SGJP-Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (%); ISHPKZh-Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (%); ISN-Indeksi i sipërfaqes ndërtimore (vlera max.); SNP-Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (vleramax.); Etazh-Etazhiteti; FP-Fronti i parcelës									
Deri 10b/h a	Banimi i përhershëm (BP) tek 3 nën-qendrat	Shtëpi të veçanta	400-600	50+10%pllakosje	40	Deri 0.5	Vlera max.50%	Deri B+P+1	Min 15m'
		Shtëpi dyshe (secila)	250-450 (secila)	50+10%pllakosje	40				Min 12m'
	Banim me funksione tjera në	Shtëpi të veçanta	400-600	50+10%pllakosje	40	Deri 0.5			Min 15m'

	pajtueshmëri -BFP me një njësi (përgjatë rrugëve rajonale dhe rrugës kryesore të vendbanimit)	Shtëpi dyshe	250-450 (secila)	50+10%pllakosje	40				Min 12m'
	Banim tjetër (shtëpi malore në Reçicë, Murgull, Popovë, Bellasicë)	Shtëpi të veçanta	200-300 (secila)	20+10%pllakosje	70	Deri 0.5	/	Deri P+NK	/

KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET E LEJUARA PRIMARE PËR ZB-2

Dobërdol; Zakut; Bradash; Buricë; Dobratin; Llaushë; Metehi; Revuq; Velikarekë, Pollatë, Shajkofc, Batllavë, Herticë, Merdar; Miroc; Sallabajë; Siboc i Epërm; Siboc i Poshtëm; Bajçinë; Shakovicë; Balloc; Penuhë, Bellopojë; Dumnicë e Poshtme; Dumosh; Shtedim; Gërdoc; Godishnjak; Kaçybeg; Kunushec; Lladoc; Llapashticë e Epërme; Llugë, Letanc; Tërrnavë, Gllamnik; Lupç i Poshtëm; Radujevc; Surkish; Llapashticë e Poshtme; Sfeqël; Livadicë; Obrançë, Peran.

DB (b/ha)	Tipologjia e banimit		MP (m ²)	SGJP (%)	IShPKZh (%)	ISN	SNP (%)	Etazhiteti	FP
Deri 50b/ha	Banimi përherëshëm (BP)	Shtëpi të veçanta	400-600	50+10%pllakosje	40	Deri 0.7	Vlera max.50%	Deri B+P+2	Min 15m'
		Shtëpi dyshe	250-450 secila	50+10%pllakosje	40				Min 12m'
	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri -BFP me një njësi (përgjatë rrugëve rajonale dhe rrugës kryesore të vendbanimit)	Shtëpi të veçanta	400-600	40+10%pllakosje	50	Deri 0.7			Min 15m'
		Shtëpi dyshe	250-450 secila	50+10%pllakosje	40				Min 12m'
		Shtëpi në varg	200-300 secila	60+10%pllakosje	30				Min 6m'

KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET E LEJUARA PRIMARE PËR ZB-3

Qendrat bazike (Kërpimëh, Orllan dhe Lluzhan), njësitë urbane "Qendra 2 Veri Blloku 2 dhe 3", "Qendra 2 Lindje- blloku 3 dhe Qendra 2 Jug Blloku 3"

DB (b/ha)	Tipologjia e banimit		MP (m ²)	SGJP (%)	IShPKZh (%)	ISN	SNP (%)	Etazhiteti	FP
30-105 b/ha	Banimi përherëshëm (BP) në nën-qendrat	Shtëpi të veçanta	300-500	50+10%pllakosje	Deri 40%	Deri 1	40	Deri B+P+1	Min 10m'
		Shtëpi dyshe	250-450 secila	50+10%pllakosje	Deri 40%		60		Min 12m'
		Shtëpi në varg	200-300 secila	60+10%pllakosje	50-80%		70		Min 6m'
	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri BFP me një njësi në Qendrat urbane kurse në nën-qendra përgjatë rrugëve lokale	Shtëpi të veçanta	400-600	40+10%pllakosje	Deri 40%	Deri 1	50	Deri B+P+2	Min 15m'
		Shtëpi dyshe	250-450 secila	50+10%pllakosje	Deri 40%		60		Min 12m'
		Shtëpi në varg	200-300 secila	(10-40)+10%pllakos.	50-80%		70		Min. 6m'

KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET TJERA TË LEJUARA PËR ZB-1, ZB-2 dhe ZB-3


Infrastrukturë bujqësore për konsum vetanak dhe ferma të vogla	Referoju normave të dhëna në zonën bujqësore									
Shërbime tregtare	me pakicë	deri 500m ²	30+20%pllakosje	Deri 50%	0.1-0.25			Deri P+1	Min. 10m'	
	me shumicë (për ZB-2)	1000m ²	30+20%pllakosje	50%	Deri 0.8			P+1	20-25m'	
Shërbime hotelierie (restaurante, bare)		200-500m ²	30+20%pllakosje	Deri 50%	0.1-0.25			P+0 (3.5m')	10-15m'	
Shërbime hotelierie (bujtina)		Referoju normave të dhëna në zonën turistike								
Riparimi i automjeteve dhe pajisjeve		700m ²	30+20%pllakosje	Deri 50%	Deri 0.4			P+0 (4m')	10-12	
Hapësira të vogla artizanale		Deri 500m ²	30+20%pllakosje	Deri 50%	0.1-0.25			Deri P+1	Min. 10m'	

Shërbime të industrisë të prodhimeve të lehta me kapacitet të ulët prodhues (Sipërfaqe jo më shumë se 1000m²)


Referoju normave të dhëna në zonën industriale

Disa shërbime të industrisë së lëndës së parë me kapacitet të ulët prodhues (Sipërfaqe jo më shumë se 1000m²)

Madhësia e parcelës: Rregullimi i procedurave për ndarjen apo bashkimin e parcelave për të arritur madhësinë maksimale, minimale apo frontin minimal të parcelës rregullohet me legjislacionet respektive në fuqi. Parcelat mund të ndahen dhe bashkohen kur kanë një dallim mbi 20% me limitin e përcaktuar me HZK; për diferencën deri në 20% mund të trajtohen pa ju nënshtruar procesit të ndarjes dhe bashkimit. Për shfrytëzimet dytësore dhe ato të lejuara të veçanta dimensionit të parcelës ndërtimore për objekt të banimit, duhet t'i shtohet sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e strukturave dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse. Me këtë HZK janë dhënë dy modele për mënyrat e organizimit të funksionit të banimit dhe strukturave dytësore në kuadër të parcelës kadastrale në vendbanimet rurale (shih figurat e mëposhtme)



Parcela kadastrale deri në 10 ari – Varianti 1 dhe 2



Parcela kadastrale deri në 20 ari

Vija ndërtimore (VN): përcaktohet në raport me kategorinë e rrugës (shih normat për profilet rrugore të dhëna në seksionin “Sipërfaqet e rrjetit të transportit” të HZK-së:

- *Rrugët lokale që lidhin dy a më shumë vendbanime (transite):* vija ndërtimore për objektet e banimit të përhershëm duhet të jetë minimum 14.5m’ e matur nga vija aksiale qarkulluese (VAQ), kjo për shkak se brezi mbrojtës rrugor për rrugët lokale në të cilat nuk lejohet ndërtimi i objekteve të banimit nuk duhet të jetë më i $\leq 10m'$.
- *Rrugët primare të vendbanimit:* vija ndërtimore për objektet e banimit të përhershëm duhet të jetë minimum 9.5m’ e matur nga vija aksiale qarkulluese (VAQ). Për objektet e banimit me funksione në përshtatshmëri në kuadër të cilave mund të ketë funksione tjera që zhvillohen në përdhesen e objektit, vija ndërtimore mund të jetë minimum 7.5m’ e matur nga VAQ.

- *Rrugët sekondare të vendbanimit*- vija ndërtimore duhet të jetë minimum 7.75m' për rrugët sekondare dykahëshe e matur nga VAQ respektivisht minimum 6.8m' për rrugët një-kahëshe e matur nga VAQ.

Në rastet kur kërkohen distanca më të mëdha mbi ato të dhëna se kushtet e HZK-së (p.sh. kur zhvillohen projekte qeveritare, sidomos kur është në pyetje përcaktimi i brezit mbrojtës), për përcaktimin e vijës ndërtimore do të merren parasysh dispozitat që derivojnë nga legjislacioni në fuqi.

Vija ndërtimore ndihmëse (VNN) apo daljet nga gabariti i objektit, nuk mund ta tejkalojë vijën ndërtimore më shumë se 1.6m' dhe atë në pjesët e objektit me lartësi mbi 3m. VNN në projektion horizontal përcaktohet në raport me vijën ndërtimore. Strukturat e mëposhtme që mund të vendosen jashtë vijës ndërtimore përfshijnë:

- Rrethojat dhe muret mbajtëse;
- Strehët dhe pjesët e zgjatura të kulmeve/ mbulesave, deri në 7.5m gjerësi nga muri i jashtëm i ndërtesës;
- Ballkonet, tarracat, hyrjet, verandat, dritaret e dala ose kutitë e dritareve (të mbështetura apo konzolë):
 - që janë jo më shumë se 8m mbi nivelin e tokës, janë të pambuluara ose pa kullm dhe lejojnë absorbimin e reshjeve atmosferike; ose
 - që janë më shumë se 8m mbi nivelin e tokës dhe të mbuluara ose me kullm, dhe që nuk kanë në total sipërfaqe më shumë se 5m² (në prerje ortogonale).

Vija rregulluese (VRr) duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese ose të planifikuar (në rastet kur planifikohet rrugë e re). Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale qarkulluese (VAQ).

Qasja në parcelë: Kushtet ndërtimore duhet të kërkojnë bazë ligjore të së drejtës për qasje nga parcela kadastrale në rrugë publike. Qasja në parcelë do të bëhet përmes shfrytëzimit të rrugës ekzistuese (kjo sepse zvogëlon shpenzimet për ndërtim të ri të rrugës për qasje) ose rrugës së planifikuar me PZHK.

Kushte shtesë për qasjen dhe mënyrën e hyrjes në parcelë përfshijnë:

- Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje ndaj një rruge publike ose private në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me anë të krijimit të një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Gjerësia e hyrjes private në parcelë e cila nuk ka qasje direkte nga rruga publike nuk mund të jetë <2,5m;
- Hyrja në objekt parashihet në anën e objektit përdhese e të cilit është në nivel ose pak e ngritur në raport me terrenin.

Në rastet e zhvillimeve të reja, kur ekziston mundësia e paraqitjes së problemeve të qasjes në parcelë si në vijim, atëherë mund të aplikohet këto kushte të veçanta:

- Pronari i tokës apo investitori që dëshiron të ushtrojë një zhvillim të ri duhet të dëshmojë që zhvillimi i propozuar nuk cenon qasjen e papenguar për pronarët apo shfrytëzuesit e parcelave kadastrale fqinje;
- Në rast se zhvillimi i ri propozohet në parcelë kadastrale e cila gjendet në mes të rrugës publike dhe parcelës fqinje nuk ka qasje tjetër në rrugë publike, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të krijojë një shteg me gjerësi së paku 3m' dhe lartësi së paku 4m' përgjatë kufirit të parcelës kadastrale nga rruga publike deri në kufirin e parcelës kadastrale fqinje që nuk ka qasje tjetër në rrugë publike;
- Para se të jepet pëlqimi për zbatimin e zhvillimit të ri, pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë marrëveshjen në mes të pronarit apo shfrytëzuesit të parcelës fqinje të cilit i cenohet e drejta e qasjes në parcelën e tyre kadastrale;
- Në rast se pronari i tokës apo investitori që synon të shfrytëzojë parcelën kadastrale për zhvillime të reja nuk ka pasur mundësi të gjejë shfrytëzuesin apo pronarin e parcelës kadastrale fqinje, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar që shtegu i qasjes me gjerësi së paku 3 m' do të jetë në dispozicion të pronarit apo shfrytëzuesve të parcelës fqinje.

Vendosja e objektit në parcelë përgjatë rrugës publike, varet nga profili rrugor dhe rregullat përkatëse për rrugët publike. Për ndërtim në kufijtë anësor të parcelës, i vendosur përgjatë fqinjëve nevojitet marrëveshja paraprake me fqinjët. Në këtë rast, fasadat kah kufijtë me fqinjët nuk mund të kenë hapje dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri.

Distancat: përcaktimet për distancat ndërmjet objekteve dhe të objektit në raport me gjerësinë e rrugës publike dhe kufijtë e parcelës bëhen sipas rregullave të dhëna në UA për NTPH si:

- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në anët në të cilat nuk ka hapje primare apo ka vetëm hapje të kthinave sekondare është jo më e vogël se $\geq 4m$ ose $=0.0m$ me kusht që të respektohen rregullat për mbrojtjen nga zjarri. Në rast se distancës të barabartë me 0.0m, vendosja e nënkallimit për automjetet për zjarr-fikje është me gjerësi $\geq 4m$ dhe lartësi $\geq 5m$;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit me kthina primare në fasada nga ndërtesat afariste të cilat nuk ndikojnë në privatësinë e banimit, është jo më e vogël se lartësia e ndërtesës afariste;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe ndërtesat shëndetësore është jo më e vogël se 1.5H e ndërtesës më të lartë të banimit, në anën jugore ose juglindore;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesës dhe kufirit anësor dhe të pasmë të parcelave kadastrale me kthina primare në fasada është jo më e vogël se $\frac{1}{2} H$ e ndërtesës më të lartë të banimit. Në rast të pamundësisë, në zona veç më të ndërtuara (të mbushura me ndërtim më shumë se 60%), është së paku $\frac{1}{4}$ e lartësisë të ndërtesës më të lartë;

Përveç tyre aplikohen edhe:

- Distanca në mes të ndërtesave të veçanta të banimit me etazhitet përdhese është 5m' ndërsa për ato $>P+0$ është 6m';
- Për objekte të ndërtuara të cilat janë në distancë më të vogël se 3m ndërmjet vete, nuk mund të parashihen hapje në anët e fqinjve;
- Largësia e gabaritit bazë (pa lëshime) te shtëpitë e veçanta të banimit në pjesët anësore të oborrit të orientuara kah veriu dhe vijës kufizuese të parcelës fqinje është 2,5m; te shtëpitë dyshe e ato në në varg të ndërprerë 4m';
- Për objektet e ndërtuara të banimit të cilat janë të larguara nga kufiri i parcelës në distanca më të vogla se 4m, në anët fqinje të tyre nuk mund të parashihen hapje të hapësirave për banim;

Distancat në raport me objektet ekonomike:

- Distanca në mes të ndërtesave bujqësore (fermat) për konsum vetanak nga objekti për banim duhet të jetë minimum 15m';
- Vendgrumbullimi i plehut duhet të jetë i larguar nga objekti i banimit, bunari apo burimi i ujit së paku 20m' në kuotën më të ulët;
- Në vendbanimet rurale, vendgrumbullimi i plehut dhe tualeteve në natyrë mund të jenë të larguara nga objekti i banimit, pusi, ose burimi i ujit së paku 20m, dhe atë vetëm në kuotë më të ulët;

- Në rast se pjesët ekonomike të parcelave fqinje kufizohen drejtpërdrejt me njëra tjetrën, distanca e objekteve të reja ekonomike nga kufiri i parcelës nuk mund të jetë më pak se 1m;
- Nëse pjesa ekonomike e një parcele kufizohet drejtpërdrejtë me pjesën rezidenciale të parcelës tjetër, distanca e strukturave të reja ekonomike përcaktohet duke zbatuar rregullat e dhëna në paragrafin e mësipërm lidhur me vendosjen e objekteve ekonomike:
 - o Në parcelën me pjerrësi të terrenit prej rrugës publike (më poshtë), në rast të ndërtimit të ri, oborri rezidencial vendoset në kuotën më të lartë përgjatë rrugës. Gjerësia më e vogël e rrugës për qasje ekonomike në parcelë është 3m. Oborri ekonomik vendoset mbrapa oborrit rezidencial (më poshtë);
 - o Në parcelën me pjerrësi të terrenit kah rruga publike (më lart), në rast të ndërtimit të ri, oborri i objektit të banimit vendoset në kuotën më të lartë. Gjerësia më e vogël e rrugës për qasje në objekt të banimit është 2,5m kurse e asaj ekonomike 3m. Nëse janë plotësuar kushtet nga paragrafi paraprak, oborri ekonomik mund të jetë përgjatë rrugës publike, ndërsa objektet ekonomike në vijën ndërtimore.

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM

Gjatë dhënies së lejes ndërtimore, të mirren parasysh kushtet e zonave mbishtresore, të sipërfaqeve ujore, infrastrukturës teknike-brezat mbrojtës rrugor/hekurudhor si dhe rregullat e mëposhtme:

Zhvillimi i peisazhit, shiritat mbrojtës të gjelbërimit: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përfshijnë:

- Sipërfaqja ekzistuese gjelbëruese në kuadër të zonave të banimit duhet të ruhet;
- Në rast se në zonat e banimit sidomos ato të parapara për zgjerim, gjenden pemë ato nuk duhet të priten por të zhvendosen apo të përfshihen në gjelbërimin e zonës;

Dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për efikasitet të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Siguria nga zjarri: të merren parasysh kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku ½ e H së ndërtesës më të lartë.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para ndërtimit në parcelën për zhvillim duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike. Në parcelën ndërtimore duhet të sigurohen lidhjet e shërbimeve komunale të definuara në drejtimet për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (apo vend-lidhjet në gropa septike), rrjetin elektro-energjetik dhe telekomunikimit, etj.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme;

Formësimi arkitektonik-estetik: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kërkesa specifike për këtë zonë. Formësimi i objekteve të banimit në përgjithësi, duhet të jetë në përputhshmëri me strukturat e mjedisit përreth (rrethinës), në aspektin e parametrave elementar të formës dhe parimit të organizimit fizik të rrethinës. Gjatë formësimit të objektit të banimit duhet marrë parasysh: thjeshtësia e proporcioneve dhe formës, përshtatshmëria e formës së objektit me topografinë e terrenit, përshtatshmëria me kushtet klimatike dhe përdorimit të materialeve dhe vegjetacionit autokton, përkatësisht zbatimit të parimeve: unitetit, ambientalizimit dhe kontekstualitetit të hapësirës. Cilësia dhe mënyra e ndërtimit të shtëpive duhet ti përshtatet nevojave të popullsisë dhe orientimit të tyre prodhues, përkatësisht amvisërive bujqësore, të përziera dhe jobujqësore. Materializimi i objektit duhet të respektojë karakteristikat/atributet e lokalitetit/zonës, përmes përdorimit të elementeve autoktone si dhe të materialeve bashkëkohore, ngjyra e së cilës, tekstura dhe parametrat tjerë vizuel afirmojnë kualitetet mjedisore të planifikimit të zonës.

Kërkesat shtesë përfshijnë:

- Objektet e banimit të përhershëm dhe me funksione të përzier të jenë të ndërtuara nga materiali i fortë dhe i qëndrueshëm, kurse për shtëpitë malore të përdoren materialet natyrore si guri dhe druri. Materialet duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës, t'i përshtaten strukturës dhe karakterit të objektit; të përdoren aq sa është e mundur materiale që konsiderohen miqësore ndaj natyrës (tulle, dru, gurë e të ngjashme) dhe përdoren elemente ndërtimi karakteristike të zonës.

- Inkurajohet përdorimi i stilit arkitekturor të thjeshtë, pastër, pa shumë detaje.

- Fasada për objektet e përkohshme të jetë tërësisht nga druri apo kombinim i drurit, gurit dhe/apo tullës.

- Dritaret dhe dyert për objektet e banimit duhet të jenë nga druri apo PVC e preferueshme PVC me ngjyrë druri, kurse te shtëpitë malore të jenë nga druri apo PVC me ngjyrë druri. Nuk lejohet përdorimi i xhamave pasqyrë dhe atyre me ngjyrë;

- Kulmi duhet të jetë dy apo më shumë ujor. Nuk lejohet aplikimi i kulmit mansard. Përdorimi i kulmeve të rrafshëta nuk është i preferueshëm dhe sidomos në vendbanimet malore;

- Gardhi/rrethoja: për përcaktimin e llojit të rrethojës (rrethojë me mur, metal, gardh me materiale natyrore etj) duhet të merren parasysh disa faktorë: tipologjia e ndërtimeve në lagje, lokaliteti, madhësia e parcelës ndërtimore, trafiku etj.

- o Nëse rrethoja është nga druri, metali apo gjelbërimi i lartë, lartësia maksimale duhet të jetë 1.20cm;

- o Nëse është me mur, atëherë duhet të jetë deri në lartësinë 0.9m nga niveli i terrenit (trotuarit).

- o Nëse është rrethojë transparente mund të ketë lartësinë deri 1.4m. Rrethoja me mur dhe ajo transparente nuk do të lejohet për objektet e banimit të përkohshëm-vila, kjo me qëllim të ruajtjes së karakterit rural të zonës;

- o Rrethoja nga rruga me të cilën rrethohet parcela ndërtimore këndore nuk guxon të jetë më e lartë se 1m', kjo për shkak të sigurimit të shikimit vizuel të udhëkryqit;

- o Rrethoja e parcelave ndërtimore mes fqinjve mund të bëhet me mur të gjallë (me gjelbërim) i cili mbillet në boshtin e kufirit të parcelave ndërtimore. Në rastet ku mund të ketë edhe rrethoja të mundshme për objektet përbrenda parcelës së njëjtë ndërtimore (objektet ekonomike, kopshte, depo etj..), lartësia e rrethojës nuk guxon të kalojë lartësinë e rrethojës së jashtme;

- o Hapja e dyerve në kuadër të rrethojës nuk duhet të jetë jashtë vijës rregulluese.

- Streha kërkohet të jetë jo më shumë se 1 m;

- Me qëllim të përmirësimit estetik, komuna mund të vendos taksë më të mëdha për ndërtesat e papërfunduara ose të degraduara të cilat nuk plotësojnë kushtet optimale të banimit e të cilat ndikojnë negativisht në peisazhin rural apo urban dhe sigurinë e zonës përreth.

Bonuset e zonimit: mund të përdoren si stimul i propozuar nga komuna apo edhe investitori për të realizuar zbatimin e planit dhe përdoret sidomos në rastet e kompensimit, ekspropriimit të pronës private me qëllim të ofrimit të përmbajtjeve publike, infrastrukturës teknike (p.sh. zgjerimin e rrugëve, parkingjeve, trotuareve) apo hapësirave për rekrijim dhe të gjelbëra në kuadër të zonës së banimit. Komuna mund të përdor legjislacionet në fuqi si dhe instrumente tjerapër të realizuar bonuset e zonimit si Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, lirim nga tatimi në pronë e të ngjashme. Në raste kur dëshmohet se as ky mekanizëm nuk mund të zbatohet për arsye objektive, atëherë Komuna mund të fillojë me zbatimin e parimit të 50% të vijës ndërtimore ekzistuese;

Jonkonformitetet: jo-konformiteti të aplikohet tek rastet e objekteve të vetmuara të banimit në toka bujqësore, të cilat do të aplikohet mënyra “ngjirja e gjendjes”.

5.3.4 Nën-zona e banimit ZB-4: Sipërfaqe e përgjithshme urbane

Përfshin strukturat e ndërtuara në qytet me dendësi të ulët deri të mesme (105-200 b/ha) në të cilat zhvillohen funksionet ekonomike që shërbejnë gjithë territorin e komunës por në një shkallë më të ulët. Disa shfrytëzime tjera publike dhe sociale gjithashtu lejohen për aq sa nuk kanë ndikim negativ në mjedisin për banim. Këtu përfshihen njësitë urbane “Qendra 2 Veri-Blloku 1, Qendra 2 Lindje-Blloku 1 dhe Blloku 2 dhe Qendra 2 Jug Blloku 1 dhe 2”. Sipas planeve të mëhershme është paraparë **dendësimi i zonës**, prandaj HZK ka përcaktuar zhvillimin e banimit me funksione tjera në pajtueshmëri. Fokusi kryesor do të jetë ofrimi i infrastrukturës rrugore dhe të transportit, përderisa në mungesë të hapësirave tjera publike, terrenet e hapura sportive në kuadër të shkollave do të përmbushin nevojat e banorëve për hapësira rekreative dhe sportive. Në të gjitha rastet në sipërfaqen urbane qendrore është përfshirë edhe bonusi i zonimit. **Varësisht prej etazhitetit të përcaktuar në bllloqet përkatëse, kërkohet që zhvilluesi i projektit të paraqes një zgjidhje ideore urbanistike në përputhje me kushtet e përcaktuara me HZK.**

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara:

- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri (ndërtesa të banimit shumë-banesor). Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet me shërbim tregtar/profesional, shërbim profesional financiar dhe i informacionit, shërbime bankare në përdhese të objektit.
- Infrastrukturë e transportit rrugor, ndalesat e autobusëve;
- Shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime të komunitetit (shërbime arsimore, shëndetësisë, fetare);
- shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative (parqe, gjelbërim, terrene sportive...);
- shërbime tregtare me pakicë (shërbime të ushqimit-shitore),
- shërbime të hotelierisë (restaurante, bare);
- hapësira të vogla për riparim të automjeteve dhe pajisjeve personale dhe shtëpiake e të ngjashme, autolarje;
- hapësira të vogla artizanale;

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të njëjtit bllok: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit. Dimensionit të parcelës për shfrytëzimet dytësore i shtohet sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e strukturave dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse.

- Parkingje;
- Shërbime rekreative (gjelbërim, terrene sportive, shtigje për ecje.


Shfrytëzimet e veçanta të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime tregtare me shumicë;
- shërbime të industrisë së prodhimeve të lehta (hapësira për prodhimin e pijeve, ushqimeve; prodhim të rrobave dhe lëkurës, prodhim të mobilieve, instrumenteve muzikore e të ngjashme) me kapacitet të ulët prodhues dhe sipërfaqe jo më shumë se 1000m²;
- disa shërbime të industrisë së lëndës së parë me kapacitet të ulët prodhues të zhvilluar në sipërfaqe jo më madhe se 1000m² ku përfshihet: prodhimi i drurit (hapësira për përpunimin e drurit-zdrukthëtari), prodhim të letrës, kartonit, gomës dhe plastikës, e të ngjashme
- prodhim i energjisë së ripërtërishme (panelet diellore);

Shfrytëzimet e përkohshme: Pikat e shitjes së prodhimeve bujqësore (treg ditor mobil), shërbime argëtuese si festivale, koncerte, panaire.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Harta 12 Harta e nën-zonës së banimit ZB-4



5.3.5 Nën-zona e banimit ZB-5: Sipërfaqe urbane qendrore

Nënkupton strukturat e ndërtuara në qytet me dendësi të mesme deri të lartë ku madhësia maksimale e ndërtesave dhe intensiteti i zhvillimit rregullohet me kufizimet e ISN dhe kushtet tjera zhvillimore. Këtu përfshihet njësia urbane “Qendra 1”. Dendësia e banimit për këtë pjesë është paraparë të jetë 120-300 b/ha, pra parashihet dendësim. Në të gjitha rastet në sipërfaqen urbane qendrore është përfshirë edhe bonusi i zonimit. **Varësisht prej etazhitetit të përcaktuar në blloqet përkatëse, kërkohet që zhvilluesi i projektit të paraqes një zgjidhje ideore urbanisitike në përputhje më kushtet e përcaktuara me HZK.**

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara:

- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri (ndërtesa të banimit shumë-banesor). Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet edhe me shërbim komerciale, shërbim profesional financiar dhe i informacionit;
- Infrastrukturë e transportit rrugor, ndalesat e autobusëve;
- Shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime të komunitetit (shërbime arsimore, shëndetësisë, fetare);
- shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative (parqe, gjelbërim, terrene sportive...);
- shërbime tregtare me pakicë (shërbime të ushqimit-shitore),
- shërbime të hotelierisë (restaurante, bare);
- hapësira të vogla për riparim të automjeteve dhe pajisjeve personale dhe shtëpiake e të ngjashme, autolarje;
- hapësira të vogla artizanale;

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në **kuadër të njëjtit bllok**: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit. Dimensionit të parcelës për shfrytëzimet dytësore i shtohet sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e strukturave dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse.

- Parkingje;
- shërbime rekreative (gjelbërim, terrene sportive, shtigje për ecje)


Shfrytëzimet e veçanta të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime tregtare me shumicë;
- shërbime të industrisë së prodhimeve të lehta (hapësira për prodhimin e pijeve, ushqimeve; prodhim të rrobave dhe lëkurës, prodhim të mobilieve, instrumenteve muzikore e të ngjashme) me kapacitet të ulët prodhues dhe sipërfaqe jo më shumë se 1000m²;

Shfrytëzimet e përkohshme: Pikat e shitjes së prodhimeve bujqësore (treg ditor mobil), shërbime argëtuese si festivale, koncerte, panaire.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen përfshihen apo nuk përkohjnë me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Harta 13 Harta e nën-zonës së banimit ZB-5



Kushtet zhvillimore

KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET E LEJUARA PRIMARE PËR ZB-4-												
Njësitë urbane: Qendra 2 veri (Blloku 1); Qendra 2 Lindje (Blloku 1 dhe 2) dhe Qendra 2 Jug (Blloku 1 dhe 2)												
Blloku	Tipologjia	MP (m ²)	ISN max	IShPKZh (%)	SGJP (%)	SNP (%)	FP	GjB (max)	VN (m')	DAP 1	DAP 2	
Kuptimi i shkurtesave: MP-Madhësia e parcelës; SGJP-Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (%); IShPKZh-Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (%); ISN-Indeksi i sipërfaqes ndërtimore (vlera max.); SNP-Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (vlera max.); FP-Fronti i parcelës, GjB-Gjatësia maksimale e Bllokut, VN-Vija ndërtimore; DAP1- Distanca anësore nga parcela – me hapje primare; DAP2- Distanca anësore nga parcela – me hapje primare sekondare												
Q2 Veri-Blloku 1	Banim me	Ndërtesa veçanta (lamela)		3.2	50	30+20% pllakosje	70	20m'		23 m' – rrugë		

	funksi e tjera në përshtats hmëri	Ndërtesa në varg	1500 - 2499					15m' (lamelë)	50m'	përmbled hëse	Min 0.25 H zonë e ndërt uar	Min 0.10 H zonë e ndërt uar	
		Ndërtesa terracore						15m' (lamelë)	50m'	19.5 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe			
Q2 Lindje- Blok 1	Banim me funksi e tjera në përshtats hmëri	Ndërtesa veçanta (lamela)	1500 - 2499	3.2	50	30+ 20% pllakosje	70	20m'		20 m' – rrugë	Min 0.25 H zonë e ndërt uar	Min 0.10 H zonë e ndërt uar)	
		Ndërtesa në varg						15m' (lamelë)	50m'	përmbled hëse			
		Ndërtesa terracore						15m' (lamelë)	50m'	17 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe			
Q2 Lindje- Blok 2	Banim me funksi e tjera në përshtats hmëri	Ndërtesa veçanta (lamela)	1200 - 2499	1.8	40	40+ 20% pllakosje	70	20m'		20 m' – rrugë	Min 0.25 H zonë e ndërt uar	Min 0.10 H (zonë e ndërt uar)	
		Ndërtesa në varg						15m' (lamelë)	50m'	përmbled hëse			
		Ndërtesa terracore						15m' (lamelë)	50m'	17 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe			
Q2 Jug- Blok 1	Banim me funksi e tjera në përshtats hmëri	Ndërtesa veçanta (lamela)	1500 - 2499	3.2	50	30+20% pllakosje	70	20m'		20 m' – rrugë	Min 0.25 H zonë e ndërt uar	Min 0.10 H (zonë e ndërt uar)	
		Ndërtesa në varg						15m' (lamelë)	50m'	përmbled hëse			
		Ndërtesa terracore						15m' (lamelë)	50m'	17 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe			
Q2 Jug- Blok 2	Banim me funksi e tjera në përshtats hmëri	Ndërtesa veçanta (lamela)	1500 - 2499	1.6	40	40+20% pllakosje		20m'		20 m' – rrugë	Min 0.25 H zonë e ndërt uar	Min 0.10 H (zonë e ndërt uar)	
		Ndërtesa në varg						15m' (lamelë)	50m'	përmbled hëse			
		Ndërtesa terracore						15m' (lamelë)	50m'	17 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe			
KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET E LEJUARA PRIMARE PËR ZB-5-Njësia urbane Qendra 1													
Bloku	Tipologjia		MP (m²)	ISN max	ISHPKZh (%)	SGJP (%)	SNP (%)	FP	GJB (max)	VN (m')	DAP 1	DAP 2	
Q1- Blok1	Banim me funksi e tjera në pajtu esh mëri	Ndërtesa të veçanta (lamela)	2500 - 3500	4.8	50	30+20% pllakosje	70	20m'		23 m' – rrugë	Min 0.25 H zonë e ndërt uar	Min 0.10 H (zonë e ndërt uar)	
		Ndërtesa në varg							15m' (lamelë)	50m			përmbled hëse
		Ndërtesa terracore							15m' (lamelë)	50m			19.5 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe

Q1- Blloku 2	Banim me funksion e tjera në pajtuesh mëri	Ndërtesa të veçanta (lamela)	2500 - 3500	4.2	50	30+ 20% pllakosje	70	20m'	50m	23 m' – rrugë përmbledhëse 19.5 m' – rrugë banesore 15.5 m' – rrugë qasëshe	Min 0.25 H zonë e ndërtuar	Min 0.10 H (zonë e ndërtuar)
Q1- Blloku 3		Ndërtesa në varg						15m' (lamelë)				

Vija ndërtimore (VN)

Rrugët përmbledhëse duhet të jenë minimum 10.5m. Ato krijojnë qasje për rrugët banesore. Qasja direkte e objekteve të banimit të rrugët përmbledhëse duhet të shmanget dhe të shfrytëzohet vetëm në rastet e domosdoshme. Vija ndërtimore për objektet shumë banesore matet nga vija aksiale qarkulluese VAQ. VN e matur nga VAQ tek rrugët përmbledhëse është 18 m'. Për objektet shumë banesore VN nuk guxon të jetë më e vogël se 10m' nga balli i parcelës.

Rrugët banesore duhet të jenë minimum 8.5m. Ato kryesisht janë të projektuara brenda blloqeve të banimit. Mund të ju shtohet një shirit parkimi përgjatë rrugës me gjërësi 2.5m'. Vija ndërtimore (VN) për objektet shumë banesore matet nga vija aksiale qarkulluese VAQ. Në rastet kur ka shirit parkimi tek rrugët banesore VN është 19.5m' e matur nga VAQ, nëse nuk ka parkim gjatësor VN është 17.5m'. Për objektet shumë banesore VN nuk guxon të jetë më e vogël se 10m' nga balli i parcelës.

Rrugët për qasje (dykahëshe) duhet të jenë minimum 5.5 m nëse ato janë dykahëshe. Ato krijojnë qasje për objektet e banimit apo tjera. Mund të ju shtohet një shirit parkimi përgjatë rrugës me gjërësi 2.5m'. Vija ndërtimore (VN) për objektet shumë banesore matet nga vija aksiale qarkulluese VAQ. Në rastet kur ka shirit parkimi VN e matur nga VAQ tek rrugët për qasje është 16.5, nëse nuk ka parkim gjatësor VN është 14 m'. Për objektet shumë banesore VN nuk guxon të jetë më e vogël se 10m' nga balli i parcelës.

Rrugët për qasje (njëkahëshe) duhet të jenë minimum 3.5 m. Ato krijojnë qasje për objektet e banimit apo tjera. Mund të ju shtohet një shirit parkimi përgjatë rrugës me gjërësi 2.5m'. Vija ndërtimore (VN) për objektet shumë banesore matet nga vija aksiale qarkulluese VAQ. Në rastet kur ka shirit parkimi VN e matur nga VAQ tek rrugët për qasje është 14.5, nëse nuk ka parkim gjatësor VN është 12 m'. Për objektet shumë banesore VN nuk guxon të jetë më e vogël se 10m' nga balli i parcelës.

Vija ndërtimore ndihmëse (VNN) apo daljet nga gabariti i objektit, nuk mund ta tejkalojë vijën ndërtimore më shumë se 1.6m' dhe atë në pjesët e objektit me lartësi mbi 3m. VNN në projektion horizontal përcaktohet në raport me vijën ndërtimore. Strukturat e mëposhtme që mund të vendosen jashtë vijës ndërtimore përfshijnë:

- Rrethojat dhe muret mbajtëse;
- Strehët dhe pjesët e zgjatura të kulmeve/ mbulesave, deri në 7.5m gjerësi nga muri i jashtëm i ndërtesës;
- Ballkonet, tarracat, hyrjet, verandat, dritaret e dala ose kutitë e dritareve (të mbështetura apo konzolë):
 - që janë jo më shumë se 8m mbi nivelin e tokës, janë të pambuluara ose pa kulm dhe lejojnë absorbimin e reshjeve atmosferike;ose
 - që janë më shumë se 8m mbi nivelin e tokës dhe të mbuluara ose me kulm, dhe që nuk kanë në total sipërfaqe më shumë se 5m² (në prerje ortogonale).

Vija rregulluese (VRR) duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese ose të planifikuar (në rastet kur planifikohet rrugë e re). Vija rregulluese përcaktohet në raport me vijën aksiale qarkulluese (VAQ).

Qasja në parcelë: Kushtet ndërtimore duhet të kërkojnë bazë ligjore të së drejtës për qasje nga parcela kadastrale në rrugë publike. Qasja në parcelë do të bëhet përmes shfrytëzimit të rrugës ekzistuese (kjo sepse zvogëlon shpenzimet për ndërtim të ri të rrugës për qasje) ose rrugës së planifikuar me PZHK. Kushte shtesë për qasjen dhe mënyrën e hyrjes në parcelë përfshijnë:

- Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje ndaj një rruge publike ose private në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me anë të krijimit të një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Hyrja në objekt parashihet në anën e objektit përdhese e të cilit është në nivel ose pak e ngritur në raport me terrenin.

Në rastet e zhvillimeve të reja, kur ekziston mundësia e paraqitjes së problemeve të qasjes në parcelë si në vijim, atëherë mund të aplikohet këto kushte të veçanta:

- Pronari i tokës apo investitori që dëshiron të ushtrojë një zhvillim të ri duhet të dëshmojë që zhvillimi i propozuar nuk cenon qasjen e papenguar për pronarët apo shfrytëzuesit e parcelave kadastrale fqinje;
- Në rast se zhvillimi i ri propozohet në parcelë kadastrale e cila gjendet në mes të rrugës publike dhe parcelës fqinje nuk ka qasje tjetër në rrugë publike, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të krijojë një shteg me gjerësi së paku 3m' dhe lartësi së paku 4m' përgjatë kufirit të parcelës kadastrale nga rruga publike deri në kufirin e parcelës kadastrale fqinje që nuk ka qasje tjetër në rrugë publike;
- Para se të jepet pëlqimi për zbatimin e zhvillimit të ri, pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë marrëveshjen në mes të pronarit apo shfrytëzuesit të parcelës fqinje të cilit i cenohet e drejta e qasjes në parcelën e tyre kadastrale;
- Në rast se pronari i tokës apo investitori që synon të shfrytëzojë parcelën kadastrale për zhvillime të reja nuk ka pasur mundësi të gjejë shfrytëzuesin apo pronarin e parcelës kadastrale fqinje, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar që shtegu i qasjes me gjerësi së paku 3 m' do të jetë në dispozicion të pronarit apo shfrytëzuesve të parcelës fqinje

Vendosja e objektit në parcelë përgjatë rrugës publike, varet nga profili rrugor dhe rregullat përkatëse për rrugët publike. Për ndërtim në kufijtë anësor të parcelës, i vendosur përgjatë fqinjëve nevojitet marrëveshja paraprake me fqinjët. Në këtë rast, fasadat kah kufijtë me fqinjët nuk mund të kenë hapje dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri.

Distancat: përcaktimet për distancat ndërmjet objekteve dhe të objektit në raport me gjerësinë e rrugës publike dhe kufijtë e parcelës bëhen sipas rregullave të dhëna në UA për NTPH si:

- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në anët në të cilat nuk ka hapje primare apo ka vetëm hapje të kthinave sekondare është jo më e vogël se $\geq 4m$ ose $=0.0m$ me kusht që të respektohen rregullat për mbrojtjen nga zjarri. Në rast së distancës të barabartë me $0.0m$, vendosja e nënkallimit për automjetet për zjarr-fikje është me gjerësi $\geq 4m$ dhe lartësi $\geq 5m$;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit, me kthina primare në fasada; nga ndërtesat afariste të cilat nuk ndikojnë në privatësinë e banimit, është jo më e vogël se lartësia e ndërtesës afariste;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe ndërtesat shëndetësore është jo më e vogël se $1.5H$ e ndërtesës më të lartë të banimit, në anën jugore ose juglindore;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesës dhe kufirit anësor dhe të pasmë të parcelave kadastrale, me kthina primare në fasada është jo më e vogël se $1/4 H$ e ndërtesës më të lartë të banimit.

Përveç tyre aplikohen edhe:

- Distanca në mes të ndërtesave të veçanta të banimit me etazhitet përdhese është $5m'$ ndërsa për ato $>P+0$ është $6m'$;
- Për objekte të ndërtuara të cilat janë në distancë më të vogël se $3m$ ndërmjet vete, nuk mund të parashihen hapje në anët e fqinjve;
- Për objektet e ndërtuara të banimit të cilat janë të larguara nga kufiri i parcelës në distanca më të vogla se $4m$, në anët fqinje të tyre nuk mund të parashihen hapje të hapësirave për banim;

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Gjatë dhënies së lejes ndërtimore, të mirren parasysht kushtet e zonave mbishtresore, të sipërfaqeve ujore, infrastrukturës teknike-brezat mbrojtës rrugor/hekurudhor si dhe rregullat e mëposhtme:

Zhvillimi i paisazhit, shiritat mbrojtës të gjelbërimit: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përfshijnë:

- Sipërfaqja ekzistuese gjelbëruese në kuadër të zonave të banimit duhet të ruhet;
- Duhet të ruhen drunjtë ekzistues dhe të regjistrohesh;
- Në rast se në zonat e banimit sidomos ato të parapara për zgjerim, gjenden pemë ato nuk duhet të priten por të zhvendosen apo të përfshihen në gjelbërimin e zonës;

Dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për efijencë të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Siguria nga zjarri: të merren parasysht kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku $1/4$ e H së ndërtesës më të lartë.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para ndërtimit në parcelën për zhvillim duhet të sigurohet Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike. Në parcelën ndërtimore duhet të sigurohen lidhjet e shërbimeve komunale të definuara në drejtimet për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (apo vend-lidhjet në gropa septike), rrjetin elektro-energjetik dhe telekomunikimit, etj.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme;

Formësimi arkitektonik-estetik: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kërkesa specifike për këtë zonë.

- Parcelat ku zhvillohet banimi kolektiv është e ndaluar të rrethohen.
- Qendra e qytetit në veçanti duhet të i kushtohet rëndësi në harmonizimin e proporcioneve të objektit, vëllimit dhe ritmit arkitektonik.

Bonuset e zonimit: mund të përdoren si stimul i propozuar nga komuna apo edhe investitori për të realizuar zbatimin e planit dhe përdoret sidomos në rastet e kompensimit, eksproprijimit të pronës private me qëllim të ofrimit të përmbajtjeve publike, infrastrukturës teknike (p.sh. zgjerimin e rrugëve, parkingjeve, trotuareve) apo hapësirave për rekrijim dhe të gjelbëra në kuadër të zonës së banimit. Komuna mund të përdor legjislacionet në fuqi si dhe instrumente tjera për të realizuar bonuset e zonimit si Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, lirinë nga tatimi në pronë e të ngjashme.

Jonkonformitetet: Të gjitha zhvillimet ekzistuese të cilat nuk përkojnë me zhvillimet e lejuara në këtë zonë, apo me kushtet zhvillimore të specifikuar në këtë HZK, atëherë ato shpallen si zhvillime jo-konforme.

5.4 Zona e shfrytëzimit të përzier

Kjo zonë është e dedikuar për shfrytëzim të përzier të ndërtesave për banim, ndërtesave komerciale, bujqësore, industriale ose veprimtari tjera¹⁶.

Sipërfaqet e shfrytëzimit të përzier sipas projeksioneve të PZHK-së

Me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore PZHK ka inkurajuar që në periudhën e ardhshme në qendrën komunale, qendrat e bashkësive lokale dhe disa nga vendbanimet rurale të zhvillohet shfrytëzimi i përzier si banim dhe shfrytëzime shërbyese e prodhuese. Synohet që këto zona të ofrojnë shërbimet për vendbanimet në afërsi të këtyre vendbanimeve. Pas vlerësimit të situatës në Komunë, është vërejtur që zhvillimi i shfrytëzimit të përzier ndodh kryesisht përgjatë rrugës nacionale, segmentit të rrugës rajonale që kalon nëpër zonën urbane dhe brenda vet zonës urbane. Andaj bazuar në këtë trend, HZK synon që zhvillimi i shfrytëzimit të përzier që përfshinë 30% banim dhe 70% funksione tjera të zhvillohet përgjatë rrugës nacionale, rajonale të tërësisë qendër aktive dhe segmentit të rrugës rajonale që kalon nëpër qendrën komunale por edhe brenda saj. Shfrytëzimi i përzier përgjatë rrugëve

¹⁶ Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

nacionale dhe rajonale do të zhvillohet në konsultim me Ministrinë përkatëse dhe duke respektuar dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore për rrugë të këtij niveli.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: banim, shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, i akomodimit dhe ushqimit si motele e restorane, patundshmërisë, financiar, sigurimit, dhe profesional financiar, dhe shërbime të logjistikës dhe magazinimit (depo).


Shfrytëzimet e lejuara dytësore: banim, hapësirat e hapura rekreative, shërbim administrativ dhe mbështetës, si dhe rrjetet e transportit dhe infrastrukturës teknike (rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit, energjetik, TV, telefonisë)

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: industri e lehtë për prodhimin e produkteve të tekstit, prodhim i drurit dhe i produkteve bazë të drurit, prodhimi i produkteve jo metalike minerale (betonit), prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës (shishet e plastikës), prodhim i pijeve, ushqimeve, dhe produkteve të duhanit (lëngjeve), dhe infrastruktura teknike (trafostacionet dhe antenat e telefonisë celulare).

Shfrytëzimet e përkohshme: pikat e shitjes së prodhimeve bujqësore dhe shërbime argëtuese si panaire.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkohjnë me funksionet e ngjashme në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Harta 14 Zona e shfrytëzimit të përzier



Kushtet zhvillimore

Gjatë ndërtimit, rinovimit të objekteve për këto aktivitete të respektohen kushtet e dhëna me UA për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me shumicë dhe pakicë dhe për ndërmjetësim në tregti.

Tabela 7 Dimensionet e parcelës, intensiteti i zhvillimit, sipërfaqja e gjelbërimit dhe nëntokësore e parcelës.

Lloji i aktivitetit	MP (min)	FP	Lartësia Kat (m')	ISHPKZh	SGJP	ISN	SNP
---------------------	----------	----	-------------------	---------	------	-----	-----

Kuptimi i shkurtesave: MP-Madhësia e parcelës; SGjP-Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (%); IShPKZh-Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (%); ISN-Indeksi i sipërfaqes ndërtimore (vlera max.); SNP-Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (vlera max.); FP-Fronti i parcelës								
Banim i përhershëm		Referoju zonës së banimit përgjatë rrugëve dhe qendrës urbane						
Shërbime administrative, financiare, tregtare me pakicë e të sigurimit	300 m ²	8.0-10.0m'	P+1 (7.0 m') P+2 (10.0 m')	30%+20%pllakosje	50%	0.8-1.2	40%	
Riparimi i automjeteve dhe pajisjeve	700 m ²	10.0-12.0m'	P+0 (4.0m')	30%+20%pllakosje	50%	0.4	40%	
Shërbime të logjistikës dhe magazinimit	700 m ²	15.0-20.0m'	P+0 (5.0m')	30%+20%pllakosje	50%	0.4	40%	
Shërbime tregtare me shumicë	1000.0 m ²	20.0-25.0m'	P+1 (7.0m')	30%+20%pllakosje	50%	0.8	40%	
Shërbime akomodimi dhe ushqimi	Motel	1000 m ²	10.0-15.0m'	P+0 (3.5m')	30%+20%pllakosje	50%	0.4	40%
	Restoran	500 m ²	10.0-15.0m'					
Industri e lëndës së parë dhe e prodhimeve të lehta	2500 m ²	20.0-30.0m'	P+NK (10.00)	30%+20%pllakosje	50%	0.4	40%	
<p>Vija ndërtimore (VN) në rastet kur zona shtrihet përgjatë arterieve rrugore vija ndërtimore duhet të përcaktohet në përputhje me Ligjin në fuqi për Rrugët. Në rastet kur është e mundur të jetë 5.0' – 10.0m', në të kundërtën ajo do të respektojë vijën ndërtimore ekzistuese.</p> <p>Vija rregulluese (VRR) të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese ose të planifikuar në rastet kur kemi planifikim të rrugës.</p> <p>Qasja dhe vendosja e objektit në parcelë: në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por në rastin e depove mund të shtohet që depoja e mbuluar ose e hapur mund të ndërtohet vetëm në tokën (truallin) e thatë në të cilën është zgjedhur rrjedha e ujit apo është vendosur drenazhimi.</p> <p>Distancat: përcaktimet për distancat të jenë konform rregullave të dhëna në UA për Normat teknike të planifikimit hapësinor. Pavarësisht nga dispozitat e këtushme, distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës dhe në mes të ndërtesave. Në çdo rast distancat ndërmjet ndërtesave nuk duhet të jenë më të vogla sesa ekzistuese. Nëse nuk përcaktohet ndryshe me dokumentet e planifikimit hapësinor, ndërtimi mund të bëhet në kufijtë e parcelës kadastrale për zhvillim të vendosura përgjatë rrugës, kur VN përputhet me VRR. Për ndërtim në kufijtë e parcelës, i vendosur përgjatë fqinjëve nevojitet marrëveshja paraprake me fqinjët.</p> <p>RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:</p> <p>Gjatë dhënies së lejes ndërtimore, të mirren parasysh kushtet e zonave mbishtesore, të sipërfaqeve ujore, infrastrukturës teknike-brezat mbrojtës rrugor/hekurudhor si dhe rregullat e mëposhtme:</p> <p>Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.</p> <p>Ndriçimi natyror dhe artificial përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.</p> <p>Kërkesat për efijencë të energjisë përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.</p> <p>Kërkesat për zvogëlimin e zurmës përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.</p> <p>Formësimi arkitektonik dhe estetik përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por dhe kushteve specifike për zonën:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Inkurajohet përdorimi i stilit arkitekturor të thjeshtë, pastër, pa shumë detaje; - Dritaret e dyert duhet të jenë nga druri apo PVC. Nuk lejohet përdorimi i xhamave pasqyrë dhe me ngjyrë; - Kulmi mund të jetë i rrafshët, dhe dy apo më shumë ujor. Nuk lejohet aplikimi i kulmit mansard; - Streha kërkohet të jetë 0.9 m; - Gardhi/rrrethoja duhet të jetë nga druri, metali apo gjelbërimi i lartë, me lartësi maksimale 1.20 m'. Nëse është me mur, atëherë duhet të jetë deri në lartësinë 0.90m' nga niveli i terrenit (trotuarit). Nëse është rrethojë transparente mund të ketë lartësinë deri 1.40m'. Rrethoja nga rruga me të cilën rrethohet parcela ndërtimore këndore nuk guxon të jetë më e lartë se 1.0m' mirëpo në rastin e depove duhet të jetë 2.0m' dhe jo me tel gjemborë. - Sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti duhet të respektohen kushtet si në vijim: - hapësira para hyrjes në shitore duhet rregulluar dhe përgatitur në mënyrën që të mundëson pastrim të lehtë dhe mirëmbajtje të sipërfaqes si dhe zgjidhje që mundëson hyrjen dhe daljen e pa penguar në shitore; - nëse para shitores nuk ekziston tarracë e rregulluar, pjesa para shitores dhe vitrinës së shitores duhet asfaltuar, betonuar ose e rregulluar me pllaka të gurit ose në ndonjë mënyrë tjetër ashtu që të sigurojë lëvizje të lirë të personave dhe të mundësojë mbajtjen e pastërtisë; - depoja në të cilën ushtrohet shitja e mallrave me shumicë duhet të jetë e mbyllur, bëhen përjashtime dhe depoja mund të jetë zbuluar apo e hapur, nëse lloji i mallit ose kushtet klimatike një gjë të tillë e lejojnë. <p>Siguria nga zjarri: në përputhje me kushtet e Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri.</p> <p>Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para se të fillojë zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike. Sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti duhet të respektohet që mbeturinat e ngurta duhet të tubohen në vendet e caktuara duke siguruar kushtet shëndetësore-teknike si dhe largimin e tyre në mënyrën e përcaktuar nga administrata lokale.</p>								

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Masat për mbrojtje të mjedisit: për të shmangur ndikimet negative në mjedis si në ajër, ujë, tokë, zhvillimet ekzistuese duhet të respektojnë kërkesat e ligjeve dhe akteve nënligjore respektive në fuqi, ndërsa në rastin e objekteve të planifikuara duhet të kryhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM).

Bonuset e zonimit: nëse pronarët krijojnë apo mirëmbajnë hapësirat e gjelbëra publike, komuna do të krijoj lehtësira sa i përket taksave dhe rritje të kushteve të përcaktuara me HZK për këtë zonë.

Jonkonformitetet: /

Kushtet tjera: sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti duhet të respektohen kushtet si në vijim:

- panairët për prodhuesit afarist duhet të kenë objektet e mbyllura dhe të hapura të përshtatshme për organizimin e tyre si dhe të pajisen me pëlqim nga Kuvendi Komunal;
- panairët e hapur duhet të jenë të rrethuar me rrethojë të fortë;
- ekspozuesve të mallit duhet t'iu sigurohet përdorimi i telefonit dhe faxit, e nëse kushtet e lejojnë edhe qasje në internet, kurse për qëndrimin e tyre duhet që në kuadër të hapësirës së panairit të sigurohet pjesë a caktuar e destinuar për punë afariste si dhe hapësirat ndihmëse për nevojat higjienë-sanitare.

5.5. Shërbimet

5.5.1 Shërbimet e komunitetit (Infrastruktura publike)

Kjo kategori e shërbimit, sipas nomenklaturës së HILUCS ndahet në nënkategoritë e mëposhtme:

- **Shërbim të administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale:** Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve administrative të përgjithshme, të mbrojtjes, drejtësisë, sigurisë publike, zjarrit dhe të sigurimit të detyrueshëm shoqëror.
- **Shërbimi arsimor:** Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të arsimit parashkollor dhe universitar, dhe shërbime të tjera arsimore.
- **Shërbim shëndetësor dhe shoqëror:** Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të sigurimit të shëndetit të njeriut dhe të kafshëve dhe të shërbimeve të punës sociale.
- **Shërbim fetar dhe shërbim tjetër i komuniteti:** Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve fetare. Shërbim tjetër i komunitetit përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të tjera të komunitetit si p.sh. varrezat.

Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit sipas projeksioneve të PZHK-së


Shërbim të administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale: PZHK ka përcaktuar ofrimin dhe funksionalizimin e qendrave të bashkësisë në qendrat e lokale (Kërpimeh, Orllan dhe Lluzhan) dhe rurale në të cilat do të ushtrohen funksionet publike administrative dhe ofrohen hapësirë për komunitetin, kulturë, shërbime postare, shërbime financiare (njësi bankare), asociacione dhe klube shoqërore, të sigurisë publike, etj. Komuna ka mbulueshmëri të mirë me ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarë përmes zyrave komunale të gjendjes civile. Këto zyre si objekte të veçanta gjenden në: Orllan, Lluzhan, Kërpimeh, Llapashticë, Bradash, Pollatë, Pakashticë e Poshtme, Batllavë dhe 2 në Sfeqël dhe në Dumnicë të Poshtme në kuadër të AMF-së. Ofrimi i hapësirave për shërbime tjera të komunitetit (kulturorë, rinorë, takime publike etj), bëhet në hapësirat shkollorë prandaj nuk ka nevojë për ndërtimin e objekteve të veçanta për ofrimin e këtyre shërbimeve. Komuna ka përpiluar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave të fshatrave.

Shërbimi arsimor: Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK-së (2016-2018) dhe deri më tani, shumica e projekteve të PZHK-së janë realizuar. Për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve, ndërtimi i shkollave në disa fshatra nuk është i arsyeshëm, për dallim nevojë më e madhe për shkolla të reja është paraqitur në Dumosh e Lladovc. Komuna ofron transportin e nxënësve në rastet kur distanca shkollë-shtëpi në një drejtim tejkalon 4km. Kjo vlen kryesisht nxënësit që jetojnë në vendbanimet e thella rurale në tërësinë Malet dhe Peisazhet dhe Natyra e Turizmi. Nevojë për rinovime ka në vazhdimësi por më prioritet në shkollat e disa fshatrave. Hapësirat për zhvillimin e arsimit para fillor janë duke u plotësuar në kuadër të hapësirave të shkollave ekzistuese. Objektet parashkollorë (çerdhe/kopshte) atë parapara me PZHK janë ndërtuar por funksionale është vetëm ajo në qytet, kurse tjetra ka nevojë për vazhdimin dhe kompletimin e mëtutjeshëm. Për nën-qendrat – qendrat bazike Lluzhan dhe Kërpimeh qytetarët në takimet publike kanë kërkuar që me HZK të parashihen institucione të tilla. PZHK ka paraprë poashtu ndërtimin e sallave të fiskulturës në shkolla me të gjitha rekuizitat dhe fushave të hapura sportive në kuadër të oborreve shkollorë.

Shërbim shëndetësor dhe mirëqenies sociale: Vlerësimi i zbatimit të PZHK-së (2016-2018) ka vënë në pah se një pjesë e projekteve të parapara janë realizuar, ka pasur investime në renovimin e objekteve tjera shëndetësore dhe atyre ndihmëse. Në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë hartimit të HZK-së, është parë e nevojshme funksionalizimi

i spitalit, ndërtimi i qendrës për ndihmë të shpejtë, ndërtimi i një QMF në zonën urbane si dhe ndërtimi i shtëpisë për kujdesin ndaj të moshurave e cila duhet të përfshijë edhe hapësirën për qëndrimin ditor të pleqve jorezident. Shërbim fetar dhe shërbim tjetër i komuniteti: PZHK i referohet hartimit të rregullores për menaxhimin e varrezave e cila përcakton kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit si dhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e komunës. PZHK nuk ka ofruar ndonjë përcaktim nëse objektet e kultit dhe lokacionet e tanishme të varrezave plotësojnë nevojat e tashme dhe ato të ardhshme deri në kohëzgjatjen e vlefshmërisë së tij (2025). Nga ana tjetër, me disa vendime nga Kuvendi Komunal, Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, u janë dhënë prona të paluajtshme për destinim për varreza në shfrytëzim afatgjatë. Këto lokacione janë përfshirë në HZK. HZK obligon autoritetet përgjegjëse të bëjnë rregullimin e sipërfaqeve ekzistuese të varrezave.

Harta 15 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit (infrastrukturës publike)



Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Në kuadër të njëjtës parcelë shfrytëzimet janë:

Shërbimi arsimor:

Shfrytëzimet e lejuara: objekte për arsim, parkingje, shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike e termike, telekomunikacionit, ujësjellësit e kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: shërbime rekreative, hapësira për deponim/magazinim në funksion të shërbimit;

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime argëtuese e rekreative si festivale, koncerte dhe ekspozita.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Shërbim shëndetësor dhe mirëqenies sociale

- Për ndërtesat e shëndetësisë:

Shfrytëzimet e lejuara: shëndetësi, barnatore, parkingje, shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: hapësira për deponim dhe të ngjashme në funksion të shërbimit;
Shfrytëzimet e ndaluara: shfrytëzimet/funksionet e papërfshira në shfrytëzimet e sipërmendura apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme.

- Për ndërtesat e mirëqenies sociale:

Shfrytëzimet e lejuara: banim, parkingje, shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: hapësira për sport e rekreacion, hapësira për deponim dhe të ngjashme në funksion të shërbimit;

Shfrytëzimet e ndaluara: shfrytëzimet/funksionet e papërfshira apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme me shfrytëzimet e sipërmendura.

Shërbim të administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale:

- Për ndërtesat e administratës publike:

Shfrytëzimet e lejuara: funksione administrative, parkingje, shërbimet publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: shërbime postare, shërbime financiare e të ngjashme;

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime kulturore si ekspozita, panaire;

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme.

- Për ndërtesat e mbrojtjes dhe sigurisë sociale

Shfrytëzimet e lejuara: hapësira për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe sigurisë publike e të ngjashme, parkingje, shërbimet publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: shërbime që janë në funksion të veprimtarisë së këtyre ndërtesave;

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen në shfrytëzimet e lartpërmendura apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme.


Shërbim fetar dhe shërbim tjetër i komuniteti:

Shfrytëzimet e lejuara: hapësira për ofrimin e ritualeve fetare (Xhami, kishë,...), varret, parkingje, shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);


Shfrytëzimet dytësore të lejuara: hapësira përcjellëse në funksion të shërbimit p.sh. të shërbimit të varrimit;

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme.


Harta 16 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- Institucionet e arsimit




Harta 17 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- Institucionet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale



Harta 18 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- administrata publike, mbrojtja dhe siguria sociale



Harta 19 Sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit- religjioni dhe varrezat



Kushtet zhvillimore për sipërfaqet e shërbimeve të komunitetit (infrastruktura publike)

Tabela 8 Dimensionet e parcelës, lartësia, indeksi për objektet e shërbimeve të komunitetit

Nënkategoritë		Madhësia e parcelës ndërtimore për objektin	Lartësia e objektit	IshPKZh	SGJP
Shërbimi arsimor	Shkolla fillore të mësimi të ulët Salla të fiskulturës Institucione parashkollore:	Sipas normave në fuqi të arsimit Sipas normave në fuqi të arsimit	Sipas normave në fuqi të arsimit	40%+10%pllakosje 25%+10%pllakosje 30% 10%pllakosje	50% 65% 60%
	- Çerdhe - Kopshte				
Shërbimi shëndetësor dhe mirëqenies sociale	QMF	Deri në 10 ari	1-2 kat	50%v+10%pllakosje	40%
	AMF	Deri në 6 ari	1 kat	50%+10%pllakosje	40%
	Shtëpi e të moshuarve e cila përfshin edhe qëndrimin ditor për të moshuarit jorezident	Deri në 10-12 ari	1 kat	60%+10%pllakosje	30%
Varreza		1.5m ² /banor	/	40%+10%pllakosje	50%

Përcaktimet për lartësinë e objektit në raport me gjerësinë e rrugës publike dhe kufinj të parcelës bëhen sipas rregullave të dhëna në UA për NTPH.

Vija rregulluese duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese ose të planifikuar në rastet kur kemi planifikim të rrugës.

Qasja dhe vendosja e objektit në parcelë: në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Gjatë dhënies së lejes ndërtimore, përveç kushteve të mëposhtme të merren parasysh edhe kushtet e zonave tjera në veçanti të zonave mbishtresore, të zonave të mbrojtura sanitare ujore, infrastrukturës teknike-brezat mbrojtës rrugor/hekurudhor. Duke ju referuar NTPH, parcelat ku do të vendosen *ndërtesat për shërbim të administratës publike, arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale* dhe komunitetit duhet mundësisht të plotësojnë këto kushte specifike:

Shërbim të administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale:

Institucionet e administratës publike:

- në pjesën/ pjesët qendrore të vendbanimeve;
- në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- në afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet.

Shërbimi arsimor: Ndërtesat e arsimit parashkollor, para-universitar duhet të planifikohen në:

- kuadër të zonës së banimit;
- lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- largësi nga lokacionet e ndotura;
- largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
- largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale;
- hapësirat e objekteve për arsim të rregullohen me breza mbrojtës.

Shërbim shëndetësor dhe mirëqenies sociale

Infrastruktura e institucioneve të shëndetësisë të nivelit parësor duhet të planifikohet në:

- parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- largësi nga lokacionet e ndotura;
- largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore);
- largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;

Infrastruktura e institucioneve të mirëqenies sociale duhet të planifikohet në:

- terren të rrafshët;
- afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore).

Shërbim fetar dhe shërbim tjetër i komuniteti: Varrezat, duhet të planifikohet në lokacione si në vijim:

- në afërsi të zonave të banimit;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në afërsi jo më të vogël se 300m nga zona e banimit; dhe në largësi jo më të madhe se 15km nga vendbanimi.

Distancat: Distancat e përcaktuara për infrastrukturën publike, sociale, teknike dhe rrugore përcaktohet në bazë të shfrytëzimit dhe qëllimit. Distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve

të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkalim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4m' i gjerë dhe 5m' i lartë.

Distancat (rrezja) optimale shërbyese për ndërtesat e arsimit dhe shëndetësisë në vijë ajrore

Vendbanime urbane	Vendbanime rurale
Ndërtesat e çerdheve: 300 m	Ndërtesat e çerdheve: 300 m
Ndërtesat e kopshteve: 500 m	Ndërtesat e kopshteve: 900 m
Ndërtesat e shkollave fillore: 600 m	Ndërtesat e shkollave fillore: 1900 m
Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta: 600m	Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta: 1900m
Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: 1500m	Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: 4700 m
Ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare: 10 km	
Ndërtesat e punkteve të mjekësisë familjare-AMF-ve: 3 km	

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Gjatë dhënies së lejes ndërtimore, të mirren parasysh kushtet e zonave mbishtresore, të sipërfaqeve ujore, infrastrukturës teknike-brezat mbrojtës rrugor/hekurudhor si dhe rregullat e mëposhtme:

Rregullat për zhvillim peisazhi, shiritat mbrojtës të gjelbërimit: vlejné Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përcaktohen sipas normave apo rregulloreve të ligjeve respektive për ndërtesat e administratës publike, arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe ndërtesave fetare.

Kërkesat për efijencë të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe PLKVEE.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe sipas rregulloreve të ligjeve respektive për ndërtesat e administratës publike, arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, fetare.

Siguria nga zjarri: kushtet për sigurinë nga zjarri duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi . Distancat në mes të objekteve duhet të jenë të mjaftueshme për të siguruar qasje direkte të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkalim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4m i gjerë dhe 5m i lartë. Siguria nga zjarri ndërmjet dy ndërtesave fqinje kërkon që distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku ½ H së ndërtesës më të lartë. Kjo distancë minimale zbatohet për të gjitha llojet e ndërtesave në të gjitha zonat specifike, nën zonat, zonat mbishtresore dhe sipërfaqet rregulluese.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para ndërtimit në parcelën për zhvillim duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike. Në parcelën ndërtimore duhet të sigurohen lidhjet e shërbimeve komunale të definuara në drejtimet për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (apo vend-lidhjet në gropa septike), rrjetin elektro-energjetik dhe telekomunikimit, etj.

Parkingjet: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Rampat për personat/fëmijët me nevoja të veçanta: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe rregulloret respektive.

Bonuset e zonimit: autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor bonuset e zonimit për ofrimin e shërbimeve të komunitetit p.sh. për sigurimin e parcelës për ndërtesat e tilla dhe të gjitha përmbajtjeve të tyre përcjellëse.

Jonkonformitetet: /

5.5.2 Sipërfaqet e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative (Infrastruktura sociale)

Kjo kategori e shërbimit, sipas nomenklaturës së HILUCS ndahet në nënkategoritë e mëposhtme:

- Shërbim kulturor
- Shërbim argëtues
- Infrastruktura sportive
- Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative:
- Shërbime tjera rekreative

Shërbim kulturor: Hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve artistike, bibliotekë, muze, kopshte zoologjike, kopshtet botanike, vendet historike dhe shërbime të tjera kulturore.

Shërbim argëtues: Hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve, si parqet e dëfrimit, parqet tematike, pikat e basteve dhe bixhozit, aktivitete dhe shërbime të tjera argëtuese.

Infrastruktura sportive: Hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës sportive, si stadione, salla sportive, pishina, palestra, impiante të skive, fusha golfi etj.

Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative: Hapësira rekreative në ajër të pastër, p.sh. parqet urbane, terrenet sportive, parqet kombëtare dhe zonat natyrore që përdoren për qëllime rekreative (p.sh. pyjet, malet, zonat bujqësore, pellgjet, liqenet, lumenjtë).

Shërbime tjera rekreative përfshijnë hapësira tjera për rekreacion që nuk janë përfshirë në kategoritë tjera të mësipërme.

5.5.2.1 Sipërfaqet e shërbimeve të kulturore, argëtuese dhe rekreative sipas projeksioneve të PZHK-së

PZHK nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur¹⁷ këtyre shërbimeve dhe si rrjedhojë nuk ka mjaftueshëm veprime/projekte të identifikuar sidomos për fushën e kulturës. Me HZK do të përcaktohen kushtet për objektet

¹⁷ Raporti i Vlerësimi i kualitetit dhe zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Podujevës (2016)

në funksion të këtij shërbimi të cilat do të merren parasysh për zhvillimet të tilla në të ardhmen. Në HZK janë përfshirë disa projekte të parapara për realizim si: Funksionalizimi i stadionit të qytetit; Ndërtimi i fushës sintetike të futbollit në Dumosh; palestrës sportive të mbyllur; fushave sportive të hapura nëpër lagjet e qytetit/fshatra; si dhe Pishina olimpike. Sa i përket hapësirave të lira, atyre publike dhe brezave mbrojtës të gjelbërimit, parimi i përgjithshëm është që të tilla hapësira nëse ekzistojnë në kuadër të hapësirave të jashtme të objekteve publike, të mund të shërbejnë në funksion të komunitetit.

[Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara](#)

Në kuadër të parcelës së këtyre ndërtesave, shfrytëzimet janë:

Shërbim kulturor dhe argëtues:

Shfrytëzimet e lejuara: objekte kulturore dhe argëtuese dhe struktura të përshtatura për aktivitete kulturore dhe argëtuese, shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave), parkingje;

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: hapësira për deponim/magazininim të materialeve në funksion të shërbimit e të ngjashme;

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime tregtare si ekspozimi dhe shitja e eksponateve, koncerte, panairë e festivale për promovimin e produkteve të shërbimit;

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme

Infrastrukturë sportive:

Shfrytëzimet e lejuara: Struktura dhe territore të përshtatura për aktivitete sportive dhe të rekreacionit, shërbimet publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, transportit dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave), parkingje;

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: hapësira për deponim/magazininim të materialeve në funksion të shërbimit e të ngjashme;

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime tregtare të produkteve të shërbimit, ekspozimi dhe shitja e eksponateve, koncerte, panairë e festivale për promovimin e produkteve të shërbimit;

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme

Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative:

Shfrytëzimet e lejuara: aktivitete argëtimi, rekreacion, hapësira për mirëmbajtje, hapësira për aktivitete kulturore dhe për rini, hapësira për ofrimin e shërbimeve të sigurisë publike e të ngjashme, parkingje, shërbimet publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, ndriçimi publik, shërbimet e transportit publik dhe telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara: shërbime financiare e të ngjashme;

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara: shërbime hoteliere me kapacitet të vogël (restaurante të vogla),

Shfrytëzimet e përkohshme: tregje të gjelbra mobile, tenda për mbajtjen e aktiviteteve argëtuese e rekreative si festivale, koncerte dhe ekspozita;

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme

Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative-Kopshti lindor

Njësia Kopshti Lindor apo Parku i Pishave duhet të mbrohet në të ardhmen nga ndërtimet pasi toka bujqësore përreth kopshtit lindor është dëmtuar dukshëm. Në tokën komunale në afërsi të tij parashihet që të ndërtohen hapësira rekreative sportive të cilat do të jenë në shërbim të komunitetit.

Shfrytëzimet e lejuara:

- gjelbërim dhe shërbime rekreative (terrene sportive, fitnes i jashtëm, fontana, fushëlojëra për fëmijë e të ngjashme);
- Infrastrukturë e transportit të pamotorizuar (shtigje për ecje, shtigje për biçikleta, ndalesa të autobusëve);

- Shërbime publike (ndriçim publik, infrastrukturë e telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara:

- Objekte për mirëmbajtjen e Parkut;
- Parkingje për qëllime të paisjeve;


Shfrytëzimet e veçanta të lejuara:

- shërbime të hotelierisë (restaurante, bare)-max. dy shërbime të tilla me kapacitet të ulët;
- prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë (hapësira ku mund të prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishme (penele diellore);

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime argëtuese si festivale, koncerte, panaire.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkohjnë me funksionet e ngjashme në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme

Harta 20 Sipërfaqet e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative



Kushtet zhvillimore

Përveç kushteve të mëposhtme, gjatë dhënies së lejes ndërtimore, të merren parasysh edhe kushtet e zonave tjera në veçanti të zonave mbishtresore, të zonave të mbrojtura sanitare ujore, infrastrukturës teknike-brezat mbrojtës rrugor/hekurudhor.

Tabela 9 Normat e planifikimit sipas UA për objektet e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative

Nënkategoritë		Madhësia e parcelës ndërtimore për objektin	Lartësia e ndërtesës	ISHPKZh	SGJP
Shërbim kulturor dhe argëtues	Bibliotekë	0.25 m2/banor	P+1	60%+10%pllakosje	30%
	Teatër	0.2 m2/banor		80%+10%pllakosje	10%
	Kinema	0.2 m2/banor		80%+10%pllakosje	10%
	Muze				
Infrastrukturë sportive	Stadiume Salla sportive Pishina Palestra	Varësisht nga nr.1 banorëve që shërbehen: ≤ 5000b-2.5 m ² /b; ≥ 5001-20000b- 4.5 m ² /b; > 20001b-5m ² /b	/	60%+10%pllakosje	30%

Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative	Park publik	1m ² /banor	/	Max. 10%pllakosje	90%
	Park i vogël në vendbanim	2m ² /banor	/	Max. 10%pllakosje	90%
	Terren i hapur sportiv	Sipas normave respektive	/		
	Brez i gjelbër përgjatë rrugëve të qytetit	1m ² /banor	/	/	100%
	Brez i gjelbër përgjatë rrjedhave ujore	2m ² /banor	/	/	100%
	Brezi i gjelbër mbrojtës mes zonës industriale dhe qytetit		/	/	100%

Shënim tek shërbim kulturor : Të përcaktohen duke marrë parasysh karakteristikat e popullsisë, projeksione demografike, faktori gjeografik, shërbimet ekzistuese dhe funksionaliteti i tyre si dhe kërkesat për shërbime të reja.

Përcaktimet për lartësinë e objektit në raport me gjerësinë e rrugës publike dhe kufinj të parcelës bëhen sipas Normave teknike të planifikimit hapësinor.

Vijat: për objektet e banimit që gjenden në parcelat e kufizuara me:

-Rrugët lokale që lidhin dy a më shumë vendbanime (transite): vija ndërtimore për objektet e banimit të përhershëm duhet të jetë minimum 14.5m' e matur nga vija aksiale qarkulluese (VAQ), kjo sepse brezi mbrojtës rrugor për rrugët lokale ku nuk lejohet ndërtimi i objekteve të banimit nuk duhet të jetë më i $\leq 10m'$.

-Rrugët primare të vendbanimit- vija ndërtimore për objektet e banimit të përhershëm duhet të jetë minimum 9.5m' e matur nga vija aksiale qarkulluese (VAQ). Për objektet e banimit me funksione në përshtatshmëri në kuadër të cilave mund të ketë funksione tjera që zhvillohen në përdhësën e objektit, vija ndërtimore mund të jetë minimum 7.5m' e matur nga VAQ.

-Rrugët sekondare të vendbanimit- vija ndërtimore duhet të jetë minimum 7.75m' për rrugët sekondare dy-kahëshe e matur nga VAQ respektivisht minimum 6.8m' për rrugët një-kahëshe e matur nga VAQ.

Në rastet kur kërkohen distanca më të mëdha mbi ato të dhëna se kushtet e HZK-së (p.sh. kur zhvillohen projekte qeveritare, sidomos kur është në pyetje përcaktimi i brezit mbrojtës), për përcaktimin e vijës ndërtimore do të mirren parasysh dispozitat që derivojnë nga legjislacioni në fuqi. Në rastet kur vija ndërtimore e objektit ekzistues të banimit përputhet me vijën rregulluese (qoftë ekzistuese apo e planifikuar), objekti do të konsiderohet jo-konforme ("gjendja e ngrirë").

Qasja në dhe vendosja e objektit në parcelë: në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Sipas NTPH, parcelat ku do të vendosen ndërtesat për shërbim të shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative duhet mundësisht të plotësojnë këto kushte specifike:

Objektet kulturore dhe argëtuese parcelat të jenë në:

- pjesën/ pjesët qendrore të vendbanimeve;
- afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;
- parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- largësi më të madhe se 100 m nga ndërtesat e garazheve.

Objektet e sportit planifikohen në:

- lokacione të diellosura dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- lokacione të rrafshëta pranë burimeve dhe pasqyrave ujore;
- lokacionet ku ka mundësi planifikimi i shtigjeve për ecje/vrapim, infrastrukturës dhe gjelbërimit.

Hapësirat e hapura rekreative planifikohen në:

- në afërsi të zonave të banimit;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.

Distancat: distancat përcaktohen në bazë të shfrytëzimit dhe qëllimit. Distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Distancat optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore për fushat sportive dhe rekreative është 800 m.

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Rregullat për zhvillim peisazhi, shiritat mbrojtës të gjelbërimit: sipas Kushteve Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përcaktohen sipas normave apo rregulloreve të ligjeve respektive për ndërtesat e këtij shërbimi.

Kërkesat për eficiencë të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe Planit lokal Komunal të veprimtimit për eficiencë të energjisë.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, dhe rregulloret e ligjeve respektive.

Siguria nga zjarri: kushtet për sigurinë nga zjarri duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për Mbrojtje nga Zjarri. Distancat në mes të objekteve duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkallim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4m i gjerë dhe 5m i lartë. Siguria nga zjarri¹⁸ ndërmjet dy ndërtesave fqinje kërkon që distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku $\frac{1}{2} H$ së ndërtesës më të lartë. Kjo distancë minimale zbatohet për të gjitha llojet e ndërtesave në të gjitha zonat specifike, nën zonat, zonat mbishtresore dhe sipërfaqet rregulluese.

¹⁸ Rregullore nr. 24/2012 për normat teknike për mbrojtje nga zjarri të objekteve të larta

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para ndërtimit në parcelën për zhvillim duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike. Në parcelën ndërtimore duhet të sigurohen lidhjet e shërbimeve komunale të definuara në drejtimet për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (apo vend-lidhjet në gropa septike), rrjetin elektro-energjetik dhe telekomunikimit, etj.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: në përputhje me Kushtet e Përgjithshme Zhvillimore.

Bonuset e zonimit: do të përdoren nga komuna për të intervenuar në shpronësimin apo kompensimin e pronës private në mënyrë që këto hapësira të kenë pronësi publike. Autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor bonuset e zonimit për ofrimin e shërbimeve të komunitetit p.sh. për sigurimin e parcelës për ndërtesat e tilla dhe të gjitha përmbajtjeve të tyre përcjellëse.

Jonkonformitetet: /

5.5.3 Sipërfaqet e shërbimeve publike- Infrastruktura teknike

Sipas nomenklaturës HILUCS, në këtë kategori hyjnë:

- Infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza
- Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike
- Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave
- Format tjera të shërbimeve

Definicionet:


Infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza: hapësira të shfrytëzuara për nxjerrjen, grumbullimin, ruajtjen, pastrimin dhe shpërndarjen e ujit dhe mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza (duke përfshirë edhe tubacionet);

Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike: hapësira të shfrytëzuara për shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit dhe energjisë termike. Kjo klasë përfshin hapësirat për transportimin e naftës dhe gazit;

Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave: Hapësira të shfrytëzuara për grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave (vend-depozitimeve, djegjen e mbeturinave, kompostimin, trajtimin e mbetjeve të rrezikshme dhe ndërtesat e riciklimit);

Format tjera të shërbimeve: Hapësira të shfrytëzuara për infrastrukturë tjetër publike të pa përfshirë në kategoritë e mësipërme.

Harta 21 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike



5.5.3.1 Infrastruktura e ujësjellësit, ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza

Sipërfaqet e infrastrukturës së ujësjellësit sipas PZHK-së

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK i bërë në vitin 2018, gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK ka pasur realizim të pjesshëm të projekteve për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Orllan dhe punohet në vazhdimësi në zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit. Rrjeti i “Vrella e Revuqit” ku janë përfshirë gjashtë fshatra është kryer pjesërisht, kaptazha dhe rezervuari nuk janë kryer. Projekti është ndërprerë. Sipas të dhënave nga Kompania

Regionale e Ujësjellësit “Prishtina”- NJOU në Podujevë, ka probleme në furnizimin e vendbanimeve me ujë nga burimi i Revuqit për shkak të pamundësisë së qasjes nga banorët e pronave përreth si dhe kapacitetit të ulët i cili verës bie deri në 7l/sec përderisa prurja maksimale është 35[l/sec] gjatë muajit Prill. Prandaj HZK propozon që të bëhet analiza dhe punimi i elaboratit për gjetjen e modaliteteve për shtimin e kapacitetit (qoftë në formë të burimeve shtesë apo tjetër) për plotësimin e nevojave të vendbanimit. Për Kaptimin e burimit “Vrella e Zhtisë” duhet të bëhet punimi i elaboratit hidrogeologjik. KUR “Prishtina” ka informacion që potencial për furnizimin e banorëve me ujë është edhe një burim në fshatin Surkish dhe Sfeqël, përgjatë lumit Dumnicë si dhe në Murgull dhe Llapashticë. HZK ka lokalizuar këto burime dhe përcakton punimin e studimit të fizibilitetit dhe më pas të elaboratit hidrogeologjik. Normat e furnizimit të vendbanimeve, me sasinë e nevojshme ditore të ujit janë si në vijim:

1) Ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri:

- për vendbanime $\geq 5001-20000$ banor: $\geq 150- 200$ litra/banor;
- për vendbanime < 5000 banor: $\geq 100- 150$ litra /banor.

2) Ujë për shfrytëzim për nevojat jo-konsumuese-rekreation/ ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike (Sipërfaqet e gjelbra, rrugët dhe sheshet): 1.50 litër/m².


Duke ju referuar strategjisë së ujërave 2017-2036, kudo që është e përshtatshme dhe e aplikueshme, të aplikohen sistemet e qëndrueshme urbane të drenazhimit (SQUD) në veçanti në zonat e reja zhvillimore dhe gjatë renovimit të sistemeve ekzistuese të rrjetit.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i ujësjellësit, ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse si dhe infrastruktura rrugore në kuadër të së cilës shtrihen këto rrjete.

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë në funksion të infrastrukturës gjegjëse.

Harta 22 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike – Rrjeti i ujësjellësit



5.5.3.2 Infrastruktura e ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza

Sipërfaqet e infrastrukturës së ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza sipas PZHK-së

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK--së, gjatë vitit 2017-2018 ka pasur investime në realizimin e projekteve të planifikuara. Fshatrat e thella në të cilat do të shtrihet rrjeti i kanalizimit janë: Zhiti, Pollatë, Kalaticë, Repë. Në


fshatrat të cilat për shkak të numrit të vogël të popullsisë apo konfiguracionit të terrenit nuk mund të kyçen në rrjetin e kanalizimit do të organizohet sistemi i të vetëpastrimit të ujërave të ndotura me gropa septike individuale dhe kolektive me sistem.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza lejohe vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse si dhe infrastruktura rrugore në kuadër të së cilës shtrihen këto rrjete.

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë në funksion të infrastrukturës gjegjëse.

Harta 23 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike – Rrjeti i kanalizimit



5.5.3.3 Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike

Sipërfaqet e infrastrukturës së shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike sipas PZHK-së

Sipas vlerësimit, gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK-së, ka pasur investime në projekte për përmirësimin e rrjetit energjetik që përfshin rritjen e kapacitetit energjetik prej 10 kv në 20kv në vendbanimet e identifikuara në PZHK. Pa u realizuar kanë mbetur këto projekte: Përmirësimi selektiv në drejtimin Podujevë 2 dhe në drejtimin fshatrat 2, përmirësimi solid në drejtimin Podujevë 4, Podujevë 5 dhe drejtimi Sillosi. Këto projekte mbesin relevante prandaj do të përfshihen në HZK. KEDS me planin e tij “Zgjerimi dhe përforsimi i rrjetit distributiv” ka planifikuar një mori projektesh të reja, për të cilat komuna veçse ka kryer procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale (shih vendimet e KK në kapitullin 2). Këto projekte përfshijnë:

- Punime në rrjetin energjetik në:
 - Zonën Aktive Qendrore, duke përfshirë largpërçuesit në vendbanimet: Majac, Llluzhan, Godishnjak, Kunushec, Buricë, Gllamnik, Velikarekë, Obrançë, Peran, Livadicë, Shtedim, Surkish, Sfeqël, Dumosh, Shajkoc, Siboc i Epërm dhe i Poshtëm, dhe
 - Qytetin e Podujevës.

Të gjitha këto vendbanime janë të kyçura në nënstacionin Podujevë 220/35/10 kV.

- Janë planifikuar tri stabilimente të reja:

- Një në fshatin Llapashticë e Poshtme (SS1), një në fshatin Kunushec (SS2, stabiliment me një hyrje dhe katër dalje, dalja e katërt është furnizim alternativ për Kunushecin (rrin e shkyçur), dhe një stabiliment në fshatin Sfeqël (SS3).
- Ndërtimi i trafostacioneve të reja në: nga 4 trafo në Obrancë dhe Llapashticë e Epërme; nga 3 trafo në Dumnicë të Poshtme, Metehi, Bradash, Lupç i Poshtëm; nga dy trafo 2 në Podujevë, Dobratin, Surkish, Sfeçël, Velikarekë; nga një trafo në: Balloc, Batllavë, Tërnavë, Halabak, Kërpimeh, Kaçybeg, Lladoc, Llaushë, Zakut, Dyz, Gërdoc, Brainë, Dobratin, Gllamnik.


Me Planin Hapësinor të Kosovës 2010–2020, është paraparë në pesë faza instalimi i gypave të gazsjellësit përgjatë rrugëve magjistrale që lidhin shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës dhe disa qendra më të vogla dhe lidhja e tyre me rrjetet e gazsjellësve të Serbisë dhe Maqedonisë, ku në fazën e pestë është paraparë furnizimi i komunës së Podujevës dhe Kamenicës.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i energjisë termike elektrike në drejtimet e përcaktuara me plan lejohen shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të këtyre përmbajtjeve si dhe vendosja e rrjetit të telekomunikimeve.

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë në funksion të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura.

Harta 24 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike –Rrjeti energjetik, telekomunikacionit dhe ndriçimit publik



5.5.3.4 Shërbimet për Eficiencë të energjisë

PZHK nuk ka trajtuar aspektin e efijencës së energjisë. Mirëpo komuna ka hartuar Planin Komunal të Veprimit për Efijencën e Energjisë (PKVEE) për periudhën 2019-2021. Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rehatisë dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Podujevës.

Veprimet në formë të projekteve, masave të parapara me PKVEE përfshijnë:

- Fushata vetëdijësuese për banorët mbi rëndësinë e kursimit të energjisë;
- Ndërtimi i depos qendrore për biomasë;

- Aplikimi i masave të EE-së në ndërtesat e sektorit publik (ndërtesa e komunës, ndërtesën e Qendrës së punës sociale, objektet shkollore, ndërtesat e shëndetësisë);
- Aplikimi i masave në ndriçimin publik.
Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të sipërfaqes ku planifikohet ndërtimi i depos qendrore për biomasë, lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjes gjegjëse.

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë nuk janë të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura.

5.5.3.5 Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave

Sipërfaqet e infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave sipas PZHK-së

PZHK ka përcaktuar shtrirjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në tri nën-qendrat – qendrat bazike: Kërpimëh, Lluzhan dhe Orllan dhe krahas grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht DUMM duhet të aplikojë masat ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Plani i referohet edhe largimit të deponive ilegale. Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK-së, ka pasur investime në teknologji për grumbullimin e mbeturinave. Sipas Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave (PLMM) për periudhën 2017-2022, ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në komunën e Podujevës do të trajtohet sipas prioriteteve të prezantuara në tabelën e mëposhtme. Numri i deponive ilegale aktualisht është 30 në gjithë territorin e komunës të lokalizuara në hartë. Veprime të rëndësishme nga aspekti hapësinor që PLMM ka paraparë përfshijnë:

- Caktimi i një pike në rajon për depozitimin dhe asgjësimin e mbeturinave inerte;
- Caktimin e pikave për grumbullimin e mbeturinave voluminoze, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura;
- Identifikimi i mundësisë për asgjësimin e mbeturinave spitalore në nivel rajonal ose brenda spitalit;
- Largimi i deponive ilegale;
- Sigurimi i deponive duke i rrethuar me gardh pas pastrimit të tyre, për të evituar rikrijimin e tyre. Pas pastrimit të tyre dhe rrethimit me gardh, komuna mund të vendosë që këto zona t'i kthejë në zona rekreative, si gjelbërimi i tyre duke i mbjellë me barë.

Tabela 10 Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës¹⁹

Zona	Njësia	Nr.i popullsisë	Nr. amvisërive me shërbim pa shporta	Nr.i amvisërive në të ardhmen
Zona A Prioritet 1	Bajcinë, Bellopojë, Bradash, Dobërdol, Dumosh, Gllamnik, Halabak, Kërpimëh, Kunushec, Letanc, Lupi Poshtëm, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Obrancë, Peran, Podujevë, Sfeqël, Surkish, Shajkovc, Shtedim, Katunishtë, Zakut	57638	5290	3674
Zona B Prioritet 2	Ballovc, Batllavë, Buricë, Dobratin, Dumnicë e Epërme, Gërdoc, Godishnjak, Kaçybeg, Livadicë, Lladoc, Llaushë, Llugë, Lluzhan, Majac, Merdar, Metehi, Orllan, Penuhë, Pollatë, Radujevc, Repë, Revuq, Sallabajë, Siboc i Epërm, Shakovicë, Tërnavë	22182	1125	2188
Zona C Prioritet 3	Bërvenik, Bllatë, Brecë, Dvorishtë, Hërticë, Metergoc, Muhazob, Murgull, Potok, Rakinicë, Sllatinë, Surdull, Sylevicë, Tërnavicë, Turiçicë	8769	196	982
Totali		88598	6611	6844

Komuna organizon, grumbullon, trajton dhe rregullon organizimin dhe mënyrën e veçimit të mbeturinave për riciklim sipas dispozitave ligjore si dhe në përputhje me planin lokal të saj. Mbeturinave e rrezikshme (eksplozive, oksiduese, shumë të ndezshme dhe ato të ndezshme, toksike, etj) dhe ato speciale grumbullohen dhe transportohen si të veçuara; transporti bëhet me mjete adekuate.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara


Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të sipërfaqeve ku planifikohet depozitimi dhe asgjësimi i mbeturinave inerte, mbeturinave voluminoze, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura si dhe mbeturinave spitalore lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: objekte të përkohshme mirëmbajtëse

¹⁹ (burimi: Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2017-2022 dhe azhurnuar nga të dhënat e fundit të komunës)

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara, të lejuara të veçanta apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura.

Harta 25 Sipërfaqet e shërbimit publik-infrastruktura teknike –Infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave



5.5.3.6 Format tjera të shërbimeve- rrjeti i telekomunikimeve

Sipërfaqet e infrastrukturës së rrjetit të telekomunikimeve sipas PZHK-së

Për shtrirjen e rrjetit të *telefonisë mobile dhe internetit* në gjithë territorin e komunës, PZHK i referohet bashkëpunimit të ngushtë me operatorët e telefonisë mobile në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve duke ofruar paketa stimuluese, si dhe duhet të ndërmerret një kampanjë për informimin e qytetarëve për mundësitë e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre (vendosja e antenave individuale në lokacione të ndryshme të komunës sidomos vendbanime më të thella malore). Në qendrat sekondare të Kërpimëh dhe Orllan janë paraparë nga minimum dy *follore publike* telefonike, mirëpo për shkak të teknologjisë aktuale këto nuk shihen si projekte të rëndësishme.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Shtrirja e rrjetit kabllor të telefonisë, internetit dhe rrjetit kabllor të televizionit, mund të bëhet në kuadër të rrjetit të energjisë termike elektrike (e preferueshme si rrjet nëntokësor), në shiritin e gjelbërimit të rrugës respektivisht në sipërfaqet publike, kurse në rrugët me profil të ngushtë edhe nën trotua.

Në kuadër të sipërfaqeve ku do të vendosen antenat transmetuese të PTK, internetit dhe RTV lejohen shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të këtyre përbajtjeve.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Në kuadër të sipërfaqeve ku do të vendosen antenat transmetuese të PTK, internetit dhe RTV shfrytëzime të lejuara sipas kushteve të veçanta në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës lejohet: banimi, shfrytëzimi i përzier, bujqësia, pylltaria.

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara, të lejuara të veçanta apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura.

5.5.3.7 Format tjera të shërbimeve-depozitat dhe stacionet e karburantit

PZHK nuk ka përcaktuar nevojën për depozita dhe stacione të reja të karburantit. As me raportin e vlerësimit të zbatimit të PZHK/U-së nuk janë paraqitur kërkesa të reja, prandaj në HZK mbetet ky përcaktim.

Kushtet zhvillimore

Tabela 11 Madhësitë e parcelës për objektet e shërbimeve publike-infrastrukturës teknike

Nënkategoritë		a) Dimensionet e parcelës b) lartësia e ndërtesës (H) c) intensiteti i zhvillimit
Infrastruktura e ujësjellësit	Kaptazha e ujit të papërpunuar Stacionet e pompimit Fabrikat për përpunimin e ujit Rezervuarët e ujit të pijshëm	Varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoren
	Rrjeti i ujësjellësit- primar, sekondar dhe terciar	/
Infrastruktura e ujërave të zeza	Galeritë e kullimit Stacionet e pompimit për largimin e ujërave të tepërta Drenazhet Kolektorët për pranimin dhe transportin e ujërave të zeza Deponitë për materiet e ndotura Fabrikat (impiantet) dhe pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza Zonat e shkarkimit të ujërave të trajtuara	Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të zeza duhet të planifikohet në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5- 10 ha
	Rrjeti i kanaleve kryesore dhe dytësore	/
	Gropat septike (GS)	Madhësia e GS varet nga kapaciteti i shfrytëzuesve: -min.3000l (shtëpi individuale) -min.5700l (grup shtëpish) -19000l për objekte fabrikuese
Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë termike elektrike	Stacionet transformuese të të gjitha niveleve	Varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoren
	Linjat nëntokësore dhe mbitolësore	/
	Rrjeti i tensionit të lartë/ sistemi i transmisionit Rrjeti i tensionit të ulët/ sistemi i shpërndarjes	/ /
Shërbimet për Efiçiençë të energjisë	Ndërtimi i depos qendrore për biomasë	Varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoren
Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave	Fabrikat për trajtim të mbeturinave Deponitë për mbeturina -deponi për mbeturinat jo të rrezikshme -deponi të mbeturinave inerte	Infrastruktura e ndërtesave për trajtimin e mbeturinave duhet të planifikohet në parcela kadastrale zhvillimore të rregulluara në bazë të kapacitetit dhe legjislacionit sektoral në fuqi.

Gjatë dhënies së lejes ndërtimore për ndërtesat e kësaj infrastrukture, përveç kushteve të cekura të mirren parasysh kushtet e zonave tjera në veçanti të zonave mbishtresore, të zonave të mbrojtura sanitare ujore, zonave të mbrojtura natyrore etj.

Vijat, Qasja dhe vendosja e objektit në parcelë si dhe Distanca

Infrastruktura e ujësjellësit duhet të planifikohet si në vijim:

- 2m' nga vija ndërtimore në rrugët me gjerësi 7m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.5m';
- 1.5m' nga vija ndërtimore në rrugët me gjerësi 6m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1m';
- trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës në rrugët me gjerësi 5m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1m'.

Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të zeza, duhet të planifikohet si në vijim:

- 6.6m' në largësi nga vija ndërtimore në rrugë me gjerësi 7m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.5m'²⁰;
- 6m' në largësi nga vija ndërtimore në rrugë me gjerësi 6m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1m;
- trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1m.
- në afërsi dhe në drejtim të rrjedhës së jashtme të lumit me qëllim të shkarkimit të ujërave të trajtuara;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore-vërshimet;
- në lokacione jashtë vendbanimeve, dhe të izoluara nga vendbanimet;

Për organizimin e *sistemit të largimit të ujërave të zeza përmes gropave septike* individuale dhe kolektive me sistem të vetëpastrimit të ujërave të ndotura në vendbanimet më të thella (kodrinoro-malore) me numër më të vogël të banorëve të mirren parasysh kushtet:

^{20,18,19} Në referencë të UA për normat e planifikimit hapësinor: *Shënim: Në rast të pa-mundësisë së plotësimit të ndonjërit nga kriteret e kërkuar me sipër, autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor është i obliguar të paraqesë alternative, ne konsultim me autoritetin përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti.

- sistemi i përzgjedhur për trajtimin e mbeturinave të jetë në ngastrën vetjake;
- sistemi të jetë ekologjik dhe të mos shkaktojë bezdi për fqinjësinë dhe t'i respektojë kushtet sanitare dhe ekologjike;
- largësitë mes pusëve duhet të respektojnë kushtet për të mundur qasje dhe mirëmbajtje të lehtë.

Linjat mbitokësore dhe nëntokësore të rrjetit të energjisë elektrike, duhet të planifikohen:

- në bazë të vlerësimit të ndikimit të fushës magnetike dhe elektrike të krijuar nga rrjeti i linjave mbitokësore;
- në largësi nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, me përjashtim të ndërtesave industriale të rezistueshme ndaj djegies:
 - o 40m nga autoudhat
 - o 20m nga rrugët nacionale
 - o 10m nga rrugët rajonale dhe lokale
- për linjat ajrore me tension deri 1kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët kallkan të ndërtesës, nuk ka kufizim;
- për linjat ajrore me tension deri 1kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët e fasadës së ndërtesës (ballkon, lozhë, dritare, verandë) nuk duhet të jetë më e vogël se 2m;
- për linjat nëntokësore, largësia ajrore e linjës duhet të jetë jo më e vogël se 1m nga vija ndërtimore.

Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, rrjetave të reja bartëse dhe distribuive të gazit, linjave të reja direkte elektro-energjetike dhe linjave gypore direkte për transimin e gazit natyral, bazohet në procedurat e autorizimit ose procedurat e tenderimit, pas të cilave ndërmarrja e energjisë, fituese e tenderit, do të pajiset nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me lejen e ndërtimit dhe me licencën që nevojitet për kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë. Ndërmarrjet e energjisë që do t'i kryejnë punët e distribuimit dhe të furnizimit të qytetarëve me energji elektrike, energji termike (ngrohje) ose gaz natyror duhet të jenë të pajisura me licencë nga ZRRE. Punët në ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror, duhet të kryhen në përputhshmëri me kodet teknike që i përpilojnë ndërmarrjet e energjisë të miratuara nga ZRRE.

Deponitë e mbeturinave:

Duhet të planifikohen në lokacione si në vijim²¹:

- në gryka të rrethuara me shpatina, sipërfaqe që kanë shërbyer për eksploitim, lokacione të rrafshata;
- në largësi nga kufiri i zonës neutrale, që rrethon deponitë deri tek shfrytëzimet në vijim:
 - o nga rrjetet elektrike: 100m;
 - o nga infrastruktura hekurudhore: 100m;
 - o nga ndërtesat e banimit: 500m;
 - o nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze: 600m;
 - o nga shtretërit e lumenjve dhe brigjet e liqeneve: 1000m;
 - o nga vendbanimet: 1500m;
 - o nga burimet e ujit dhe ujësjellësit dhe spitalet: 2000m;
 - o nga spitalet: 2000m;
 - o nga infrastruktura ajrore: 4000m.

Nuk duhet të planifikohen në lokacione si në vijim²²:

- në zonat e rrezikuara nga erozioni;
- në zonat e rrezikuara nga vërshimet apo të vërshuar në 25 vitet e fundit;
- në zonat me shkallë të lartë të rrezikshmërisë sizmike;
- në zonat me pjerrtësi të thukët;
- në zonat ku ujërat nëntokësorë janë afër sipërfaqes së tokës;
- në zonat me pasuri minerale dhe minimet;
- në zonat me përdorim intensiv të bujqësisë;
- në zonat ku rrezikon llojet e veçanta të florës dhe faunës;
- mbi strehimore apo tunele nëntokësore;
- në zonat ku distanca nga fundi i deponisë deri tek niveli ujërave nëntokësore gjatë sezonit është <2m;
- në zonat ku përshkueshmëria e tokës është > 0,00001 cm/s.

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritat mbrojtës të gjelbërimit: sipas Kushteve Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: kushtet për kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përcaktohen sipas normave apo rregulloreve të ligjeve respektive.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për eficiencë të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe sipas rregulloreve të ligjeve respektive.

Siguria nga zjarri: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe legjislacionit përkatës.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: vlejnë Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Bonuset e zonimit: do të përdoren nga komuna për të intervenuar në shpronësimin apo kompensimin e pronës private në mënyrë që këto hapësira të kenë pronësi publike. Autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor bonuset e zonimit për ofrimin e shërbimeve publike p.sh. për sigurimin e parcelës për ndërtesat e tilla dhe të gjitha përmbytjet e tyre përcjellëse.

5.6. Sipërfaqet e rrjetit të transportit

Këtu përfshihen sipërfaqet ku shtrihet infrastruktura e transportit rrugor, hekurudhor, ajror dhe transport jo i motorizuar si dhe shërbime tjera mbështetëse.

5.6.1 Sipërfaqet e rrjetit të transportit rrugor

Rrjetin e rrugëve e përbëjnë: a) Autoudha, b) Rrugët nacionale; c) Rrugët rajonale; d) Rrugët lokale; e) Rrugët e pakategorizuara.

Kutia 5 Rrjeti rrugor publik në Kosovë

Autoudhë: rrugë publike posaqërisht të ndërtuar dhe të destinuar vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike e cila është e shënuar me shenjë të posacme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtimet e kundërta të shiritave me gjerësi së paku 3.50 m', varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autoudhës, me gjerësi së paku 2.5 m'.

Rrugë Nacionale: nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si Rrugë Nacionale, e cila lidh dy e më tepër qytete dhe e cila mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës.

Rrugë Rajonale: nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër rajoneve.

Rrugë Lokale: rruga publike e cila lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune.

Rrugë e Pakategorizuar: rruga e cila nuk është e caktuar si rrugë publike, por shfrytëzohet për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeneve akumuluese, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme²³.

Brezi Rrugor: është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e rrugës, gjerësia e të cilit kalkullohet nga cepi i skajshëm i profilit tërthor të rrugës, përkatësisht nga cepi i jashtëm i kanalit për largim të ujërave, dhe i shërben për mbrojtjen e rrugës dhe trafikut që realizohet nëpër të.

Brezi Mbrojtës Rrugor: është një hapësirë e vazhdueshme rrugore, në të dy anët e rrugës, distance e të cilit kalkullohet nga cepi përfundimtar i brezit mbrojtës rrugor dhe shërben përveç për mbrojtjen e rrugës dhe trafikut që realizohet nëpër të, gjithashty edhe për kufizimin e llojit dhe shtrirjes së zhvillimit në të.

5.6.1.1 Sipërfaqet për transport dhe komunikacion sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjisë nacionale

Rrjeti rrugor në vendbanimet rurale

Në Komunën e Podujevës shtrihen rrugët e pesë kategorive duke filluar nga autoudha Prishtinë–Merdat, rrugët nacionale, rajonale, lokale si dhe ato të pa kategorizuara. Shtrirja e Rrugës nacionale, kryesisht në pjesën qendrore dhe jug-lindore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësire.

Tabela 12 Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë dhe Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive

Kategoria	Drejtimi	Gjatësia		Sipërfaqja			Tërësitë hapësinore		
		Km	%	A	B	total	AQ	NT	MP
Autoudha	Prishtinë – Merdat								
Rrugë Nacionale	Rruga nacionale N25	18.8	1.53	16.54	4.51	21.05	18.8	0.0	0.0
Rrugë rajonale	R129 Podujevë-Mitrovicë R128 Podujevë-Vushtri R126 Podujevë – Pollatë R125 Podujevë-Orllan R127 Podujevë -Perpelac	80	6.53	47.44	14.2	61.67	37.29	23.12	19.59
Rrugë lokale	Rrugët lokale në 78 vendbanimet përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve	370.1	30.21	166.40	63.1	229.50	181	59.1	130
Rrugë e pa kategorizuar	Rrugë në të gjitha lagjet e fshatrave dhe hapësirat ku zhvillohen aktivitetet socio-ekonomike	756.3	61.73	185.48	0	185.48	370	107.8	278.5
Total		1225	100	415.86	81.84	497.70	607	190	428.1
%		100					49.55	15.51	34.94

²³ UA Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike për Planifikim Hapësinor

Rruga nacionale N25: Sipas PZHK është paraparë zgjerimi i saj me 4 korsi në segmentin nga rreth-rrotullimi ku përfundon Autostrada Ibrahim Rugova deri tek Hotel Besiana në një gjatësi prej 20km, rritja e cilësisë së asfaltit nga kufiri me komunën e Prishtinës deri tek vendbanimi Merdar me gjatësi 18.8km, mirëmbajtja e rrugës, rregullimin e anësoreve, trotuareve, sinjalizimit, kufizimit e aktiviteteve ekonomike përgjatë segmenteve rrugore sipas standarteve etj.

Rrugët rajonale, sipas PZHK-së kanë nevojë për mirëmbajtjen e rregullt, rregullimin e trotuareve, zgjerimin e rrjetit rrugor, rregullimin e anësoreve, sinjalizimit, kufizimit e aktiviteteve ekonomike etj.

Rrugët lokale: PZHK rekomandon rregullimin e rrugës tranzit në gjatësi 2.45 km e cila do të lidh Rrugët R126 dhe R127; mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara dhe atyre me mbulesë nga rëra dhe zhavorri, të cilat kryesisht shtrihen në tërësitë Malet dhe Peisazhet e Natyra dhe Turizmi; rregullimin e trotuareve, sinjalizimit, anësorëve si dhe aty ku është e nevojshme apo mungon shtrirjen e shtigjeve për transport jo të motorizuar përfshirë dhe shiritat e gjelbër. Duke pas parasysh që HZK planifikon plotësimin, dendësimin dhe konsolidimin e vendbanimeve kërkohet ndërtimi i rrugëve të reja lokale apo asfaltimi i rrugëve lokale (kryesore, përmbledhëse dhe rrugëve për qasje) ekzistuese brenda vendbanimeve rurale.

Rrugët e pa kategorizuara shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të vendbanimeve. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

Rrjeti rrugor në vendbanimin urban

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK/U, është konstatuar se ka pasur investime të mëdha në shtrirjen dhe përmirësimin e rrjetit rrugor. Aktualisht, duke ju referuar planifikimeve të nivelit qendror, është duke u punuar në zgjerimin e rrugës nacionale N25. Në të ardhmen planifikohet edhe ndërtimi i autoudhës Prishtinë-Merdar, traseja e saktë e së cilës nuk ka mundur të sigurohet nga Ministria e Infrastrukturës. Në hartë është prezantuar traseja tentative me disa të dhëna nga burime jo zyrtare.

Bazuar në kërkesat ligjore dhe Strategjisë Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 e Ministrisë së Infrastrukturës, me këtë HZK është përcaktuar hartimi i planit të transportit lokal, një iniciativë kjo e diskutuar edhe me donatëorë potencialë për përkrahje. Strategjia parasheh investime në mbrojtjen e brezit rrugor nga uzurpimet si dhe nga ndërtimet dhe kyçjet ilegale në rrjet.

5.6.2 Transporti hekurudhor

5.6.2.1 Sipërfaqet për transport dhe komunikacion sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjive nacionale

Me PZHK është paraparë rregullimi i sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat (Podujevë, Surkish, Siboc i Epërm, Lluzhan). Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, ky veprim nuk është realizuar. Në bazë të dhënave nga INFRAKOS, planifikohet të vihet në funksion segmentit të rrjetit hekurudhor që kalon nëpër komunën e Podujevës, ku matjet gjeodezike kanë përfunduar, matjet gjeomekanike dhe projekti janë në proces. Me projektin e ri traseja e linjës do të mbetet e njëjta dhe do të shqyrtohen të gjitha 29 vendkalimet ekzistuese për mundësinë e vazhimit të statusit vendkalim, eliminim të disa prej tyre, por dhe nëse është e nevojshme hapje të ndonjë vendkalimit (disniveli) të ri. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar i Ministrisë së Infrastrukturës, ka përcaktuar rindërtimin e linjës hekurudhore në drejtimet Podujevë-Prishtinë-Fushë Kosovë-Pejë si mundësi për të krijuar një linjë/degë, e cila i shërben aeroportit të Kosovës dhe organizimin e lidhjeve të mira përmes të cilave ofrohen shërbime të qëndrueshme për popullsinë. Ky projekt kap një shumë prej 290 000 000 eurosh. Strategjia promovon intermodalitetit autobus-hekurudhë për udhëtime të pasagjerëve si objektiv afatmesëm/afatgjatë, që do të financohej me mjetet e planifikuara për përmirësimin e rrjetit hekurudhor dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve për udhëtarë. Infrastruktura ekzistuese hekurudhore edhe pse në gjendje jo të mirë, paraqet bazë të mirë për modernizimin e saj, e me këtë edhe për ofrimin e shërbimeve cilësore për transportin e udhëtarëve, në kombinim me linjat e autobusëve. Duke u nisur nga kjo, me HZK është propozuar hartimi i studimit të fizibilitetit për ndërtimin e Qendrës multimodale të transportit e cila do të përfshinte stacionin hekurudhor, të autobusëve, rrugën tranzit në afërsi të qendrës komunale për shmangien e kalimit të automjeteve brenda saj, parkingjet, taxit, etj. Propozimi

i INFRAKOS për sipërfaqen e tokës në pronësi të tyre përballë stacionit hekurudhor është që të ndërtohet një stacion i autobusëve, vend-parkingjet për biçikleta, taksi dhe eventualisht edhe ndonjë shërbim tjetër transportues. Planet për shfrytëzim të patundshmërisë janë komerciale respektivisht dhënie me qera pas marrjes së pëlqimit për ushtrim të veprimtarisë nga Komuna. Studimi i fizibilitetit duhet të identifikojë ndikimin në transport dhe në shfrytëzimin e tokës, vlerësimin e kostove dhe përfitimeve dhe vlerësimin 'vlerës në para'. Studimi duhet të merr parasysh të dhëna të sakta të udhëtimeve në linjat ekzistuese ndër-urbane dhe parashikimet për numrin e shfrytëzuesve të ardhshëm. Strategjia po ashtu parashihet Sigurimin e vendkalimeve në hekurudha përmes instalimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, eliminimin e ndërtimeve ilegale në brezin mbrojtës të hekurudhave.

5.6.3 Sipërfaqet e rrjetit të transportit- ajror

Në komunën e Podujevës ekziston aeroporti sportiv në Dumosh. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 e Ministrisë së Infrastrukturës, ka përcaktuar Renovimin e tij (renovimin e ndërtesave ekzistuese, rregullimin e pistës, vendosjen e një hangari të parapërgatitur, rregullimin e rrethojës).

5.6.4 Urat

Sipas PZHK-së në komunën e Podujevës ekzistojnë gjithsej 102 ura që i përkasin kategorisë së komunikacionit rrugor dhe hekurudhor. PZHK rekomandon rehabilitimin dhe zgjerimin e disa urave, që të jenë më stabile dhe më të sigurta për qarkullim edhe gjatë rritjes së nivelit të ujit në liqenin e Batllavës. Raporti për vlerësimin e zbatimit të PZHK-së, tregon që ka pasur investime në rregullimin dhe zgjerimin e urave. Këto investime bëhen në baza të rregullta vjetore meqenëse komuna ka një numër të madh të lumenjve.

Kutia 6 Urat në komunikacionin rrugor dhe hekurudhor në Podujevë

Urat në komunikacionin rrugor

Në komunikacionin rrugor janë ndërtuar 96 ura, ku 6 shtrihen në rrugë nacionale dhe 9 në rajonale, ndërsa të tjerat mbi rrugë lokale dhe të pa kategorizuara.

- Urat mbi rrugë nacionale: për shkak të konfiguracionit të terrenit ka qenë e nevojshme që brenda 18.8 km² të rrugës të ndërtohen 6 ura 2 në Lluzhan dhe 4 në Podujevë. Dy urat më të rëndësishme shtrihen mbi lumin Llap njëra në dalje të zonës urbane që është me gjatësi 53m', dhe tjetra në pjesën jugore të zonës kadastrale të Lluzhanit në kufi me zonën kadastrale të Shakovicës me gjatësi 80m'.
- Urat mbi rrugë rajonale: janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve rajonale, njëra është e vendosur në rrugën rajonale Pollatë–Podujevë (përkatësisht në zonën kadastrale të Repës me gjatësi prej 40m', mbi lumin Llap dhe tjetra në zonën kadastrale të Bajçinës me gjatësi 22m', dhe 2 ura në rrugën rajonale Lluzhan–Batllavë–Orllan si ura në zonën kadastrale të Shakovicës me gjatësi prej 32m' mbi lumin Batllavë dhe ajo në zonën kadastrale të Orllanit me gjatësi prej 36m', mbi një pjesë të Liqenit të Batllavës. Urat mbi rrugë lokale dhe të pakategorizuara-urat tjera shtrihen mbi rrugët lokale dhe të pakategorizuara dhe janë me gjatësi nga 1deri në 10m'. Në përgjithësi urat janë në gjendje mesatarisht të mirë, me përjashtim të disa urave të cilat karakterizohen me gjerësi të vogël dhe të pamjaftueshme.

Urat në komunikacionin hekurudhor

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Podujevës janë të ndërtuar gjithsej 6 ura prej të cilave 1 në Lupç të Poshtëm, 2 në Lluzhan, 1 në Siboc të Epërm, 1 në Podujevë, 1 në Livadhi. Prej gjithsej 6 urave, 2 janë të ndërtuar mbi lumin Llap, dy mbi rrugë nacionale dhe 2 ura në rrjedhat tjera. Urat më të rëndësishme mbi rrjetin hekurudhor janë ato të ndërtuara mbi nacionale, në periferi të zonës urbane me gjatësi prej 25m, dhe mbi lumin Llap në Lupç të Poshtëm me gjatësi 55m gjatësi. Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli afër Merdarit (tuneli në komunën kadastrale të Merdarit me gjatësi prej 1500m' në rrjetin hekurudhor).

5.6.5 Sipërfaqet e rrjetit të transportit publik dhe transportit jo të motorizuar

Transporti publik në nivel lokal organizohet nëpërmjet autobusëve, kombi-busëve dhe automjeteve të tjera të transportit dhe është mjaft mirë i organizuar. Nga 78 vendbanime, 40 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, 21 nëpërmjet të kombi-busëve dhe 17 vendbanime nuk kanë transport publik. Në zonën urbane ndodhet stacioni i autobusëve, i cili nuk është në gjendje të mirë. Sipas PZHK-së kërkohet që të përmirësohet transporti publik ku qytetarët do të kenë qasje më të mire, dhe shtrirja e rrjetit të transportit dhe qasja e të gjitha vendbanimeve në të, përmirësimi në rritjen e komoditetit në mjetet e transportit publik, si dhe respektimin rigoroz të itinerareve. Gjithashtu kërkohet rregullimi i shtigjeve për këmbësorë e çiklistë përfshirë edhe shiritat e gjelbër rrugor brenda vendbanimeve. Sipas raportit të vlerësimit të PZHK/U-së ka pasur pak investime në realizim të projekteve të tilla.

Kutia 7 Definicionet

Vendndalimet për autobusa: vend i shenjuar me shenjzim për ndaljen e autobusëve.

Shtegu: nënkupton sipërfaqen e rregulluar për lëvizjen e këmbësorëve dhe biçikletave.

Korsitë për biçikleta: nënkupton pjesën e rrugës e dedikuar për qarkullimin e biçikletave, e shënuar me shenja përkatëse të komunikacionit.

Brezi Mbrojtës i korsive dhe shtigjeve: është një brez tokësor në të dyja anët e korsisë dhe shtegut distanca e të cilit llogaritet nga cepi i skajshëm i profilit tërthor të korsive dhe shtigjeve për biçikleta.

5.6.6 Sipërfaqet e rrjetit të transportit- parkingjet

Plani ka paraparë sigurimin e hapësirave për parking, të cilat gjatë zbatimit të tij janë realizuar në masë të vogël. Me HZK është adresuar nevoja e sigurimit të hapësirave për parkingje të hapura të veturave sidomos në qytet.

5.6.7 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Infrastruktura e transportit rrugor:

Shfrytëzimet e lejuara: infrastrukturë e transportit rrugor publik të kategorisë nacionale, rajonale, lokale, të banimit, përmbledhëse, për çasje, shtigjet, pusetat e infrastrukturës teknike, semaforët, kanalizimi i ujërave atmosferik, trotualet, brezat e gjelbër, rrethojat, muret/panelet për mbrojtje nga zhurma dhe rrethrotullimet;

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: vendkalimet, tunelet, urat, parkingjet, shtigjet, shiritat e gjelbër, shtyllat për ndriçim, reklamat, ndalesat e autobusëve, automjeteve, dhe kamionëve, pajisjet tjera në shërbim të transportit, sinjalizimi vetikal, dhe muret mbrojtëse.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, dhe infrastrukturë tjetër.

Shfrytëzimet e përkohshme: Pajisjet dhe makineritë për ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje të rrugëve, infrastrukturës në mbështetje të infrastrukturës së transportit rrugor (stacioni i autobusëve), shërbimet tregtare e të ushqimit, si dhe të infrastrukturës së shërbimeve publike.

Infrastruktura e transportit hekurudhor:

Shfrytëzimet e lejuara: binarët, shinat, kanalizimi i ujërave atmosferik, kanalet e muosura, muret rrethuese, rrethojat, shiritat për mbrojtje nga zjarri, kryqëzimet, rrugët të cilat kalojnë mbi binarë, aparatat për nxehjen e ndëruesve dhe rrjetat për mbrojtje nga bora, muret për mbrojtje nga zhurma.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: mbikalimet, sinjalizimi, pajisjet në shërbim të infrastrukturës hekurudhore, rruga për qasje të udhëtarëve dhe mallrave.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, dhe infrastrukturë tjetër.

Shfrytëzimet e përkohshme: Pajisjet dhe makineritë për ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje të hekurudhës, infrastrukturës në mbështetje të infrastrukturës së transportit hekurudhor (stacioni hekurudhor), shërbimeve tregtare e të ushqimit, si dhe të infrastrukturës së shërbimeve publike.


Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkohshme me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme

Qendra e mobilitetit:


Shfrytëzimet e lejuara: infrastruktura në shërbim të infrastrukturës së transportit rrugor dhe hekurudhor (stacioni hekurudhor dhe i autobusëve).

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: parkingjet, infrastruktura e transportit rrugor dhe hekurudhor (rrugët servitore dhe qasëshe), shtyllat për ndriçim, reklamat, shërbime tregtare me pakicë dhe shërbime ushqimi (restorane dhe kafeteri), ndalesat e autobusëve.

Harta 26 Sipërfaqet e rrjetit të transportit



Harta 27 Sipërfaqet e rrjetit të transportit – qytet



Kushtet zhvillimore

Përcaktimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën e transportit rrugor dhe hekurudhor është bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të dhëna mëposhtë:

- UA Nr.08/2017 mbi Normat Teknike për Planifikim Hapësinor
- Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020
- Ligji Nr.2003/11 për Rrugët; Ligji Nr.03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr.2003/11
- Ligji Nr.06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120; UA Nr.04/2011 për Vendosjen, Formën, Ngjyrën, Dimensionet e Shenjave dhe Sinjalizimet e Pajisjeve në Komunikacion Rrugor; UA Nr.09/2015 për Kyçje, Instalime nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe rajonale
- Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

Gjatë planifikimit të projekteve në këtë lëmi, përveç kushteve të mëposhtme të mirren parasysh kushtet e zonave tjera sidomos zonave mbishtresore, zonave të mbrojtura sanitare të burimeve ujore, atyre të mbrojtura natyrore.

a) Kushtet teknike

a1) *Infrastruktura e transportit rrugor: Rrugët në kompetencë të nivelit qendror*- Kushtet teknike për rrugët të cilat janë në *kompetencë të nivelit qendror* (autoudhët, rrugët nacionale dhe rrugët rajonale) përcaktohen në pajtim me legjislacionin e lartpërmendur. Sa i përket procedurës dhe mënyrës së kyçjes individuale apo kolektive në Rrugët Nacionale dhe Rajonale, vendosjes së instalimeve përcaktohen me rregullat ligjore për kyçje, Instalime, nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale sipas të cilave personi fizik apo juridik duhet të kërkoj pëlqimin nga Ministria e Infrastrukturës për kyçje në Rrugët Nacionale dhe Rajonale.

Tabela 13 Normat për kategoritë e rrugëve

Kriteret	Kategoria e rrugës						
	Autoudha (E)	Rrugë Nacionale (N)			Rrugë Rajonale (R)		
		Rr.që lidhin VB rurale të kategorizuara si rr.nacion.	Rr.brenda VB rurale të kategorizuara si rr.nacion.	Rr.brenda VB urban të kategorizuara si rr.nacion.	Rr.që lidhin VB rurale të kategorizuara si rr.rajonale	Rr.brenda VB rurale të kategorizuara si rr.rajonale	Rr.brenda VB urban të kategorizuara si rr.rajonale
Gjerësia e rrugës	Sipas normave respektive	Min.23m'			Min.23m		
Brezi mbrojtës rrugor - Në hapësirën e caktuar si brez mbrojtës rrugor nuk lejohet hapja e minierave, ndërtimi i liqeneve artificiale, fabrikave, ndërtesave të ngjashme në distancë më të:	≤100m nga autoudha	≤60m nga rr.nacionale			≤40m nga rrugët rajonale		
- Në hapësirën e caktuar si brez mbrojtës rrugor nuk lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit, administrative, hapja e puseve të ujit dhe gropave septike, ngritja e instalimeve të transmetuesëve elektrik dhe të ngjashme, në distancë më të:	≤40m nga autoudha	≤20m nga rr.nacionale			≤10m nga rrugët rajonale		
Parkimi në profilin tërthor të rrugës	S'ka	S'ka			S'ka		
Sinjalizimi dhe shenjzimi	në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA Nr. 04/2011 për Vendosjen, Formën, Ngjyrën, Dimensionet e Shenjave dhe Sinjalizimet e Pajisjeve në Komunikacion Rrugor						

a2) *Infrastruktura e transportit rrugor: Rrugët lokale të nivelit lokal* - janë kompetencë e Komunës së Podujevës dhe ndërtimi i tyre realizohet nën mbikqyrjen e organeve kompetente komunale. Duke pas parasysh që HZK planifikon plotësimin, dendësimin dhe konsolidimin e vendbanimeve, kërkohet ndërtimi i rrugëve lokale të reja apo asfaltimi i rrugëve lokale ekzistuese brenda vendbanimeve rurale dhe sidomos atij urban. Në rastet kur gjerësia minimale nuk mund të aplikohet te rrugët publike të planifikuara atëherë mund të merret gjerësia e rrugëve ekzistuese mirëpo duke respektuar kushtet për sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Për qëllime të HZK-së është planifikuar ndarja e qytetit në njësi urbane (shih hartën vijuese), dhe me këtë kërkohet edhe riorganizimi i kategorisë së rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i profileve të reja të motorizuara sipas normave në tabelën e mëposhtme.

Tabela 14 Normat për ndërtimin e rrugëve lokale dhe përmbajtjeve përcjellëse

	Rrugët në vendbanimet rurale				Rrugët në vendbanimin urban								
	Rr.tranzi te nëpërmjet VB-fshatra.	Rr.brenda VB rural		Rr. të pakategorizuara (rr. mali, rr.për qasje në t.bujq.etj)	Rr.rrjetit nacional/regjion.	Rr.tranzite urbane	Rr.për mbledhëse	Rr.shpërndarëse/Rr. banesore	Rr. për qasje		Rr. Servisore	Rr. Industriale	
		njëkahëshe	dykahëshe						njësia hësh	dykahëshe			
Gjerësia e rrugës	9.5m'	3.5m'	5.5m'	3.5m'	23 m'	21m'	14.5 m'	9 m'	3.5m'	5.5m'	9m'	10m'	
Brezi mbrojtës rrugor Në brezin mbrojtës rrugor nuk lejohet hapja e minierave, ndërtimi i liqeneve artificiale, fabrikave, ndërtesave të ngjashme në distancë:	≤ 30m nga rrugët lokale				Nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimit								
Në brezin mbrojtës rrugor nuk lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit, administrative, hapja e puseve të ujit dhe gropave septike, ngritja e instalimeve të transmetuesëve elektrik dhe të ngjashme, në distancë më të:	≤ 10m nga rrugët lokale				Nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimit								
Parkimi në profilin tërthor të rrugës	S'ka		Lejohet	S'ka	S'ka	S'ka	Lejohet	Lejohet	Lejohet	S'ka	S'ka		
Trotuaret	1.5m	1.5m	1.5m	S'ka	2.5m'	2m'	1.5m	1.5m	1.5m				
Sinjalizimi dhe shenjzimi	në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA Nr. 04/2011 për Vendosjen, Formën, Ngjyrën, Dimensionet e Shenjave dhe Sinjalizimet e Pajisjeve në Komunikacion Rrugor												

a3) Infrastruktura e rrjetit hekurudhor:

Brezi hekurudhor rregullohet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe Rregullores së aplikueshme, i cili ka përcaktuar kushtet për zhvillimet në afërsi të infrastrukturës hekurudhor sipas të cilit ndërtesat dhe strukturat e tjera, uzinat dhe stabilimentet mund të vendosen në brezin mbrojtës të hekurudhës bazuar në miratimin sipas kushteve të dhëna në vazhdim:

- në vendbanime, male, terrene me baltë dhe vende të tjera ku kërkojnë kushtet fushore, mund të miratohet dhe lejohet hapja e minierave, guroreve, ndërtimi i tullave dhe gëlqeres, ndërtimi i ndërtesave industriale apo strukturave të ngjashme në brezin mbrojtës afër hekurudhës nëse toka ku do të vendosen ato është terren i përcaktuar nga autoritetet komunale për ndërtimin e strukturave dhe uzinave por kjo nuk mund të jetë më afër se 50m nga aksi i binarit të fundit anësor;
- ndërtimi i shtëpive, bizneseve, ndërtesave ndihmëse dhe të ngjashme, gërmimi i puseve, rezervarëve, gropave septike, ndërtimi i linjave të gjata elektrike, etj. mund të miratohet në vendbanime dhe tokën sipas legjislacionit në fuqi por jo më afër se 25m nga aksi i binarit të fundit anësor;
- shenjat dhe billboardet mund të vendosen në brezin mbrojtës të paktën 7m nga pika e fundme e hapësirës hekurudhore;
- nëse për shkak të ndërtimit të një strukture apo mirëmbajtjes së saj (rrugë publike, aeroport, rezervar, strukturë e rrymës, minierë, etj.), një pjesë e aseteve hekurudhore është dëmtuar, atëherë kjo pjesë e aseteve të hekurudhës që është dëmtuar duhet të riparohet në bazë të normave dhe standardeve ekzistuese për llojin e aseteve hekurudhore pa marr parasysh gjendjen aktuale para dëmtimit. Në këtë rast shpenzimet për riparim të aseteve të dëmtuara hekurudhore duhet t'i bartë investitori i strukturës së re apo të mirëmbajtjes së saj.

Kutia 2 Rregullorja 315 për hekurudha

Sipas Rregullores 315 e aplikueshme nga autoritetet kosovare kemi:

- Brezi i hekurudhës është hapësira ndërmjet binarëve hekurudhorë, si dhe pranë binarëve të skajshëm-fundorë, në distancë më së paku 8m, e në rast se vija hekurudhore kalon nëpër vendbanime- në distancë më së paku 6m, llogaritur nga aksi i binarit të skajshëm.

- Brezi mbrojtës hekurudhorë është brezi i paramenduar në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi prej 200m, llogaritur nga aksi i binarëve të skajshëm ndërsa sipërfaqja e hapësirës ajrore mbi (T L SH) tehur e lartë të shinës për largpërçuesit deri në 220 kV është në lartësi prej 12m gjegjësisht 14m te largpërçuesit me tension mbi 220 kV.
- Në brezin hekurudhorë me distancat më së paku 8m në vijën e hapur hekurudhore, gjegjësisht më së paku 6m nga aksi i binarëve fundor në stacione, mundë të ndërtohen vetëm objektet dhe stabilimentet hekurudhore. Në veçanti e më pëlqimin e HK mund të ndërtohen stabilimentet e organizatave tjera që shërbejnë për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave në hekurudhë.
- Në brezin mbrojtës hekurudhorë varësisht nga lloji dhe destinimi mundë të ndërtohen objektet ndërtimore dhe objektet tjera, ngritja dhe vendosja e stabilimenteve dhe pajisjeve në distancë jo më të vogël se 25m llogaritur nga aksi-boshti i binarit fundor, pos objekteve që janë në funksion të komunikacionit hekurudhor.

Sinjalizimi i kryqëzimeve rrugë hekurudhë duhet të bëhet në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës. Me qëllim të riorganizimit dhe përmirësimit të qarkullimit dhe transportit të motorizuar dhe jo të motorizuar në komunën e Podujevës rekomandohet hartimi i Planit të Mobilitetit për tërë komunën.

a4) Transporti publik

Në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve një qasje më e lehtë, qarkullim i sigurt dhe i rehatshëm rekomandohet shtrirja e rrjetit edhe në ato vendbanime ku mungon, rritja e komoditetit në mjetet e transportit publik dhe respektimi rigoroz i itinerareve.

a5) Transporti jo i motorizuar

Meqenëse tentohet drejt kompaktësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të zonës urbane por edhe të vendbanimeve rurale, promovohet ndërtimi dhe përdorimi i shtigjeve për transport jo të motorizuar sidomos brenda zonave të banimit. Brenda vendbanimeve duhet të inkurajohet përdorimi i transportit jo të motorizuar në mënyrë që të zvogëlohet ndikim negativ në mjedis, andaj aty ku është e mundur duhet ndërtuar shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta si dhe brezi i gjelbërt sipas standardeve të parapara me UA mbi NTPH.

Tabela 15 Normat e transportit jo të motorizuar

	Rrugë rajonale		Rrugët lokale në vendbanimet rurale				Rrugët lokale në vendbanimin urban							
	Brenda vendbanimit		Jashtë vendbanimit	Rr. që lidhin VB rurale	Rr. kryesore të VB rural	Rr. tjera të VB rural		Rr. rrejt nacional/re gjonat	Rr. tranzite urbane	Rr. përmbledhës e/shpërndarëse	Rrugë banesore	Rr. servise	Rr. për qasje	
	Një drejt mësh	Dy drejt mësh				Një drejt mësh	njëkah hësh						dykahësh	njëkahësh
Shtegu për biçikleta	1.5-2m'	2-2.5m'	1-1.6m'	1-1.6m'	1.2m'	1.2m'	1.5m'	1.5m'	1.5m'				1.2m'	
Shtigjet për persona me nevoja të veçanta: Gjerësia e shtegut duhet të jetë të paktën 1.80 m', por aty ku nuk mund të sigurohet kjo gjerësi mund të jetë 1.50 m'. Gjerësia e kalimeve për personat me nevoja të vecanta ndërmjet pengesave fiksa duhet të jetë të paktën 0.90 m'.														
Brezi i gjelbërt përgjatë shtigjeve duhet të jetë ≥ 3m'.														

Tabela 16 Madhësia e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit për qendrën e Mobilitetit

Objekti	Madhësia e parcelës ndërtimore	Lartësia E ndërtesës	Intensiteti		
			IShPKZh	SGJP	ISN
Qendra e mobilitetit (stacion i autobusëve dhe hekurudhës)	Kushtet për qendër të mobilitetit duhet të analizohen varësisht nga kapaciteti i linjave të planifikuara transportit rrugor dhe hekurudhor. Madhësia e objektit mund të varion sipas studim të fizibilitetit për qendër të mobilitetit në komunën e Podujevës.				

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës dhe Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike të përcaktuara me ligjet përkatëse për të mbrojtur mjedisin përreth nga ndotja. Në mënyrë që të parandalohet ndotja që do të pengonte zonat fqinje duhet të krijohen brezat mbrojtës me gjerësi minimale 3m'.

Siguria nga zjarri: të merren parasysh kushtet nga Ligji për Mbrojtje nga Zjarri.

Parkingu përgjatë rrugëve dhe ndalesat e autobusëve: planifikohet që sipas mundësive të vendosen parkingjet gjatësore përgjatë rrugëve kryesore në vendbanimet rurale dhe në atë urban. Sipas UA mbi NTPH dimensionet e

parkingjeve gjatësore duhet të jenë 215x640cm. Për shkak të promovimit të përdorimit të transportit jo të motorizuar duhet të parashihen edhe vend-parkingjet për biçikleta, dimensionet e të cilave janë:

- 1.20 m²/biçikletë –hapësira e vend parkimit; 1.5/1.8 m–hapësira për qasje në vend parkim

PZHK ka rekomanduar që në zonat që shërbejnë për parkim të transportit publik, shtegu për ndalesë të autobusëve duhet të jetë 2m’ i gjerë. Kurse brezi i gjelbër përgjatë vend-parkingjeve duhet të jetë ≥2.5-4.5m’ sipas UA për NTPH.

5.7. Zona industriale dhe komerciale

Kjo zonë është e dedikuar për zhvillimin e ndërtesave për prodhimtari industriale respektivisht për veprimtari komerciale²⁴.

5.7.1 Sipërfaqet për industri sipas projeksioneve të PZHK-së

Sipas PZHK-së përveç aktivizimit të ndërmarrjeve industriale dhe zhvillimit të zonave të tilla në pjesët tjera të komunës, është rekomanduar përcaktimi i zonave të veçanta për zhvillimin e veprimtarive industriale dhe komerciale, ku njëra nga ato lokacionet është edhe ai në vendbanimin rural Livadicë që i përket ndërmarrjes shoqërore Koperativa. Komuna e Podujevës e ka miratuar vendimin për shfrytëzimin e këtij lokacioni për qëllime ekonomike. Kjo zonë do të trajtohet me PRRH, mirëpo si aktivitet paraprak do të jetë studimi i fizibilitetit, dhe krahas hartimit të PRRH-së duhet të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor (VSM) në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i zhvillimeve të planifikuara në mjedis dhe të shmangen apo zbuten ato.

Përpos këtij zhvillimi të paraparë me PZHK, gjatë periudhës së hartimit të HZK-së, komuna ka pranuar kërkesa për zhvillimin e veprimtarive ekonomike e industriale në zona tjera në territorin e komunës. Me qëllim të avancimit të zhvillimit ekonomik, komuna do të udhëzojë investitorët potencial që të hartojnë studime fizibiliteti për veprimtaritë e caktuara të cilat nuk bien ndesh me zhvillimet e lejuara të zonave se ku iniciohen. Këto veprimtari duhet të orientohen në kategori të tokës prej V-VII, si dhe të përcjellin proceduarat ligjore në bazë të legjislacionit sektoral.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Shfrytëzimet e lejuara: industri e lëndës së parë si prodhimet e drurit dhe produkteve me bazë të drurit, prodhimet e produkteve jometalike dhe minerale, industri e prodhimeve të lehta si prodhimi i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, shërbimet tregtare me shumicë, prodhimi i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikua si prodhimi i telave elektrik dhe prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: shërbim i logjistikës dhe magazinimit, shërbim administrativ dhe mbështetës, shërbim i komunikimit e informimit, shërbim teknik profesional dhe shkencor shërbim financiar dhe i sigurimit, rrjetet e transportit rrugor si dhe shërbime publike si infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, shpërndarjes së gazit, dhe energjisë termike elektrike.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: infrastrukturë e telekomunikacionit (antemat) e energjise termike elektrike (trafostacionet).

Shfrytëzimet e përkohshme: /

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Kushtet zhvillimore

Dimensionet e parcelës, lartësia e objektit, intensiteti: Dimensionet e parcelës varen nga lloji i industrisë dhe madhësia veprimtarisë që i shërben asaj industrie (qoftë një parcelë apo më shumë). Parcela duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar që nevojat aktuale dhe të ardhshme mund të përmbushen.

Tabela 17 Dimensionet e parcelës, lartësia, intensiteti i zhvillimit

Lloji i aktivitetit	MP		FP	Etazhiteti/Lartësia Kat /m’		IShPKZh	SGJP	ISN	SNP
	min.	maks.		Minimale	Maksimale				
Kuptimi i shkurtesave: MP-Madhësia e parcelës; SGJP-Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (%); IShPKZh-Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (%); ISN-Indeksi i sipërfaqes ndërtimore (vlera max.); SNP-Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (vlera max.); FP-Fronti i parcelës									

²⁴ Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

Industri e lëndës së parë dhe e prodhimeve të lehta	2500.0 m ²	10000.0 m ²	Min. 30.0m' Max. 80.0m'	P+NK (12.0m')				50%+10 %pllakosje	40%	0.5	50%
Shërbime tregtare me shumicë	1000.0 m ²	2500.0 m ²	Min. 10.0m' Max. 30.0m'	P+0				5.0 m'	P+1	8.0 m	50%+10 %pllakosje
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	700.0 m ²	1000.0m ²	Min. 20.0m' Max. 25.0m'	P+0 (5.0m')				50%+10 %pllakosje	40%	0.5	40%
Shërbim administrativ dhe mbështetës	300.0 m ²	500.0m ²	Min. 10.0m' Max. 15.0m'	P+0	4.0 m'	P+1	8.0 m'	40%+10 %pllakosje	50%	0.4-0.8	40%
Shërbim teknik profesional dhe shkencor shërbim financiar, komunikimit e informimit dhe i sigurimit	300.0 m ²	500.0 m ²	Min. 10.0m' Max. 15.0m'	P+0	4.0 m'	P+1	8.0 m'	40%+10 %pllakosje	50%	0.4-0.8	40%

Dimenzionet e ndërtesave industriale varen edhe nga lloji i industrisë dhe madhësia e veprimtarisë. Duke ju referuar UA për kategorizimin e ndërtimeve, ndërtesat industriale të mbuluara si fabrika, punëtori, thertore, birrari etj i përkasin kategorisë së II-të dhe madhësia e tyre mund të sillet deri në 400.0m² dhe mbi 400.0m².

Vija ndërtimore (VN) në rastet kur zona shtrihet përgjatë arterieve rrugore vija ndërtimore duhet të përcaktohet në përputhje me Ligjet rrugët, në të kundërtën duhet të caktohen me PRrH.

Vija rregulluese (VRR) duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese ose të planifikuar në rastet kur kemi planifikim të rrugës.

Qasja në parcelë: në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Në këtë rast qasja nga rruga nacionale apo rajonale duhet të realizohet duke respektuar kushtet e përcaktuara me legjislacionin për rrugët të përmendur në seksionin zona e rrjetit të transportit.

Distancat: distanca e lejuar e ndërtesave nga kufiri anësor i parcelës kadastrale dhe nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale duhet të jetë 2L/1GJ.

Distancat në mes objekteve industriale përcaktohen në përputhje me rregullat e sigurisë së ndërtesës dhe aktiviteteve që zhvillohen në to, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Distanca në mes të një objekti industrial dhe një ndërtese jo industriale nuk duhet të jetë më pak se lartësia maksimale mbi tokë e ndërtesës më të lartë fqinje. Gjithashtu te rastet e objekteve tjera në kuadër të kësaj zone distancat duhet të jenë të mëdha ashtu që të sigurohet qasje e lirshme e ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave, qasje e drejtëpërdrejtë e automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve tjera të emergjencave të paktën në dy anët e objektit dhe në mes objekteve, ku distanca minimale duhet të jetë sa 0.5L e ndërtesës më të lartë.

Objektet duhet të vendosen në lokacionet që do të jenë larg zhvillimeve fqinje, si dhe në distanca të përcaktuara me ligjet dhe aktet ligjore përkatëse nga monumentet natyrore e kulturore, dhe resurset natyrore²⁵, ashtu që të pengohet apo shmanget ndikimi negativ. Gjithashtu, distanca e këtyre objekteve nga infrastruktura e transportit hekurudhor, telekomunikacionit, trajtimit të mbeturinave apo të ujësjellësit, ujërave të zeza dhe energjisë termike elektrike ekzistuese, duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligje dhe aktelgjore të sektorëve përkatës²⁶. Objektet industriale nuk duhet të ndërtohen në afërsi të zonës së banimit, shërbimeve dhe hapësirave të hapura rekreative.

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike të përcaktuara me ligjet përkatëse për të mbrojtur mjedisin përreth nga ndotja. Në mënyrë që të parandalohet ndotja duhet të krijohen brezat mbrojtës sanitar me gjerësi minimale 5m'.

Siguria nga zjarri: sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri.

Ndriçimi natyror dhe artificial: Përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për eficiencë të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike për këtë zonë. Kërkesat shtesë përfshijnë:

- Dritaret dhe dyert duhet të jenë nga druri, PVC, alumini apo materialet tjera bashkëkohore;
- Nuk lejohet përdorimi i xhamave pasqyrë dhe me ngjyrë;
- Kulmi duhet të jetë dy ujor apo i fshehtë.
- Parcela duhet të jetë e rrethuar me rrethojë transparente, metali, apo çeliku të lartësisë prej 1.4m'–2 m'.

Sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti duhet të respektohen kushtet si:

²⁵ Shih Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit, Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës, Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore, Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit, Zona pyjore dhe bujqësore

²⁶ Shih Zona e shërbimeve dhe Sipërfaqet e rrjetit të transportit

- hapësira para hyrjes në shitore duhet rregulluar dhe përgatitur në mënyrën që të mundëson pastrim të lehtë dhe mirëmbajtje të sipërfaqes si dhe zgjidhje që mundëson hyrjen dhe daljen e pa penguar në shitore;
- nëse para shitores nuk ekziston teracë e rregulluar, pjesa para shitores dhe vitrinës së shitores duhet asfaltuar, betonuar ose e rregulluar me pllaka të gurit ose në ndonjë mënyrë tjetër ashtu që të sigurojë lëvizje të lirë të personave dhe të mundësojë mbajtjen e pastërtisë;
- depoja në të cilën ushtrohet shitja e mallrave me shumicë duhet të jetë e mbyllur, bëhen përrjashtime dhe depoja mund të jetë zbuluar apo e hapur, nëse lloji i mallit ose kushtet klimatike një gjë të tillë e lejojnë.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para se të filloj zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike. Sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti duhet të respektohet që mbeturinat e ngurta duhet të tubohen në vendet e caktuara duke siguruar kushtet shëndetësore-teknike si dhe largimin e tyre në mënyrën e përcaktuar nga administrata lokale.


Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: sipas Kushteve të Përgjithshme Zhvillimore.

Masat për mbrojtje të mjedisit: sipas masave të dala nga raporti i VSM-së së HZK-së zhvilluesi duhet t'i respektoj kushtet dhe masat parandaluese dhe mbrojtëse ndaj ndotjes dhe degradimit të mjedisit nga fatkeqësitë natyrore, zhurma apo rrezatimi në përputhje me normat europiane të sigurisë mjedisore dhe shëndetësore.

Bonuset e zonimit: përcaktohen me rregullore të komunës.

Jonkonformitetet: /

Harta 28 Zonat industriale dhe komerciale



5.8. Zonat turistike

Zona turistike janë sipërfaqet me vlera të mëdha natyrore, peisazhore, kulturore, sportive, shëndetësore, pushimi dhe rekreimi të cilat janë përcaktuar para se gjithash për zhvillim të turizmit.

Sipërfaqet për turizëm sipas projeksioneve të PZHK-së

Potencialet e shumta si gjeomorfologjia e territorit komunal e karakterizuar me dy masive malore si Kopaonikun dhe Gollakun, si dhe fushëgropa e Llapit së bashku me lumin Llap dhe liqenin e Batllavës, monumentet natyrore dhe ato kulturore, numri i madh i shërbimeve hoteliere i japin vlerë konkurruese komunës së Podujevës në Kosovë, që mund të jenë bazë për zhvillimin e turizmit vikendor dhe rural. PZHK rekomandon mbrojtjen nga zhvillimet, si dhe zhvillimin e avancimin e këtyre potencialeve në mënyrë që të jenë më atraktive për vizitorët apo pushuesit në të gjitha tërësitë hapësinore. PZHK përcakton që në të gjitha tërësitë të krijohen kushte më të mira për zhvillimin e

turizmit duke e përmirësuar dhe shtuar infrastrukturën e nevojshme dhe krijimin e shtigjeve për ngjitje të lehtë në male dhe ecje në sipërfaqet e tokës bujqësore duke përfshirë dhe lokacionet për pushim, për çiklizëm si dhe hapësirat e hapura rekreative dhe shërbimet hoteliere. Për shkak të rëndësisë kombëtare dhe vlerave të rëndësishme natyrore sipas PZHK-së është rekomanduar që për zonën e Liqenit të Batllavës të hartohet një plan i hollësishëm rregullues dhe të zbatohet me përpikëri.

Mirëpo, duke ju referuar kriterëve peisazhike të dalura nga raporti i VSM-së për projekt HZK-në dhe ligjeve, akteve nënligjore dhe UA 08/2017, HZK nuk lejon ndërtimet në këtë zonë dhe rekomandon mbrojtjen strikte nga degradimi.

Gjithashtu bazuar në kriteret e Raportit të VSM-së për projekt HZK-në, HZK ndalon ndërtimet edhe në zonat të konsideruara me vlera të larta peisazhore si:

- Peizazhet bujqësore, po ashtu në periudha të caktuara të vitit paraqesin një atraksion;
- Livadhet dhe kullosat, është paraparë që të mbjelljen me lloje të shumta të bimëve barishtore;
- Masivet malore të Kopaunikut dhe Gollakut.

Për të nxitur zhvillimin e turizmit Komuna ka hartuar strategjinë e zhvillimit të turizmit e cila ka përcaktuar pikat turistike, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta dhe llojin e turizmit, ku një numër i madh i rekomandimeve dhe veprimeve janë përfshirë në HZK. Rekomandimet nga strategjia dhe të përfshira nga HZK janë si në vijim:

- zhvillimi i ekoturizmit malor, rekreativ dhe sportiv, veror dhe njëditor – rregullimi i shtigjeve për ecje, ciklizëm dhe skijim në vendbanimet të cilat janë listuar në plan të veprimit.
- zhvillimi i turizmit shëndetësor - nëse raporti i fizibilitetit e arsyeton atëherë planifikohet dhe ndërtimi i një qendre shëndetësore – rehabilituese në të planifikohet në lokacionit ndërmjet vendbanimeve Bradash dhe Dobratin;
- ndërtimi i qendrës edukative – informuese për turistë në vendbanimin Orllan;
- ndërtimi i shtëpive malore në vendbanimet Recicë, Murgull, Popovë, dhe Bellasicë;
- zhvillimi i kampingut në vendbanimin Pupovc;
- zhvillimi i turizmit rural – në vendbanimet malore.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: shërbime akomodimi dhe ushqimi si objekte hoteliere, bujtina, shtëpi malore dhe kamp shtëpiza, banim i përhershëm e përkohshëm, shtigjet për ecje e çiklizëm dhe pikat informuese për turistë.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: shërbime tregtare me pakicë në funksion të këtyre zonave si shitore ushqimi dhe për përpunimin dhe shitjen e produkteve artizanale, shërbime financiare dhe të sigurimit, infrastrukturë sporti, hapësirë e hapur rekreative, infrastrukturë e transportit rrugor si rrugë rajonale, lokale dhe e pa-kategorizuar si shtigjet për ngjitje në m, ecje dhe çiklizëm, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit, dhe energjisë termike elektrike, infrastrukturë ujësjellësit dhe ujërave të zeza.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: infrastrukturë e sportit si pishina, terrene të sportit, impiante të skive, infrastrukturë e telekomunikacionit dhe e energjisë termike elektrike (trafostacionet), shërbime argëtuese si parqe dëfryese për të rritur dhe fëmijë dhe teknike profesionale e shkencore.

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime kulturore si festivale, panaire, etj., gjueti dhe peshkim rekreativ, dhe shërbime tregtare të shitjes me pakicë si pikat e shitjes së produkteve bujqësore dhe artizanale.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkohjnë me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme.

Kushtet zhvillimore

Kushtet zhvillimore do të jepen për këtë zonë ashtu si kërkohet me UA mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale, UA mbi NTPH dhe ligjet dhe aktet nënligjore sektoriale të ujërave, pyjeve, mjedisit, tokës bujqësore, natyrës dhe biodiversitetit.

Tabela 18 Dimensionet e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit:

Kategoria e objekteve hoteliere dhe turistike	Dimensionet e parcelës ndërtimore		Fronti i parcelës	Lartësia m'/kat		Intensiteti		
	minimale	maksimale		minimale	maksimale	IShPKZh	SGJP	ISN

Objekte hoteliere deri 7 njësi	500.0 m ²	1500.0 m ²	10.0m'	2	10.0	4	13.0	30% +10%pllakosje	50%	0.9 - 1.2
Bujtina/pansione deri 7 njësi	500.0 m ²	1000.0 m ²	10.0m'	2	10.0	4	13.0	40% +10%pllakosje	50%	
Shtëpi banimi me qira	300.0m ²	500.0m ²	15.0m'	1	3.0	1 +NK	5.0	40% +10%pllakosje	50%	0.4 - 0.8
Objekti shëndetësorë – rehabilitues (nëse lejohet me raport të fizibilitetit)	Deri në 1000.0m ²		10.0- 20.0m'	1	3.0	2	6.0	50%+10%plla kosje	40%	0.5 – 1.0
Shtëpi malore	200.0m ²	300.0m ²	12.0m'	1	3.0	1+N K	4.5	30% +10%pllakosje	60%	0.3 – 0.6
Qendra edukative – informative për turist në Orllan	300.0m ²	500.0m ²	10.0- 20.0m'	1	3.0	2	6.0	10-40% +10%pllakosje	70- 40%	0.25- 0.50
Kamping me 6 njësi	1000.0m ²	2000.0m ²	/	P+0 /				10-40% +10%pllakosje	/	/
Infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative (fushat sportive – rekreative shumë funksionale dhe ndërtesat sportive shumë funksionale)	≤ 5000 banor, 2.5 m ² /banor ≤ 5001 – 20000 banor 4.5 m ² /banor		/	P+0				60%	40%	0.6
Hapësirat e gjelbra	2.0 m ² /banor		/	/				/	/	/

Vijat: **Vija ndërtimore (VN)** në rastet kur zona shtrihet përgjatë arterieve rrugore vija ndërtimore duhet të përcaktohet në përputhje me Ligjin në fuqi për Rrugët. Në rastet kur zona shtrihet në qendra të vendbanimeve, VN duhet të jetë 10.0–15.0m' në rastet kur është e mundur, në të kundërtën ajo do të respektojë vijën ndërtimore ekzistuese.

Vija rregulluese (VRr) duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese ose të planifikuar në rastet kur kemi planifikim të rrugës.

Qasja në parcelë: do të bëhet përmes shfrytëzimit të rrugës ekzistuese (kjo sepse zvogëlon shpenzimet për ndërtim të ri të rrugës për qasje) ose rrugës së planifikuar me PZH/HZK dhe duhet të jetë në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushte shtesë për qasjen dhe mënyrën e hyrjes në parcelë përfshijnë:

- Hyrja në objekt parashihet në anën e objektit përdhese e të cilit është në nivel ose pak e ngritur në raport me terrenin.

Në rastet e zhvillimeve të reja, kur ekziston mundësia e paraqitjes së problemeve të qasjes në parcelë si në vijim, atëherë mund të aplikohen këto kushte të veçanta:

- Zhvillim i ri apo zgjerimi i objekteve ekzistuese nuk duhet cënuar qasjen e papenguar në parcelat kadastrale fqinje;
- Para se të filloj realizimi i zhvillimit të ri, pronari i tokës apo investitori duhet të ketë një marrëveshje me pronarin apo shfrytëzuesin e parcelës fqinje të cilit mund t'i cenohet e drejta e qasjes në parcelën e tij kadastrale;
- Në qoftë se parcela kadastrale në të cilën planifikohet zhvillimi i ri apo zgjerimi i objekteve ekzistuese nuk ka mundësi qasjeje nga rruga publike, atëherë pronari i parcelës apo investitori ka të drejtë të kërkojë nga pronari apo shfrytëzuesi i parcelës kadastrale fqinje shfrytëzimin e parcelës për të siguruar qasjen.

Distancat: për përcaktimin e distancave ndërmjet objekteve në këto zona merren në konsideratë faktorët: i) orientimi, ii) gjendja e fqinjësisë dhe iii) kërkesat higjieno-sanitare. Për orientimin merret kusht bazë orientimi drejt jugut në kufijtë deri 40 gradë të tij, si dhe 3 orë diell në periudhën 22 mars–22 shtator. Për gjendjen e fqinjësisë mbahet parasysh krijimi i hapësirave të nevojshme funksionale ndërmjet ndërtesave. Për kërkesat higjieno-sanitare përfshihen kërkesat për ndriçim, diellzim dhe ajrim. Distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Ndërsa sa i përket distancës së objektit shëndetësor–rehabilitues (nëse lejohet me raport të fizibilitetit) nga zhvillimet tjera duhet të respektohen dispozitat e përcaktuara për institucionet shëndetësore të nivelit dytësor me UA për NTPH. Përdërisa, distanca dhe organizimi i hapësirës së kampingut përcaktohet nga UA nr. 17/2010 për Klasifikimin dhe Kategorizimin e objekteve hoteliere.

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përfshijnë:

- Sipërfaqja ekzistuese gjelbëruese në kuadër të zonës duhet të ruhet;
- Peizazhi duhet të mbrojë karakterin dhe identitetin e vendbanimit rural, ashtu që si në objektet ashtu edhe hapësira publike duhet përdorur materialet dhe bimësia lokale. Nëse për shkaqe sigurie do të ndërmerren masa mbrojtëse nga erozioni dhe vërshimet, ato veprime duhet të kontribuojnë në peizazh. Sa i përket rrugëve ekzistuese dhe të planifikuara si dhe parkingjeve duhet të kenë brezat e gjelbra të cilat mbrojnë nga ndikimet negative në mjedis por edhe kontribuojnë në përmirësimin e peizazhit të vendbanimit.

Siguria nga zjarri: distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku ½ e H së ndërtesës më të lartë. Kjo distancë minimale zbatohet për të gjitha llojet e ndërtesave në të gjitha zonat specifike, nën zonat, zonat mbishtesore dhe sipërfaqet rregulluese. Duhet të merren parasysh kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri.

Ndriçimi natyror dhe artificial: përputhen Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për eficiencë të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike për këtë zonë, si: formësimi i objekteve në përgjithësi, duhet të jetë në përputhshmëri me strukturat e mjedisit përreth (rrethinës), në aspektin e parametrave elementar të formës dhe parimit të organizimit fizik të rrethinës. Gjatë formësimit të tyre duhet marrë parasysh: thjeshtësia e proporcioneve dhe formës, përshtatshmëria e formës së objektit me topografinë e terrenit, përshtatshmëria me kushtet klimatike dhe përdorimit të materialeve dhe vegjetacionit autokton, përkatësisht zbatimit të parimeve: unitetit, ambientalizimit dhe kontekstualitetit të hapësirës. Kushtet për formësimin arkitektonik dhe estetik duhet të përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kërkesa specifike për këtë zonë. Materializimi i objektit duhet të respektojë karakteristikat/atributet e lokalitetit/zonës, përmes përdorimit të elementeve autoktone si dhe të materialeve bashkëkohore, ngjyra e së cilës, tekstura dhe parametrat tjerë vizual afirmojnë kualitetet mjedisore të planifikimit të zonës. Kërkesat shitesë përfshijnë:

- Objektet të jenë të ndërtuara nga materiali i fortë dhe i qëndrueshëm. Materialet duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës dhe duhet t'i përshtaten strukturës dhe karakterit të objektit dhe të përdoren elemente ndërtimi që janë karakteristike për zonën. Objektet duhet ndërtohen nga druri dhe guri.
- Shtëpitë malore dhe kamp shtëpizat duhet të jenë tërësisht nga druri apo kombinim i drurit, gurit dhe/apo tullës.
- Dritaret dhe dyert duhet të jenë nga druri, PVC me ngjyrë druri. Nuk lejohet përdorimi i xhamave pasqyrë dhe me ngjyrë;
- Kulmi duhet të jetë dy ujqor apo më tepër, dhe nuk lejohet kulmi mastard. Mbulimi i kulmit duhet të jetë me material, strukturë dhe ngjyrë të tillë që nuk do të shqetësojnë natyrën dhe mjedisin përreth.
- Gardhi / rrethoja te të parcelat e zhvilluara mund të jetë gjelbërim i lartë, transparent, apo nga druri, kombinim i drurit me gurë dhe me lartësi maksimale 1.2m, gjelbërim i lartë, dhe nuk do të lejohet gardhi me materiale tjera.
- Streha kërkohet të jetë 0.9 m.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: para se të fillojë zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike.

Shtigjet:

- Shtegu për ecje duhet të jetë me gjerësi 0.90 cm';
- Shtegu për ciklizëm 1.20cm';

Shtigjet duhet të shtrohen me materiale të përshtatshme për ecje dhe ciklizëm si: zhavor i imët, kubëza të betonit dhe dheu.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Masat për mbrojtje të mjedisit: gjatë planifikimit të objekteve hoteliere dhe objektit shëndetësor duhet që sipas kërkesave të ligjeve dhe akteve nënligjore për mbrojtje të mjedisit të përcaktohen masat të cilat duhet t'i aplikoj zhvilluesi për shmangien apo zbutjen e ndikimeve në mjedis. Gjatë projektimit dhe kryerjes së punëve ndërtimore në këtë zonë (ndërtimi i ndërtesave, rrugëve, shtigjeve, infrastrukturës, etj.) duhet të respektohen kushtet dhe masat si në vijim:

- Vlerat natyrore si toka pyjore, dhe bujqesore, ujërrjedhat, etj duhet të mbrohen në mënyrë maksimale;
- Prerja e drunjëve është rreptësisht e ndaluar;
- Mbetjet e materialit të përdorur për ndërtim duhet të largohen, nuk lejohet krijimi i deponive;
- Të kontrollohet hedhja e mbeturinave;
- Zbatimi i masave për mbrojtjen nga zjarri;
- Të shenjohe vendet ku lejohet ndezja e zjarrit dhe të sigurohen pajisje përkatëse për shuarjen e zjarrit (enët me rërë dhe me ujë).

Bonuset e zonimit: /

Jonkonformitetet: /

Kushtet tjera: sipas UA nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste, objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe për ndërmjetësim në tregti duhet të respektohen kushtet si në vijim:

- panairët për prodhuesit afarist duhet të kenë objektet e mbyllura dhe të hapura të përshtatshme për organizimin e tyre si dhe të pajisen me pëlqim nga Kuvendi Komunal;
- panairët e hapur duhet të jenë të rrethuar me rrethojë të fortë;
- ekspozuesve të mallit duhet t'u sigurohet përdorimi i telefonit dhe faxit, e nëse kushtet e lejojnë edhe qasje në internet, kurse për qëndrimin e tyre duhet që në kuadër të hapësirës së panairit të sigurohet pjesë a caktuar e destinuar për punë afariste si dhe hapësirat ndihmëse për nevojat higjienë-sanitare.

Kampet – janë vende të hapura në të cilat vendosja behët në tenda , kamp-shtëpiza si dhe kamp – karrocëri. Kampet janë të karakterit sezonal dhe ofrojnë hapësirë të mjaftueshme brenda territorit të caktuar. Kampet përbëhen nga kamp shtëpizat të cilat do të organizohen në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA nr. 19/2013 për rregullimin dhe zhvillimin e sistemit të vlerësimit të akomodimit, e të cilat janë:


- kampi do të ketë maksimum 6 njësi (100.0m² për njësi);
- të ketë të gjitha hapësirat mbështetëse si toaletet, hapësira për gatim dhe larje të rrobave;
- të jetë në hapësira të cilat duhet ti plotësojnë kushtet minimale teknike;
- të jetë në mjedis të gjelbëruara, të pyllëzuara, në toka pa lagështirë;
- të jetë larg zonave industriale që ndotin ambientin dhe prishin qetësinë;
- të ketë qasje në rrugë automobilistike me qendrat e banuara;
- rruga për në kamp duhet të jetë e asfaltuar ose e shtruar mirë, me dy kalime min.5.5 – 6 m dhe detyrimisht e lidhur me rrugën kryesore;
- duhet të ketë barrierë dhe tra sigurie për parandalimin e automjeteve;
- mjediset brenda kampit detyrimisht të ndriçuara;

Shtëpia malore është një strukturë e vendosur në një mjedis natyror malor, ku mysafirëve u ofrohen shërbime akomodimi apo edhe ushqimit e pijeve, si dhe ju mundësohet përdorimi i një hapësire të veçantë ku mysafirët mund të pregatisin vet ushqimin të cilin e

konsumojnë. Përveç këtij funksioni themelor, ato gjithashtu kanë karakter shërbyes (strehim nga moti i keq, akomodim në rast nevoje, dhe kontrollim të hapësirës).

Shtëpitë malore duhet të projektohen dhe ndërtohen në bazë të dokumentacionit teknik me kushte ndërtimore të përcaktuara mirë sipas standardeve më të larta të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit.

Harta 29 Zonat turistike



5.9. Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit

Sipërfaqet ujore përfshijnë të gjithë ujërat e brendshëm sipërfaqësor (liqenet dhe akumulimet, ujë-rrjedhat e hapura) dhe ujërat nëntokësor (burimet akuifere inter-granular dhe karstik, burimet minerale, termale dhe termominerale).

Zona e mbrojtur sanitare e burimit nënkupton pjesën e përkufizuar të pellgut nëntokësor dhe sipërfaqësor të burimit, në të cilin kufizohen, kontrollohen dhe mbikëqyren aktivitetet njerëzore, përfshirë ndërtimin e objekteve të cilat mund të shkaktojnë ndryshimin e vetive bakteriologjike dhe/ose fiziko-kimike të ujit. Me qëllim të mbrojtjes së burimeve të ujit, përcaktohen tri zona të mbrojtura sanitare:

- Zona 1-Zona e kufizimit përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit dhe objekteve ujëmarrëse si dhe zonës së drejtpërdrejt të tyre nga çfarëdo dëmtimi, ndotje ose ndikim tjera të dëmshme të rastësishme ose të qëllimshme;
- Zona 2-Zona e kontrollimit përcaktohet me qëllim të parandalimit të kontaminimit dhe rrezikut të ndotjes nga mikroorganizmat ose materiet tjera të dëmshme për cilësinë e ujit;
- Zona e 3-Zona e mbikëqyrjes përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit nga ndotja me materie të rrezikshme ndotëse që vështirë zërthehen dhe për pasojë dëmtojnë në afat të gjatë shfrytëzimin e ujit të burimit.

5.9.1 Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit sipas PZHK-së dhe Strategjive nacionale

Në komunën e Podujevës, sipas PZHK, lumenjtë dhe shtretërit e tyre përbëjnë 1% të sipërfaqes së përgjithshme. *Sipërfaqet ujore* në Podujevë përfshijnë.

- Lumenjtë (Llap, Murgulla, Dumnica, Batllava, Kaqandollit)

- Burime të ujit natyror (Revuçë, Zhiti, Dobratin, Peran)
- Burime termo-minerale (Sallabajë dhe Shakovicë)
- Akumulimi Batllava

Me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve ujore nga ndotja prej mbeturinave inerte, ujërave të zeza dhe industriale, degradimi nga eksploatimi i inerteve (sidomos në lumin Llap dhe Murgull), erozioni dhe vërshimet, si dhe veprimet e pakontrolluara të njeriut, PZHK ka paraparë ndërmarrjen e një mori veprimesh dhe masash të cilat sipas raportit të vlerësimit të zbatimit të PZHK/U-së për periudhën 2016-2018 janë zbatuar vetëm pjesërisht. Me Strategjinë nacionale për ujërat 2017-2036, me qëllim të promovimit të shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit nga shfrytëzuesit tjerë, parashihet përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion. Megjithatë këto shfrytëzime sipas strategjisë duhet të planifikohen në atë mënyrë që të mos interferojnë me strategjinë dhe planet e veprimit për shfrytëzimin e ujërave për objektivat tjera.

5.9.2 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Në *pasurinë ujore publike* (qoftë ujë-rrjedhë apo akumulacion), sipas ligjit për ujëra, respektivisht UA për rregullimin e statusit të pasurisë ujore, si dhe për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve të ujë-rrjedhave dhe akumulacioneve janë dhënë në kutinë e mëposhtme. Gjerësia e brezit bregujor është 5 m' nga shtrati i ujë-rrjedhës sipas përcaktimit ligjor.

Kutia 3 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në pasurinë ujore publike

Shfrytëzimet e lejuara janë:

- ndërtimi i objekteve të infrastrukturës publike (urat, rrugët, hekurudhat);
- ndërtimi i objekteve për rregullimin dhe mbrojtjen e ujërave;
- ndërtimi i objekteve për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike të ujërave sipërfaqësor;
- ndërtimi i objekteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës;
- ndërtimi i objekteve për shfrytëzimin e ujërave-veprat ujëmarrëse dhe veprat e akumulimit;
- ndërtimi i objekteve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja;
- ndërtimi i objekteve për nevojat e organeve shtetërore, mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve dhe pronës nga fatkeqësitë natyrore dhe për kryerjen e detyrave të policisë;

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- pasuria ujore publike mund të shfrytëzohet për pushim dhe rekreacion në mënyrën që e përcakton komuna me pëlqim paraprak të Autoritetit të rajonit të Pellgjeve lumore, dhe me kushtin që në asnjë formë të mos rrezikohet funksioni i zonës për destinimin që ka;

Shfrytëzimet e ndaluara:

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve tjera përpos atyre të përkohshme tek shfrytëzimet e lejuara.
- Eksploatimi i rërës dhe zhavorrit (përfshirë edhe gurët, dherat dhe argjilën) në zonat e rëndësishme për regjimin ujor, qoftë të rezervave të përtërishme po ashtu edhe të atyre të jo-përtërishme. Përfshirë bën nxjerrja e rërës dhe zhavorrit për tu shfrytëzuar për mirëmbajtjen e ujë-rrjedhave dhe ndërtimin e objekteve rregulluese dhe mbrojtëse në ujë-rrjedha sipas përcaktimit ligjor;
- Ndërrimi i rrjedhjes së natyrshe të ujit sipërfaqësor apo nëntokësor përveç në rastet kur e lejon MMPH;
- Në brigjet e lumenjve ndalohet kryerja e aktiviteteve dhe veprimeve²⁷:
 - * ndërrimi i drejtimit të ujit në ujërrjedha dhe kanale;
 - * nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujërrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre;
 - * ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;
 - * kryerja e punëve në afërsi të ujërrjedhave, liqeneve, akumulimeve, tuneleve të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre, si dhe transportimin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme;
 - * Ndërrimi i drejtimit, nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, ndërtimi i objekteve kryhet vetëm nën kushtet, mënyrën dhe procedurat e caktuara sipas ligjit në fuqi.

Gjithashtu, aplikohen edhe dispozitat sipas UA Nr-04/2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujë-rrjedhave dhe Akumulacioneve

Në *Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujërave të pijshëm*, sipas ligjit për ujëra, respektivisht akteve nënligjore, përcaktimet për zonat e mbrojtura të burimeve ujore dhe UA.nr 08/2017 janë dhënë në kutinë si vijon:

Kutia 4 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në akumulacionin Batllava

Zonat e mbrojtura sanitare të akumulimit Batllava

²⁷ Ligji Nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës (neni 48)

Zona e mbrojtur sanitare e burimit ujq sipërfaqësor-akumulimi i Batllavës sipas vendimit të Qeverisë nr.17/127 të datës për 24.04.2013 përfshijnë:

- Zona e 1-rë e mbrojtur e cila përfshin liqenin, pendën, stacionin e pompave, impiantin për përpunimin e ujit, fundërruesit mbrojtës në grykën e rrjedhës dhe brezin mbrojtës përgjatë akumulimit me gjerësi 10m nga kufiri i nivelit më të lartë të ujit. Objekte të rrethuara në këtë zonë janë: objekti për marrjen e ujit, stacioni i pompave dhe objektet e reparteve të sigurimit;
- Zona e 2-të e mbrojtur përfshin brezin e akumulimit me gjerësi prej 200m përgjatë nga kufiri i jashtëm i zonës së 1-rë mbrojtëse. Derdhjet e ujë-rrjedhave në liqe mbrohen në gjatësi prej 3000m nga derdhja në drejtim të kundërt të rrjedhjes dhe në gjerësi 50m në të dy anët e ujë-rrjedhës;
- Zona e 3-të e mbrojtur shtrihet jashtë kufijve të zonës së II-të duke përfshirë tërë gjerësinë e pellgut natyror dhe derdhet në akumulim ose liqe. Në rast të një bartje artificiale të ujit (përmes kanalit ose gypit) nga pellgu i jashtëm në akumulim ose liqe, pellgu i jashtëm po ashtu do të cilësohet si zonë e III-të mbrojtëse.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në zonat e mbrojtura sanitare të akumulimit Batllava:

Shfrytëzimet e lejuara:

- Në zonën e 1-rë mbrojtëse ujore lejohen shfrytëzime, ndërtesa e instalime përmes së cilave bëhet marrja e ujit për përpunim dhe transportin e ujit deri në sistemin për furnizim (penda, stacioni i pompave, impianti për përpunimin e ujit, fundërruesit mbrojtës e ngjashme).
- Në zonën e 2-të mbrojtëse ujore lejohen shfrytëzime, ndërtesa e instalime me të cilat mbrohet burimi i ujit nga lëvizjet e ndotësve mikrobiologjik, kimik dhe llojeve të tjera të ndotësve;
- Në zonën e 3-të mbrojtëse ujore lejohen shfrytëzime, ndërtesa e instalime me të cilat sigurohet mbrojtja parandaluese për pellgun përkatës të burimit të ujit dhe që ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të mbrojtjes nga ndotja kimike dhe radioaktive.

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në zonën e 1-rë mbrojtëse sanitare shfrytëzime të ndaluara janë:

- Ndërtimi dhe kryerja e veprimtarive të ekonomive familjare dhe të tjera, përveç atyre të nevojshme për marrjen e ujit për përpunimin dhe transportin e ujit deri në sistemin për furnizim;
- Ndërtimi i objekteve për turizëm ose rekreacion dhe objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit;
- Përdorimi i plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura nga objektet, repartet dhe nga pajisjet për pastrimin e ujit;
- Ndalimi i të gjitha sporteve në ujë, shfrytëzimi i të gjitha llojeve të mjeteve lundruese dhe larjet
- Kultivimi komercial i peshqve, përveç rritjes biologjike dhe ripërtëritjes së tyre;
- Dhënia ujë bagëtive;
- Qarkullimi publik i automjeteve dhe këmbësorëve;
- Kultivimi i produkteve bujqësore, përveç në rastet e përdorimit të kufizuar të plehrave dhe pesticideve lehtë të zbërthyeshme;
- Kultivimi i produkteve shtazore, përveç për nevojat e ekonomive familjare;
- Ndërtimi i të gjitha reparteve për prodhimin, deponimin dhe transportin e materieve të rrezikshme;
- Ndërtimi i varrezave apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- Ndërtimi i autorrugëve dhe rrugëve magjistrale;
- Ndërtimi i hekurudhave;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit;
- Deponimi i mbeturinave
- Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajtuara
- Çdo deponim i naftës dhe derivateve të saj
- Ndërtimi i objekteve për deponim, përdorim, përpunim dhe furnizim me materie të rrezikshme
- Ndërtimi i rrugëve pa sistem kontrollues të largimit dhe pastrimit të ujërave atmosferik;
- Eksploatimi i resurseve minerale;
- Ndërtimi i gyp-sjellësve për materie të lëngëta të cilat janë të rrezikshme për cilësinë e ujit;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit.

Në zonën e 2-të mbrojtëse sanitare shfrytëzime të ndaluara janë:

- Kultivimi i produkteve bujqësore, përveç në rastet e përdorimit të kufizuar të plehrave dhe pesticideve lehtë të zbërthyeshme sipas ligjit, Direktivës 91/676/EEC dhe kodit për praktika të mira bujqësore;
- Kultivimi i produkteve shtazore, përveç për nevojat e ekonomive familjare sipas ligjit, Direktivës 91/676/EEC dhe kodit për praktika të mira bujqësore;
- Ndërtimi i objekteve për turizëm ose rekreacion dhe objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit;

- Ndërtimi i të gjitha reparteve për prodhimin, deponimin dhe transportin e materieve të rrezikshme;
- Ndërtimi i varrezave apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- Ndërtimi i auto rrugëve dhe rrugëve magjistrale;
- Ndërtimi i hekurudhave;
- Deponimi i mbeturinave;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa-trajtuara;
- Çdo deponim i naftës dhe derivateve të saj;
- Ndërtimi i objekteve për deponim, përdorim, përpunim dhe furnizim me materie të rrezikshme;
- Ndërtimi i rrugëve pa sistem kontrollues të largimit dhe pastrimit të ujërave atmosferik;
- Eksploatimi i resurseve minerale;
- Ndërtimi i gypsjellësve për materie të lëngëta të cilat janë të rrezikshme për cilësinë e ujit;

Në zonën e 3-të mbrojtëse ujore shfrytëzime të ndaluara janë:

- Zhvillimi i aktiviteteve bujqësore që nuk janë harmonizuar sipas ligjit, Direktivës 91/676/EEC dhe kodit për praktika të mira bujqësore;
- Deponimi i mbeturinave;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajtuara;
- Çdo deponim i naftës dhe derivateve të saj;
- Ndërtimi i objekteve për deponim, përdorim, përpunim dhe furnizim me materie të rrezikshme;
- Ndërtimi i rrugëve pa sistem kontrollues të largimit dhe pastrimit të ujërave atmosferik;
- Eksploatimi i resurseve minerale;
- Ndërtimi i gyp-sjellësve për materie të lëngëta të cilat janë të rrezikshme për cilësinë e ujit.

Kutia 5 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në burimet ujore ekzistuese: Peran, Revuq, Dobratin dhe burimin e planifikuar në Zhiti dhe tjera që mund të planifikohen në të ardhmen (potenciale të mundshme në Sfeqël, Surkish, Murgull dhe Llapashticë)

Zonat e mbrojtura të burimeve nëntokësore në akuifer karstik: Peran, Revuq, Dobratin, Zhiti

Për burimet ujore ekzistuese të cilat shfrytëzohen për furnizimin e vendbanimeve me ujë: Revuq, Dobratin, Peran dhe për burimin e planifikuar në Zhiti dhe të tjera burime që mund të planifikohen në të ardhmen, sipas HZK zonat e mbrojtura sanitare kanë këtë përcaktim:

Burimi ujq Peran:

- Zona e 1-rë e mbrojtur sanitare apo zona e kufizimit zë një sipërfaqe prej 6 ha;
- Zona e 2-të e mbrojtur sanitare apo zona e kontrollimit
- Zona e 3 e mbrojtur sanitare apo zona e regjimit të lehtë të mbrojtjes dhe mbikëqyrjes

Burimet ujore Revuq dhe Dobratin

- Zona e 1-rë e mbrojtur sanitare apo zona e kufizimit- 20 m e larguar nga vepra ujëmarrëse. Në kuadër të kësaj zone përfshihen të gjitha objektet përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit të ujit. Në rastet kur nuk mund të sigurohet largësia prej 20m, kjo duhet të jetë së paku 10m nga të gjitha objektet ujëmarrëse me kusht që të vërtetohet se burimi nuk rrezikohet;
- Zona e 2-të e mbrojtur sanitare apo zona e kontrollimit- jo më afër se 500m' nga vepra ujëmarrëse;
- Zona e 3 e mbrojtur sanitare apo zona e regjimit të lehtë të mbrojtjes dhe mbikëqyrjes- së paku 1000m' larg veprës ujëmarrëse në drejtim të rrjedhjes së ujit.

Burimin ujq në Zhiti dhe burime të tjera që planifikohen në të ardhmen

- Zona e 1-rë e mbrojtur sanitare apo zona e kufizimit- 20 m e larguar nga vepra ujëmarrëse. Në kuadër të kësaj zone përfshihen të gjitha objektet përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit të ujit. Në rastet kur nuk mund të sigurohet largësia prej 20m, kjo duhet të jetë së paku 10m nga të gjitha objektet ujëmarrëse me kusht që të vërtetohet se burimi nuk rrezikohet;
- Zona e 2-të e mbrojtur sanitare apo zona e kontrollimit- jo më afër se 500m' nga vepra ujëmarrëse;
- Zona e 3 e mbrojtur sanitare apo zona e regjimit të lehtë të mbrojtjes dhe mbikëqyrjes- së paku 1000m' larg veprës ujëmarrëse në drejtim të rrjedhjes së ujit.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara në burimet ujore të lartpërmendura:

Shfrytëzimet e lejuara:

Në zonën e 1-rë mbrojtëse ujore lejohen shfrytëzime të lejuara janë:

- Të gjitha objektet përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit të ujit;
- Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund të rrezikojnë cilësinë e ujit;
- Punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi, me ç'rast me zgjidhjet e laboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim;

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në zonën e I-rë mbrojtëse sanitare shfrytëzime të ndaluara janë:

- a) Kryerja e të gjitha llojeve të punimeve dhe aktiviteteve që nuk janë direkt të lidhura me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.

Në zonën e II-të mbrojtëse sanitare shfrytëzime të ndaluara janë:

- a) Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara të kanalizimit;
- b) Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (p.sh.industri kimike, repartë të përpunimit të metaleve, industri të lëkurave etj);
- c) Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
- d) Përpunimi, deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra, materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
- e) Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
- f) Ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve ose hapësira tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre ne recipient;
- g) Kryerja e shpimeve hulumtuese për nagtë, gas nëntokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
- h) Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve;
- i) Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
- j) Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit si në kuptim sasior apo cilësor;
- k) Përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafshëve;
- l) Përdorimi i pesticideve, herbicideve dhe insekticideve;
- m) Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
- n) Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
- o) Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;
- p) Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie, kimike, karburanteve, vajrave dhe materie tjera të rrezikshme;
- q) Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve dhe rrezikshme;
- r) Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
- s) Aktivitete tjera që mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit;

Në zonën e III-të mbrojtëse sanitare shfrytëzimet e ndaluara janë aktivitetet prej a) deri në j) të cekura nga zona II.

Kushtet zhvillimore

Kushtet zhvillimore sa i përket dimensionit të parcelës, lartësisë së ndërtesave, intensitetit të zhvillimit ejt. për ndërtesat dhe instalimet në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara në këto zona varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoret dhe duhet të jenë në përputhje me standardet e lejuara ndërkombëtare dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Rregullat për zhvillimin e peisazhit dhe shiritave mbrojtës të gjelbërimit përputhen me Kushtet zhvillimore të përgjithshme dhe kërkesave për zhvillim të përshkruara në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara apo ndaluara.

Kërkesat për *zvogëlimin e zhurmës, parkingjet, siguria nga zjarri etj* përputhen me Kushtet zhvillimore të përgjithshme.

Masat e përgjithshme mbrojtëse si dhe masat e mbrojtjes për secilën zonë në veçanti duhet të jenë në përputhje me ato të dhëna në vendimin e Qeverisë për caktimin e zonave të mbrojtura për akumulimin Batllava kurse për burimet tjera ujore në përputhje me ligjin për ujërat dhe akteve ligjore përcjellëse në fuqi.

Kutia 6 Masat mbrojtëse në bazë të Vendimit me nr. 17/127, të burimit ujq sipërfaqësor – Akumulimi i Batllavës

Masat e përgjithshme mbrojtëse te burimit ujq sipërfaqësor – Akumulimi i Batllavës

1. Trajtimi i ujërave të ndotura, para shkarkimit në ujë rrjedhat që furnizojnë akumulimin (lumi i Ballabanit, Toriqicë, Kushtericë) si masë afatshkurtër me anë të gropave thithëse;
2. Ndërtimi i sistemit adekuat për trajtimin e ujërave të ndotura si masë afatgjate;
3. Për aktivitete bujqësore të zbatohen dispozitat sipas ligjit Direktivës 91/676/EEC dhe kodit për praktika të mira bujqësore;
4. Vendosja e sistemit të menaxhimit të mbeturinave (zona e I-rë, II-të, III-të);
5. Vendosja e një sistemi efikas të monitorimit;
6. Investitori nuk mund të marrë leje për ndërtim apo nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti të planifikuar, pa u pajisur, sipas ligjit, me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja;
7. MMPH-ja lëshon vërtetim për objektet që nuk i nënshtrohen procedurës administrative për t'u pajisur, sipas ligjit, me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor;
8. Sipas ligjit të bëhet legalizimi i objektivave ekzistuese të ndërtuara pa leje;

9. Për zonat e rrezikuara, hartimi dhe zbatimi programit aksional sipas Direktivës 91/676/EEC;
10. Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e masave të mbrojtura nga MMPH-ja;
11. KUR "Prishtina" në bazë të monitorimit të cilësisë së cilësisë së ujit, mundet menjëherë të ndalojë shfrytëzimin dhe përdorimin e zonave rekreative me kërkesë të MMPH-së;
12. Për cdo vit kalendarik dhe para stinës së verës, për lejimin dhe përcaktimin e zonave rekreative rreth akumulimit të Batllavës, organi kompetent i KK të Podujevës, duhet të aplikojë për autorizim mjedisor në MMPH;
13. Për arritjen e menaxhimit efikas të zonave të mbrojtura, rekomandojmë që para procesit të privatizimit, pronësia rreth akumulimit të Batllavës të kalojë nga KEK-u në favor të KRU "RPshina";
14. Vendosja e tabelave në kufirin e zonës së I-rë dhe të II-të;

Masat mbrojtëse në zonën e I-rë dhe II-të të burimit uhor sipërfaqësor – Akumulimi i Batllavës

1. Procedurës administrative për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor, sipas nenit 7, të Ligjit Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 03/214), ose me Autorizim Mjedisor nga MMPHJ-a, sipas nenit 33, të Ligjit Për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr.03/L-025), i nënshtrohen:
 - 1.1 Ndërtimi i objekteve të reja sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit për Ndërtim, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 1.2 Ndërtimi pa lejeqë nënkupton objektin e ndërtuar në kundërshtim me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit për Ndërtim dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 1.3 Investimet dhe zhvillimi i projekteve me potencial të ndotjes së ujit;
 - 1.4 Objektet afariste të cilat nuk kanë leje për punë;
 - 1.5 Ndalimi i shkarkimit të ujërave të ndotura për objektet ekzistuese në zonën e II-të. Testimi i gropave septike sipas ligjit. Raportimi mujor në MMPH, për zbrazjet e gropave septike.
2. Për aktivitetet bujqësore, të zbatohen dispozitat sipas ligjit, Direktivës 91/676/EFC, dhe kodit për praktika të mira bujqësore.
3. Rikonstruimi i rrugëve ekzistuese me sistem kontrollues të largimit dhe pastrimit të ujërave atmosferike;

Masat mbrojtëse në zonën e III-të të burimit uhor sipërfaqësor – Akumulimi i Batllavës

1. Aplikimi i procedurës administrative për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor, sipas nenit 14.
2. Për aktivitetet bujqësore, të zbatohen dispozitat sipas ligjit, Direktivës 91/676/EEC, dhe kodit për praktika të mira mjedisore.
3. Ndalimi i shkarkimit të ujërave të ndotura për objektet ekzistuese. Testimi i gropave septike sipas ligjit. Raportimi mujor në MMPH, për zbrazjet e gropave septike.
4. Rikonstruimi i rrugëve ekzistuese rreth akumulimit me sistemin kontrollues të largimit dhe pastrimit të ujërave atmosferike.

Jonkoformiteti: në rast se në një zonë të mbrojtur sanitare ekzistojnë objekte të ndërtuara në pajtim me legjislacionin e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, ndërtimi i të cilave është i ndaluar me aktet nënligjore të ligjit për ujëra, respektivisht nëse në zonën e mbrojtur sanitare zhvillohen veprimtari të cilat janë në kundërshtim me aktet respektive, MMPHI duhet të vendos një regjim të mbikëqyrjeje me qëllim të konstatimit të ndikimit të ndikimit të këtyre objekteve dhe veprimtarive në burim. Në rast se në një zonë të mbrojtur sanitare ekzistojnë objekte të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, ndërtimi i të cilave respektivisht zhvillimi veprimtarive të tyre është i ndaluar me dispozitat e akteve nënligjore të ligjit për ujëra, këto objekte nuk do të legalizohen nga MMPHI respektivisht komuna në procesin e legalizimit dhe për to do të iniciohet procedura e rrënimit.

Shih hartën 19 e përbashkët me zonat e mbrojtura të natyrës

5.10. Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës

Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës përfshijnë:

- Rezervatet strikte të natyrës;
- Parqet kombëtare;
- Zonat e veçanta të mbrojtura të natyrës;
- Zonat e veçanta të ruajtura;
- Parqet natyrore;
- Monumentet e natyrës;
- Peizazhet e mbrojtura;
- Monumentet e arkitekturës së parkut.

5.10.1 Sipërfaqet me vlera të mbrojtura të natyrës sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera

Lista e monumenteve të natyrës në komunën e Podujevës, duke referuar regjistrin të MMPHI-së/Institutit për mbrojtje të natyrës është sikur në tabelën vijuese.

Tabela 19 Vlerat natyrore

	Monumente me karakter botanik	Sipërfaqja mbrojtur e	Zona buferike e përfshirë në kuadër të sipërfaqes	Pronësia
1	Trungu i Qarrit në Pollatë	~5 ari		
2	Trungu i shpandhit në Dyz	5 ari	10 m rreth projekcionit të kurorës	Private
3	Trungu i dushkut në Llapashticë të Epërme	5 ari		Private
4	Trungjet e dushkut në Llapashticë të Epërme	10 ari		Shoqërore
5	Trungu i plepit në Murgull	5 ari		Shoqërore
6	Trungu i plepit në Orllan	5 ari		Komunës
	Monumente me karakter hidrologjik			
1	Burimi i ujit termo-mineral në Shakovicë	1ha 40 ari e 54m		
2	Burimi i ujit termo-mineral në Sallabajë	31 ari e 47m		
	Monumente me karakter botanik dhe hidrologjik			
1	Trungu i ahut dhe vrella në Dobratin	10 ari	10 m rreth projekcionit të kurorës dhe burimit të ujit	Private

5.10.2 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Monumentet me karakter botanik

Shfrytëzimet e lejuara:

Në sipërfaqen e monumentit lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të monumentit nën kushtet të cilat i përcakton autoriteti përgjegjës sipas projektit për sanimin e gjendjes;
- Punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit;
- Shfrytëzimi i ujit (nën mbikëqyrjen e organeve kompetente) duke mos penguar rrjedhën e tij.

Në zonën buferike lejohen shfrytëzime për qëllime të prezantimit me kusht që nuk e rrezikojnë monumentin.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: Lejohen veprimtari që kanë për qëllim hulumtimin, mbledhjen e të dhënave profesionale si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Mjetet për mbrojtjen e bimëve dhe plehrat minerale mund të përdoren në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në sipërfaqen e monumentit ndalohe:

- Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur;
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të monumentit të natyrës.

Në zonën buferike të monumentit ndalohe:

- Rrjedhja (lëshimi) i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
- Ndërrimi i kulturës;
- Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së monumentit.

Monumentet me karakter hidrologjik

Shfrytëzimet e lejuara: Në sipërfaqen e monumentit lejohen objekte dhe stabilimente që janë në funksion të mbrojtjes së tij.

Në zonën buferike lejohen ato ndërhyrje dhe punë të cilat nuk i dëmtojnë dhe nuk i ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është shpallur e mbrojtur.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: Lejohen veprimtari që kanë për qëllim hulumtimin, mbledhjen e të dhënave profesionale si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Mjetet për mbrojtjen e bimëve dhe plehrat minerale mund të përdoren në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij. Ndalohen apo kufizohen aktivitetet në vijim:

- ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës;
- ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve;
- mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve;
- deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura;
- ndryshimi i regjimit të ujërave;
- evitimi i përmbytjeve, përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike;
- kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës;
- guetia, peshkimi, veprimtaritë rekreative- sportive;
- vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera;
- aktivitetet tjera të cilat mund të rrezikuar vlerën e mbrojtur të natyrës.


Në zonat buferike ndalohet kryerja e ushtrimeve dhe aktiviteteve të tjera ushtarake të cilat mund t'i rrezikojnë vlerat e natyrës.

Kushtet zhvillimore


Kushtet zhvillimore për ndërtesat dhe instalimet në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara në këto zona (në këtë rast vlen për monumentet e natyrës me karakter hidrologjik), si dhe rregullat për zhvillimin e peisazhit dhe shiritave mbrojtës të gjelbërimit, siguria nga zjarri etj përputhen me kushtet zhvillimore të përgjithshme.

Masat e përgjithshme mbrojtëse si dhe masat e mbrojtjes për monumentin e natyrës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe akteve ligjore përcjellëse.

Harta 30 Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës si dhe sipërfaqet ujore me zonat e mbrojtura ujore



Harta 31 Zonat e mbrojtura të akumulacionit të Batllavës



5.11 Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore

Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore janë pjesë të territorit të cilat përmbajnë karakteristikat dhe vlera të posaçme historike, artistike, trashëgimisë kulturore dhe mjedisore urbane. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përcaktojnë mbrojtjen afat-gjate dhe konservimin e një zonë gjeografike me karakteristika të veçanta të trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, peizazhet kulturore me potencial të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përfshijnë perimetrin e vend-shtirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojtje dhe zonës mbrojtëse të tij në radius prej 50 m (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 m për trashëgiminë arkeologjike nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet në pajtueshmëri me planin e Institucionit kompetent. Në momentin që ndonjë vlerë e trashëgimisë kulturore hyn në listën për mbrojtje të përkohshme apo të përhershme (shih në ligj procedurat për shpalljen e vlerës në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme), ajo regjistrohet në Kadastër.

5.11.1 Sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera

PZHK i referohet mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore për të cilat propozon që komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) duhet të përgatis planin menaxhues me qëllim të mbrojtjes së monumentit nga çfarëdo zhvillimi që mund të ketë efekte negative tek ato. PZHK propozon përpilimin e katalogut të hartës për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për nevojat e turizmit, dhe vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK. Sipas PZHK në komunë ekzistojnë edhe shumë vlera të trashëgimisë të cilat kanë mbetur jashtë përfshirjes në listën për mbrojtje nga MKRS. Sipas raportit të vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, brenda dy viteve të zbatimit të planit, është punuar pjesërisht në veprimin vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK-së, kurse nuk ka progres të shënuar për hartimin e planit menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve natyrore dhe përpilimi i katalogut turistik për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Pavarësisht këtyre, vlerësimi ka vënë në pah realizmin e të tjera projekteve që nuk kanë qenë të përfshira me plan si: mbledhjen

e eksponateve në terren, inicimin e trashëgimisë shpirtërore, ekspozita të prezantimit të etno-trashëgimisë dhe fushata sensibilizimi për grumbullimin e eksponateve të trashëgimisë.

Në vijim është dhënë tabela që prezanton vlerat sipas Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e vitit 2019 dhe ato të përcaktuara sipas PZHK. Me HZK janë lokalizuar këto vlera dhe për to është përcaktuar zona mbrojtëse sipas përcaktimeve të ligjit respektiv.

Tabela 28 Lista e trashëgimisë kulturore

KATEGORIA: TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE					
A	Nënkategoria: Monument/Ansambël	Periudha	Vend-ndodhja	PZHK	Lista 2018
1	Lokalitet Arkeologjik	Antikë	Sallabajë		
2	Gërmadhat e kishës	Mesjetë	Sallabajë		
B	Nënkategoria: Lokalitet arkeologjik/rezevat				
1	Lokalitet arkeologjik-Maja e Llapit ('vërhlab')	Antikitët i vonë	Bellasicë	√	√
2	Varret e vjetra, gjurmët e kishës	Antikitët i vonë, Mesjetë	Pollatë	√	√
3	Lokaliteti arkeologjik- Çuka e Brainës	Antikitët i vonë, Mesjetë	Brainë	√	√
4	Gërmadhat e Kishës 'Perandori Konstantin dhe Perandoreshës Jelena'	Mesjetë	Orllan	√	√
5	Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjel Mehillit	Mesjetë	Rakinicë	√	√
6	Lokaliteti arkeologjik Vindenis 'Polanicë'	Romake, antikitet i vonë	Gllamnik	√	√
7	Gërmadhat e kishës së Marisë së Zjarrit	Mesjetë	Batllavë	√	√
8	Lokaliteti arkeologjik-Kalaja (qyteaza)	Antikitët i vonë	Lupç i Poshtëm	√	√
9	Gërmadhat e kishës së Shën Arkangjelit	Mesjetë	Bradash	√	√
10	Lokaliteti neolitik 'Gumnishtë'	Parahistori	Surkish	√	√
11	Kalaja e Ballocit	Antikitët i vonë	Balloc	√	√
II. KATEGORIA: TRASHËGIMIA ARKITEKTURORE					
A	Nënkategoria: Monument/Ansambël				
1	Kisha e Shën Andrejës	shek.XIX	Qytet		√
2	Shtëpia e Kadri Metehisë	shek.XVII	Metehi		√
3	Shtëpi banimi	1935	Qytet		√
4	Kulla e Xhemail Haxhiut	shek.XIX	Herticë		√
5	Shtëpi banim- Avdullah Avdullahu	shek.XIX	Llaushë e ulët		√
6	Kishëz	shek.XIX	Rakinicë		√
7	Xhamia e brainës	shek.XVIII	Brainë		√
8	Mulliri Metehi	shek.XX	Metehi		√
9	Pojata e Avdyl Shabani	shek.XX	Metehi		√
10	Flladniku i Avdyl Shabani	shek.XX	Metehi		√
11	Xhamia e Dumnicës	shek.XIX	Dumnicë		√
12	Kulla e Nazif Muratit	shek.XIX	Popovë		√
13	Mulliri i Demë Ahmetit	shek.XIX	Reçicë		√
14	Shtëpi banimi- Sabit Hamiti	shek.XX	Reçicë		√
15	Kulla e Demë Ahmetit	shek.XX	Reçicë		√
16	Shtëpi banimi-Musa Hamiti	shek.XIX	Reçicë		√
17	Shtëpi banimi-Hasan Ramadani	shek.XX	Shajkoc		√
18	Mulliri	shek.XIX	Majac		√
19	Koshi i Basri Rrahmanit		Lladoc		√
20	Ndërtesa e kuvendit Komunal	Shek.XX	Qytet		√
21	Mulliri i lagjes Azemi	Shek.XIX	Pollatë		
TË PROPOZUARA NGA KOMUNA PËR MBROJTJE					
20	Teqja në Herticë				
21	Xhamia në Herticë				
B	Nënkategoria: Fushat e konservimit arkitekturor				
1	Shishe	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
2	Kupë	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
3	Vazo	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
4	Sarkofag	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
5	Broke	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		√
6	Byzylyk	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		√
7	Broke	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		√

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Trashëgimia arkeologjike

Shfrytëzimet e lejuara:

- Aktivitete për konservimin dhe mbrojtjen e këtyre vlerave e lejuar nga organi kompetent;
- Revitalizimi në funksion të zhvillimit turistik e lejuar nga organi kompetent;

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës të cilat mund të zhvillohen në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin:

- Objekte apo struktura përcjellëse që e plotësojnë funksionin e monumentit gjithnjë në harmoni me arkitekturën origjinale dhe me leje nga organi kompetent;
- Kiosqe për informim apo tabela informuese që ofrojnë të dhëna të rëndësishme për monumentin.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- Ndërhyrja në tokë brenda zonës së mbrojtur për veprimtaritë bujqësore me leje nga Institucioni kompetent;
- Zhvillimi i aktiviteteve turistike me qëllim promovimin e monumentit (vizita në monumente);
- Ndërtimi i strukturave për shitje suveniresh me leje nga Institucioni kompetent;
- Infrastrukturë rrugore lokale dhe shërbimeve publike të nevojshme për funksionimin e zonës me lejen e organit kompetent;
- Muzika me zë më të lartë se 70 db, përveç gjatë ngjarjeve/organizimeve të natyrës publike, për të cilat merret paraprakisht leja nga institucioni kompetent.

Shfrytëzimet e përkohshme:

- shërbim tregtar me pakicë (pikat e shitjes së prodhimeve për nevoja të zhvillimit të turizmit- suvenire, produkte artizanale, produkte të vendit);
- tenda për panairë apo manifestime të caktuara për ekspozimin e materialeve arkeologjike, etnografike, ikonografike etj;
- vendosja e karrigeve dhe tavolinave për nevoja të bizneseve të vogla në rastet e manifestimeve të ndryshme.

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në sipërfaqet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore arkeologjike ndalohet:

- ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje;
- ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale;
- zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë;
- instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjital;
- çdo veprimtari që shkakton dëmtim të ndonjë vlere të trashëgimisë arkeologjike pa lejen e shkruar nga Institucioni kompetent;
- vendosja e kontejnerëve për mbeturina para dhe në afërsi të monumentit;
- vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve që pengojnë vizurat në monument.

Trashëgimia arkitekturore

Shfrytëzimet e lejuara:

- Aktivitete për konservimin dhe mbrojtjen e këtyre vlerave me lejen e organit kompetent;
- Revitalizimi në funksion të zhvillimit turistik m lejen e organit kompetent;
- Çdo punë për modifikim ose demolim i monumentit arkitektural ose ndonjë veprim konservues ose restaurues që mund të ndikojë në vlerat atribuese të monumentit me pëlqimin nga organit kompetent;
- Çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për mbulesën e jashtme të ndërtesave të përfshira në asamble ose zona konservuese arkitekturale me pëlqimin nga organi kompetent;
- Riparimi urgjent ose emergjent i monumentit ose ndërtesave brenda asambleve që janë në një gjendje të keqe të riparimit ose janë në rrezik të dëmtimit sipas procedurave të parapara ligjore.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës të cilat mund të zhvillohen në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin:

- Objekte apo struktura përcjellëse që e plotësojnë funksionin e monumentit gjithnjë në harmoni me arkitekturën origjinale dhe me leje nga organi kompetent;
- Kiosqe për informim apo tabela informatore që ofrojnë të dhëna të rëndësishme për monumentin;
- Hidranti I ujit për mbrojtje nga zjarri;

- Rrugë për qasje në kuadër të asamblesë së monumenteve e rëndësishme për funksionimin e zonës dhe me leje paraprake nga organi kompetent;
- Shërbime publike të furnizimit me ujë, energji elektrike, kanalizimi të nevojshme për funksionimin e monumentit me leje nga organi kompetent.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:

- Vendosja e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e asambleve ose brenda hapësirave konservuese arkitekturale me leje të shkruar nga organi kompetent;
- Përdorimi me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor i monumentit (zhvillimi i aktiviteteve turistike me qëllim promovimin e monumentit me autorizim nga organi kompetent:
- Ndërhyrja në tokë brenda zonës së mbrojtur për veprimtaritë bujqësore me leje nga organi kompetent;
- Ndërtimi i strukturave për shitje suveniresh me leje nga organi kompetent;
- Infrastruktura rrugore lokale dhe shërbimeve publike të nevojshme për funksionimin e zonës me lejen e organit kompetent.

Shfrytëzimet e përkohshme:

- Shërbim tregtar me pakicë (pikat e shitjes së prodhimeve për nevoja të zhvillimit të turizmit- suvenire, produkte artizanale, produkte të vendit);
- Tenda për panairë apo manifestime të caktuara për promovimin e monumenteve arkitekturore, etnografike, ikonografike etj;
- Vendosja e karrigeve dhe tavolinave për nevoja të bizneseve të vogla në rastet e manifestimeve të ndryshme promovuese të trashëgimisë.

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në sipërfaqet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë arkitekturore ndalohet:

- ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje;
- ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale;
- zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë;
- instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjital;
- çdo veprimtari që shkakton dëmtim të ndonjë vlere të trashëgimisë arkitekturore pa leje nga organi kompetent;
- Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjeshme ose komplete e ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturore nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme;
- vendosja e kontejnerëve dhe shportave tjera për mbeturina para dhe në afërsi të monumentit;
- vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve që pengojnë vizurat në monument;

Kushtet zhvillimore

Masat e përgjithshme mbrojtëse si dhe masat e mbrojtjes për monumentin e trashëgimisë kulturore duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore, akteve ligjore përcjellëse si dhe rregulloreve respektive. Po ashtu dhënia e lejes për ndërtim në objektet nën mbrojtje të përkohshme apo përhershme, mënyra e përdorimit me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor, çështjet e kompensimit, financimit, shitjes, të drejtave pronësore të trashëgimisë kulturore nën kontrollin e shtetit apo pronësi apo trashëgimisë kulturore në pronësi private janë të rregulluara me ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë.

Kushtet tjera përfshijnë:

Dimensionet e parcelës: /

Lartësia e ndërtesës (H): Në rast renovimi, rikonstruktimi apo revitalizimi, lartësia origjinale e monumentit duhet të mbetet e njëjtë.

Intensiteti: Në rast renovimi, rikonstruktimi apo revitalizimi, indeksi i shfrytëzueshmëria së parcelës së monumentit dhe indeksi i ndërtimit duhet të mbetet e njëjtë. Në qoftë se ndryshimi është i domosdoshëm kjo duhet të bëhet me leje nga organi kompetent.

Vijat: /

Qasje në parcelën e monumentit: Në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushte shtesë për qasjen dhe mënyrën e hyrjes në parcelë përfshijnë:

- Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje ndaj një rruge publike ose private në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me anë të krijimit të një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Gjerësia e hyrjes private në parcelë e cila nuk ka qasje direkte nga rruga publike nuk mund të jetë më e vogël se 2,5m;
- Shfrytëzimet apo strukturat dytësore, ato të lejuara të veçanta apo me shfrytëzim të përkohshëm nuk duhet të cenojnë qasjen në monument apo në parcelat kadastrale fqinje;

Vendosja e objektit në parcelë: Vendosja e objekteve apo strukturave për shfrytëzim dytësor, atyre për shfrytëzim të lejuar të veçantë apo përkohshëm duhet të bëhet në harmoni dhe përputhje me masat e parapara për mbrojtjen e monumentit të përcaktuara me ligjin për trashëgimi apo të përcaktuara nga organi kompetent;

Distancat: Distancat nga monumenti kanë përcaktim ligjor. Perimetri mbrojtës përfshin distancën prej monumentit arkitekturor deri tek vija e parcelës por në raste specifike mund të jetë edhe jashtë parcelës (përcaktohet nga institucioni kompetent). Zona mbrojtëse tek lokalitetet arkeologjik përfshin distancën prej parcelës dhe mvarësisht nga rastet mund të jetë 50m, 100m dhe mund të shkojë deri 150m (përcaktohet nga institucioni kompetent).

RREGULLAT TJERA PËR ZHVILLIM:

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave mbrojtës të gjelbërimit: Përputhen me kushtet zhvillimore të përgjithshme dhe në veçanti me kërkesat ligjore të ligjit për trashëgiminë kulturore.

Kushtet e veçanta përfshijnë:

- Sipërfaqja ekzistuese gjelbëruese në kuadër të zonës së monumentit duhet të ruhet;

- Në rast renovimi, rikonstruktimi apo revitalizimi, gjelbërimi ekzistues nuk duhet të pritet, dëmtohet. Në raste të veçanta kur me rikonstruim parashihet ndonjë adaptim i hapësirave apo kur ndërtohen struktura dytësore të cilat mund të dëmtojnë gjelbërimin ekzistues, duhet që gjelbërimi të zhvendoset duke e përfshirë në gjelbërimin e zonës;

- Peisazhi duhet të reflektojë dhe mbrojë karakterin si të monumentit ashtu edhe të mjedisit përreth duhet përdorur materialet dhe bimësia lokale. Nëse për shkaqe sigurie do të ndërmerren masa mbrojtëse nga erozioni dhe vërshimet, ato veprime duhet të kontribuojnë në peisazh.

Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe dispozitat e ligjeve respektive. Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, duke shtuar: Për shmangjen, parandalimin apo zvogëlimin e efekteve të dëmshme që vijnë si rezultat i ekspozimit të zhurmës sidomos nga trafiku HZK ka përcaktuar si vijon:

Kërkesat për zhurmë: me rastin e renovimit, rikonstruktimit apo revitalizimit të monumentit duhet të planifikohen, dizajnohen dhe të operojnë në mënyrë që të mos prodhojnë zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat për efizienz të energjisë: Ndërmarrja e masave për ngritjen e efijencës së energjisë në monumentet arkitekturor bëhet në përputhje me ligjet respektive apo me leje nga organi kompetent;

Formësimi arkitektonik dhe estetik: Do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike për zonën:

- Në rast të renovimit, rikonstruktimit apo revitalizimit të monumenteve, elementet e formësimit arkitektonik (Hapjet (dritare, dyer), ngjyra e fasadës së monumentit, ngjyra/materiali i hapjeve, materialet mvëshëse, vitrinat në përdhese, muret rrethuese duhet të ruajnë origjinalitetin e tyre;

- Në rast të ndërtimit të strukturave dytësore apo shfrytëzimeve të lejuara të veçanta materializimi i objektit duhet të jetë në përputhje me veçoritë e monumentit;

Signuria nga zjarri: Përputhen me kushtet zhvillimore të përgjithshme. Për këto monumente duhet të parashihet vendosja e hidrantëve të ujit në përputhje me ligjin respektiv;

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: Do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet specifike përfshijnë:

- Nuk lejohet qarkullimi i automjeteve më të rënda se 3 tonë afër lokaliteteve arkeologjike e monumenteve, përveç rasteve emergjente, ambulancës, zjarrfikësve dhe në raste të katastrofave natyrore;

- Duhet paraparë masat për zbutjen e trafikut në rrugë automjeteve në afërsi të monumenteve me vendkalimet për këmbësorë të ngritura në nivel me trotuarin;

- Lejohet përdorimi i shtyllave te ulëta (bollard) në vendet ku nuk pengojnë, në cdo 1 apo 2m. Këto shtylla mund të jenë maksimum 50x40x40cm nga guri, metali apo betoni i ngjyrosur;

- Pjerrinat duhet të kenë pjerrtësi maksimale 4% (ose 1m'/25m' gjatësi);

- Trotualet nuk duhet të jenë të rrethuara apo të kenë pengesa për këmbësorë;

- Është e ndaluar vendosja e kiosqeve, tezgave, kontejnerëve, shportave për mbeturina dhe elementeve tjera montazhe para apo në afërsi të monumenteve që mund të pengojnë pamjen apo qasjen e lirë në monument;

- Inkurajohet shfrytëzimi i teksturave për persona me shikim të dobësuar.

Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta:


- Parkimi i automjeteve lejohet vetëm në hapësirat e hapura të caktuara nga institucioni kompetent;

- Është e ndaluar vendosja e parkingjeve para apo në afërsi të monumenteve që mund të pengojnë pamjen apo qasjen e lirë në monument.

Bonuset e zonimit: autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor bonuset e zonimit me qëllim të mbrojtjes së monumentit apo stimulimit të pronarëve për mbrojtjen e tij. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme lirohet nga tatimi në pronë.

Jonkonformitetet: çdo zhvillim ekzistues në kuadër të zonës së monumentit apo sipërfaqes mbrojtëse të tij që bie ndesh me dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore, akteve ligjore përcjellëse si dhe rregulloreve respektive do të konsiderohet jo-konform dhe trajtohet përmes programeve të veçanta që merren me trajtimin e çështjes gjegjëse.

Harta 32 Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore



5.12. Zonat e interesit dhe mbrojtjes shtetërore

Përfshijnë sipërfaqet e objekteve apo strukturave që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të interesit dhe mbrojtjes shtetërore (bazat ushtarake, terminalet doganore, pikat kufitare etj).

5.12.1 Sipërfaqet e interesit të përgjithshëm sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera


Në Podujevë ekzistojnë dy pikë-kalimi kufitare me Serbinë: një në Merdar ku operon Dogana dhe Qendra Kombëtare për menaxhim të Kufirit dhe një në juglindje të Qafa e Bervenikut i cili është një vendkalim me karakter sekondar. PZHK nuk ka ndonjë përcaktim për zgjerim apo intervenim të mundshëm në këto zona.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara, të lejuara dytësore, të veçanta, përkohshme apo të ndaluara në pikat kufitare janë subjekt i përcaktimit të Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe ligjeve tjera respektive. Rregullimi i hapësirës për gjatë vijës kufitare deri në 500m' nga vija kufitare dhe nga zona e pikës kufitare kërkon miratimin me pëlqim paraprak të Ministrisë së Financave. Për shkaqe sigurie, autoritetet shtetërore mund të ndalojnë gjuetinë, peshkimin, fluturimin e avionëve dhe mjeteve tjera për fluturim, lëvizjen, qëndrimin në thellësi deri në 500 m' nga vija kufitare në tërë ose në një pjesë të kufirit shtetëror. Për dukshmërinë e vijës kufitare mund të ndalohet mbjellja e llojeve të caktuara të kulturave bujqësore, mbjellja e drunjve dhe bimëve tjera për gjatë vijës kufitare.

Kushtet zhvillimore

Objektet të cilat shfrytëzohen në pikat e kalimit kufitar duhet të planifikohen, ndërtohen dhe rregullohen në mënyrë që të mundësojnë kryerje të sigurt, të papenguar dhe ekonomike të kontrollit kufitar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe aktet që i përcakton Qeveria e Republikës së Kosovës.



5.13. Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploimit

Rezervat minerare janë hapësirat të cilat përmbajnë përqendrim të rezervave specifike minerare të akumuluar, të cilat për nga sasia, cilësia dhe kushtet tjera, janë të përshtatshme për eksploitim. Në sipërfaqet e tilla mund të planifikohen ndërtesa të cilat janë mbështetje të këtij funksioni.

Fushat e eksploimit janë zona në të cilat shtrihen burimet e rezervave minerare, të cilat janë të dedikuara për hulumtimin, kryerjen e punëve, përgatitjen, gërmimin dhe transportimin e lëndës së parë. Në zonat e fushave të eksploimit planifikohen hapësira për deponimin e mbetjeve industriale, ndërtimin e ndërtesave të minierës si dhe të ndërtesave për strehim të përkohshëm. Në zonat për eksploitim të lëndës së parë minerare gjithashtu planifikohet ri-kultivimi dhe rehabilitimi i terrenit.²⁸

Sipërfaqet minerare sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjisë nacionale

Territori i komunës së Podujevës është i pasur me resurse të shumta minerare ku prej tyre më të njohura janë mineralet që mund të përdoren si lëndë e parë ndërtimore në industrinë e ndërtimit si: Silikatet (sh), Karbonatet (ch), Zhavori (gs), Argjila (cl), pastaj, Nikeli (Ni), Plumbi (Pb), Zinku (Zn), Alumini (Al), etj. Sipas Strategjisë Minerare të Kosovës 2012–2025 si paraqitje dhe vendburime të rëndësishme më parë të hulumtuara dhe vlerësuara janë Quka e Batllavës për mineralet metalore si Plumb (Pb), Zink (Zn) dhe Argjend (Ag), dhe Llapashtica e Epërme për minerale jo–metalore Argjilë.

Për zhvillimin e aktiviteteve për eksploitim të resurseve minerare nëntokësore apo sipërfaqësore sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të MMPHI-së dhe MZHE-së respektivisht KPMM operatori ekonomik duhet të pajiset me lejet dhe licencat përkatëse nga niveli qendror dhe lokal. Komuna nuk duhet të lejoj zhvillimin e kësaj veprimtarie nëse operatori ekonomik nuk posedon licencën për operim nga autoritetet e lartpërmendura.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: minierë e xeheve metaleve dhe minierë dhe gurore tjetër.

²⁸ UA Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: infrastrukturë e transportit rrugor dhe hekurudhor, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, shërbim i logjistikës dhe magazinimit dhe administrativ dhe mbështetës si zyre administrative dhe objekte në shërbim të këtij funksioni.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: në sipërfaqet e eksploatura lejohet rikultivimi i sipërfaqes në pajtueshmëri me ligjet respektive, vendosja e paneleve solare për prodhimin e energjisë së ripërtërishe (me panele solate) nëse plotësohen kushtet e veçanta dhe ato mjedisore, e të ngjashme.

Shfrytëzimet e përkohshme: infrastrukturë/hapësirë për mbeturina si deponi e përkohshme e mbeturinave.

Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato shfrytëzime/funksione që nuk përfshihen apo nuk përkojnë me funksionet e ngjashme të përmendura në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimeve të përkohshme. Sipas për NTPH në zonat e rezervave minerare dhe të fushave të eksploatimit ndalohet planifikimi apo ushtrimi i ndonjë veprimtarie mbi shfrytëzimin e resurseve minerare në ndonjë sipërfaqe që:

- ndodhet 200m' ose më afër nga kufiri i një vendbanimi;
- ndodhet 250 m' ose më afër nga ndonjë shtëpi, ndërtesë e banuar ose përkohësisht e pabanuar;
- ndodhet 20m' ose më afër (në varësi nga pjerrtësia e lejuar e shpatit të shfrytëzimit e planifikuar kjo në projektin e shfrytëzimit) nga ndonjë tokë e pastruar ose lëvruar, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore, ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur bartësi i licencës ose lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë;
- ndodhet 200m' ose më afër nga ndonjë pendë ose rezervuar;
- ndodhet 150m' ose më afër të ndonjë termocentrali, largpërçuesi (35KË ose më lartë) ose lumi; Termocentrali duhet të jetë jo më afër se 150m' ose jo më larg se 250m' nga largpërçuesit nëse aktiviteti minierar zhvillohet pa minim;
- ndodhet 60m' ose më afër nga ndonjë rrugë e sistemit kombëtar;
- ndodhet 100m' ose më afër nga varrezat;
- ndodhet 100m' ose më afër nga ndonjë monument antik ose kombëtar i mbrojtur me ligj; ose 500m' ose më afër nëse përdoret eksploziv;
- ndodhet 500m' ose më afër ndonjë aeroporti ose pjese të zonës së sigurisë së aviacionit;
- ndodhet brenda ndonjë parku kombëtar ose komunal të mbrojtur me ligj;
- ndodhet 500m' ose më afër nga ndonjë ndërtesë e banimit ose institucionale dhe publike, nëse përdoret eksploziv.

Kushtet zhvillimore

Dimensionet e parcelës: Madhësia minimale e parcelës për një objekt në funksion të veprimtarisë është 300m².

Lartësia: Numri i etazhave 1 kat me lartësi maksimale 3.5m.

Lartësia në raport me rrugën publike: /

Lartësia në raport me kufijtë e parcelës: /

Intensiteti

- IShPKZh – 50%, dhe SGJP – 40%
- ISN – 0.5

Vijat: /

Qasja në parcelë: Duhet të jetë në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Distancat: /

Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës: Përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike të përcaktuara me ligjet përkatëse për të mbrojtur mjedisin dhe natyrën përreth nga ndotja. Në mënyrë që të parandalohet ndotja duhet të krijohen brezat mbrojtës me gjerësi minimale 5m'.

Siguria nga zjarri: Duhet të merren parasysh kushtet e përcaktuara me për Mbrojtje nga Zjarri.

Kërkesat për efikasitet të energjisë: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

Formësimi arkitektonik dhe estetik: Objekti i administratës duhet ndërtuar nga materiali ndërtimor si dru, gur, tulla, betoni, dritaret duhet të jenë nga PVC me ngjyrë të bardhë apo druri, kulmi duhet të jetë dy apo më shumë ujor, dhe parcela duhet të jetë e rrethuar me rrethojë metalike apo të drurit me lartësi 1.2m' apo me gjelbërim i lartë.

Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: Para se të filloj zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike.


Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: të përputhen me Kushtet e Përgjithshme Zhvillimore.
Masat mbrojtëse për mbrojtje të mjedisit: Nëse është e nevojshme zhvilluesi duhet të ndërmerr masa për parandalimin e ndotjes së mjedisit, zhurmës apo rrezatimit të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit apo aktet tjera ligjore.

Bonuset e zonimit: /

Jonkonformitetet: /

Me Ligjin për Miniera dhe Minerale, Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës përcaktohen masat dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së eksploatimit të resurseve minerale.

Harta 34 Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit



5.14 Zona Mbishtresore

Zona mbishtresore përcakton kushte zhvillimore dhe ndërtimore plotësuese brenda një sipërfaqeje të komunës të cilës i nevojitet vëmendje e veçantë. Zonat mbishtresore vendosen mbi një apo disa zona bazë. Krahas kushteve të zonës bazë kushtet mbishtresore vendosin kushte apo masa plotësuese. Në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë. Zonat mbishtresore përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte dhe masa mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike ku përcaktohen:

- Masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
- Masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
- Masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
- Masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurmës, etj;
- Përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet seizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, ortekëve, tërmetet, e të tjera, dhe

- Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për t'u zbatuar në gjithë territorin e Komunës.

Masat Mbrojtëse dhe Kushtet për mbrojtjen e resurseve kulturore, historike, natyrore, ujore, ekonomike, turistike, bujqësore, pyjore, zonat mbrojtëse, sipërfaqet e mbrojtura, për ndikimet në mjedis janë përcaktuar me zonat bazë.

5.14.1. Zona Mbishtresore për mbrojtje nga vërshimet (ZM – mv)

Lumi Llap gjatë periudhës së lagështisë ka predispozita të rrezikimit të sipërfaqeve tokësore. Sipas vlerësimeve në Hidro-ekonominë e Kosovës sipërfaqe që janë të rrezikuara nga vërshimet janë rreth 50ha, ndërsa në rrezik të përhershëm janë rreth 2972ha. Mbrojtja nga vërshimet përfshinë aktivitetet dhe masat për shmangien apo zvogëlimin e pasojave që mund të kenë vërshimet për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik²⁹. Për të parandaluar dhe minimizuar dëmet PZHK ka rekomanduar masat dhe kushtet si:

- zgjerimin e shtretërve të lumenjve në mënyrë që të përballojnë vëllimin e ujit;
- eliminimin e lakesave të forta të lumit;
- përcaktimin e vendit për menaxhimin e brigjeve të lumenjve;
- prerjen e shelgjeve dhe pastrimin nga ana e pronarëve të pronave;
- mbrojtjen e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, të cilat paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit;
- parandalimin e nxjerrjes ilegale të inerteve pranë shtretërve të lumenjve;
- kufizimin e shfrytëzimit të tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesorë me kullota të përhershme ose pyje përgjatë vijës ujore së paku 10m' nga vija ujore me qëllim të parandalimit të vërshimeve;
- meliorimin dhe pyllëzimin e brigjeve të lumenjve;
- ndërtimin e kanaleve dhe/ose mureve mbrojtëse;
- kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet;
- mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve, por prerja lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për rregullim peizazhor për rekreim, si modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit.

Gjithashtu duhet të ndërmerren masat dhe kushtet zhvillimore tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave dhe UA për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujë-rrjedhave dhe Akumulacioneve.

5.14.2. Zona Mbishtresore për mbrojtje nga erozioni (ZM – me)

Erozioni është prezent pothuajse në tërë territorin e Komunës së Podujevës, ku 4.11 % janë sipërfaqe pa erozion, 0.44 % me erozion shumë të dobët, 29.7% me erozion të dobët, 31.91% me erozion të mesëm, 29.52% me erozion të fortë dhe 4.32% me erozion shumë të fortë. Përsheptimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka inicuar edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar mjedisor. Erozioni më tepër prezent është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.

Sipas ligjit të Ujërave të Kosovës, sipërfaqet me intensitet të lartë të erozionit i cili sjell pasoja të dëmshme në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe paluajtshme, duhet të shpallen nga komuna si zona erozive. Masat parandaluese dhe antierozive për minimizimin e shfaqjes së erozionit që duhet të ndërmirën janë:

Masat parandaluese

- ndalimi i prerjes së degradimit të pyjeve;
- ndalimi i mbi kullotjes;
- ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion.

Veprimet dhe masat antierozive

- Masat hidroteknike
 - Ndërtimi i teracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese;
 - Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes;

²⁹ Ligjin Nr. UA Nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave

- Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve;
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve
- Masat bujqësore
 - Të mirëmbahen tokat bujqësore;
 - Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore;
 - Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet bazuar në udhëzimet e ekspertëve;
 - Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve;
- Masat biologjike
 - Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri;
 - Ndalimi i kullotjes në masivet e varfëra me bimësi;
 - Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara;
 - Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë;
 - Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjve kryesor me mbjelljen e drunjëve që do të mbulonin brezin prej 10m largësi nga lumi;
 - Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje.
- Masat anti-erozive
 - Meliorimi i pyjeve-11850ha;
 - Brezi mbrojtës i shpatieve-18170ha;
 - Mbrojtja me ndërtimin e terracave-3498ha;
 - Zonat e zhvillimit të punëve të antierozionit 790.3 ha;

Me HZK kërkohet që të respektohen masat dhe kushtet plotësuese, të përcaktuara me UA për Përcaktimin, Mënyrën, dhe procedurat për Mbrojtjen e Zonave Erozive dhe UA për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga Erozioni, si dhe rregullat dhe kushtet tjera për zhvillime në këtë zonë të përcaktuara me këtë plan, si:

- Kur komuna nuk ka të dhëna të besueshme mbi topografinë ekzistuese, ose kur informatat në dispozicion nuk ofrojnë detaje të mjaftueshme për të administruar kërkesat e këtyre dispozitave, komuna mund të kërkojë që aplikuesi për zhvillim të sigurojë një hulumtim topografik të vendit specifik, të paguar nga aplikuesi.
- Kushtet për këtë zonë nuk do të kenë efekt në shfrytëzimet e lejuara ose rregulloret në zonën bazë, përveç rasteve kur zhvillimi i propozuar do të vendoset brenda kufijve të Zonës mbishtresore-mbrojtja nga erozioni (ZM-me). Në hapësirat ku zbatohet mbishtresa, kërkesat e zonës mbishtresore do të zëvendësojnë çdo kërkesë më pak të rreptë të zonës bazë.
- Asnjë person nuk do të kryej asnjë nga aktivitetet e rregulluara në vijim brenda ZM-me, përveç nëse personi i tillë ka marrë më parë leje ndërtimore:
 - për pastrim ose ndërtim në cilëndo hapësirë të tokës brenda zonës, duke përfshirë aktivitetet e ndërtimit ose pastrimit në lidhje me sigurimin e qasjes së pajisjeve në lokacion. Kjo nuk përfshinë aktivitetet për mirëmbajtjen normale të pronës dhe/ose aktivitetet që kanë të bëjnë me shëndetin publik, situatat e sigurisë ose të emergjencës, siç janë:
 - aktivitetet e kopshtarisë, kujdesi dhe mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve, përfshirë heqjen e vegetacionit të vdekur ose të prishur;
 - riparimi i vogël dhe mirëmbajtja e strukturave;
 - riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të dëmtuara ose të prishura të ujërave të zeza, ose linjave të shërbimeve publike;
 - aktivitetet bujqësore, përveç aktiviteteve ndërtimore;
 - aktivitetet e shëndetit publik, urdhërat dhe rregulloret e komunës ose Qeverisë së Kosovës.
 - çdo aktivitet aktual ose i vazhdueshëm që është menjëherë i nevojshëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e jetës, pasurisë ose burimeve natyrore;
 - ndërtimi ose vendosja e ndonjë sistemi për deponimin e ujërave të zeza, duke përfshirë sistemet individuale të deponimit të ujërave të zeza, gropat septike, kanalizimet dhe drenazhimet;
 - operacionet e plotësimit, prerjes ose gërmimit të dheut;
 - drenazhimi i të reshurave dhe/ose ndërtimi dhe vendosja e sistemeve të drenazhimit të të reshurave;
 - ndërtimi i ndërtesave ose strukturave të reja ose shtesave dhe modifikimet në ndërtesat dhe strukturat ekzistuese, në përputhje me kërkesat e zonës bazë dhe zonës mbishtresore.

- Në dhënien, mohimin ose kushtëzimin e një lejeje ndërtimi, komuna merr në konsideratë efektin që zhvillimi i propozuar do të ketë për shëndetin dhe sigurinë publike dhe mbrojtjen ose përmirësimin e zonave me ndjeshmëri mjedisore brenda komunës. Asnjë miratim nuk lëshohet, përveç rasteve kur aplikuesi në mënyrë adekuate demonstroi se:
 - stabiliteti i tokës dhe i kushteve nëntokësore duhet të ruhet ose të rritet për të mbështetur në mënyrë adekuate çdo ndërtim, ose për të mbështetur çdo veprimtari të rregullimit të peizazhit, veprimtari bujqësore ose të ngjashme. Kjo duhet të dokumentohet në një raport gjeologjik të ofruar nga një laborator i testuar, i kualifikuar ose inxhinier, të paguar nga aplikuesi.
 - asnjë aktivitet i propozuar nuk do të shkaktojë erozion të pakontrolluar, rrëshqitje të tokës ose të shkaktojë që sedimentet të shkarkohen në ndonjë trup ujor.
 - jeta bimore e vendosur në shpatet dhe kodrinat jashtë hapësirës së zhvillimit do të ruhet. Bimët (shkurret dhe drunjtë) e nxjerra, duhet të rivendosen në zonat e trazuara menjëherë pas përfundimit të aktivitetit zhvillimor, për të parandaluar ndonjë nga efektet e dëmshme të përcaktuara më sipër dhe për të ruajtur karakteristikat natyrore skenike të shpatit dhe të kodrës.
 - qasja në shpatet e pjerrëta do të sigurohet me rrugë të rrafshëta jo më të mëdha se 15% dhe struktura anësore ose gabione jo më të mëdha se 30%, ose me tarraca apo stabilizim tjetër strukturor. Hapësirat e trazuara që nuk janë rrugë, do të stabilizohen me bimësi ose mjete të tjera fizike të aprovuara. Rrugët e përfunduara duhet të stabilizohen dhe të drenohen në mënyrë adekuate. Trazimi i shpatieve në masë më të madhe se 30% për të siguruar hyrjen në vendet e ndërtimit, do të kufizohet në 3% të hapësirës së tillë të pjerrtë.
- Ndërtimi i strukturave mbrojtëse nga erozioni duhet të jetë në përputhje me normat e mëposhtme:
 - të gjitha strukturat mbrojtëse ndaj erozionit duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me parimet inxhinierike të pranura ndërkombëtarisht, të cilat kanë treguar sukses ose gjasa të suksesit në kontrollin e erozionit afatgjatë. Masa mbrojtëse ndaj erozionit do të ketë probabilitet të arsyeshëm të kontrollimit të erozionit për së paku 30 vjet.
 - një program i mirëmbajtjes afatgjatë, do të përfshihet në çdo aplikim për ndërtim, modifikim ose restaurim të strukturës për mbrojtje nga erozioni. Programi do të përfshijë specifikimet për mirëmbajtjen normale të materialeve degraduese dhe zëvendësimin periodik të materialeve të largueshme.
 - i gjithë materiali i përdorur në struktura të tilla duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i aftë të qëndrojë ndaj kushteve të motit dhe stuhive. Materialet përbërëse të strukturave mund të kenë një jetëgjatësi më pak se 30 vjet, vetëm kur një program i mirëmbajtjes siguron që ato do të mirëmbahen rregullisht dhe të zëvendësohen sipas nevojës, për të arritur 30 vjetët e kërkuara të mbrojtjes ndaj erozionit.
 - ndërtimi, modifikimi ose restaurimi i strukturave të mbrojtjes nga erozioni nuk do të ketë të ngjarë të shkaktojë ndonjë rritje të matshme të erozionit në zonën e zhvillimit, apo në vende të tjera dhe të parandalojë efektet negative në tiparet mbrojtëse natyrore, strukturat ekzistuese të mbrojtjes nga erozioni dhe resurset natyrore.
 - drenazhimi i të reshurave nuk do të shkaktojë erozion, ngërç, kontribuojë në rrëshqitje të pjerrësisë, ndotë ujërat nëntokësore, të shkaktojë dëme ose përmytje të pronave. Sistemet e drenazhimit do të projektohen dhe vendosen për të siguruar stabilitetin e pjerrësisë.
 - çfarëdo shkallëzimi, gërmimi ose trazimi tjetër i tokës, i kryer në shpatiet e pjerrëta nuk duhet të drejtojë rrjedhjen e ujërave sipërfaqësore drejt ndërtimeve.
- Të gjitha aplikimet për leje ndërtimore do të përgatiten dhe shqyrtohen duke përdorur kriteret e mëposhtme:
 - shkalla e përfunduar për të gjitha shpatiet prerëse ose mbushëse nuk do të kalojë 3 me 1, domethënë tri horizontale me një vertikale. Përdorimi i strukturave mbajtëse mund të kërkohet për të eliminuar shpatiet më të mëdha se 3 me 1. Të gjitha këto mure mbajtëse duhet të projektohen nga një inxhinier. Plani i lokacionit do të tregojë konturat e propozuara dhe të tregojë të gjitha shpatet e propozuara më të mëdha se 3 me 1.
 - ujërat sipërfaqësore që largohen, nuk do të lejohet të rrjedhin kundrejt shpatieve me pjerrësi më të madhe se 15%. Ujërat e tilla duhet të shkarkohen nga një sistem i mbyllur i kullimit, deri në shpinën e shpatit ose në një strukturë rimbushëse (d.m.th., pus të thatë) ose një sistemi për të reshura. Metodrat e drenazhimit të të reshurave duhet të tregohen dhe të shënohen në planin e lokacionit.
 - do të lejohet trazimi i hapësirës minimum të nevojshme të shpatieve të pjerrëta, për të lejuar përfundimin e ndërtimit. Hapësirat e tilla duhet të shënohen qartë dhe të paraqiten në planin e lokacionit;

